

**LIBRI I LIGJEVE DHE I
RREGULLOREVE TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

VËLLIMI II

PËRMBAJTJA

	<i>RREGULLORE "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË"</i>	5
	<i>UDHËZIM "PËR KAPITALIN RREGULLATOR TË BANKËS"</i>	15
	<i>RREGULLORE "PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT"</i>	20
	<i>RREGULLORE "PËR POZICIONET E HAPURA VALUTORE"</i>	31
	<i>UDHËZIM METODIK "PËR RREZIQET NGA KËMBIMET VALUTORE"</i>	35
	<i>RREGULLORE "MBI RREZIQET E TREGUT"</i>	46
	<i>RREGULLORE "PËR KONTROLLIN E RREZIQEVE TË MËDHA"</i>	69
	<i>RREGULLORE "PËR INVESTIMET NGA BANKAT NË KAPITALIN E SHOQËRIVE TREGTARE"</i>	73
	<i>UDHËZIM "MBI ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT"</i>	75
	<i>RREGULLORE "PËR ADMINISTRATORËT E BANKAVE DHE TË DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA".</i>	77
	<i>RREGULLORE PËR "MADHËSINË DHE PLOTËSIMIN E "KAPITALIT FILLESTAR MINIMAL" PËR VEPRIMTARITË E LEJUARA PËR BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA TË LICENCUARA"</i>	84
	<i>RREGULLORE "PËR VEPRIMTARINË VALUTORE"</i>	87
	<i>UDHËZIM "PËR LIKUIDITETIN E BANKAVE"</i>	97
	<i>UDHËZIM "PËR KONTROLLIN E BRENDSHËM NË BANKA DHE NË DEGËT E BANKAVE TË HUAJA"</i>	101
	<i>RREGULLORE "PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË BANKAVE".</i>	105
	<i>UDHËZIM "PËR ÇERTIFIKATAT E DEPOZITAVE"</i>	109
	<i>VENDIM NR. 26, DATË 29.03.2000 PËR PËRJASHTIMIN E DISA SUBJEKTEVE NGA ZBATIMI I DISPOZITAVE TË LIGJIT NR.8365, DATË 2.07.1998 "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" NË BAZË TË NENIT 1 PIKA 2 E KËTJU LIGJI.</i>	111
	<i>UDHËZIM "PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE"</i>	112
	<i>UDHËZIM "MBI KUJDESTARINË DHE LIKUIDIMIN E BANKAVE"</i>	119
	<i>VENDIM NR. 58, DATË 24.07.2002 I KËSHILLIT MBIKËQYRËS "PËR MIRATIMIN E NJË VEPRIMTARIE SHITESË NË VEPRIMTARINË BANKARE"</i>	127
	<i>UDHËZIMI "PËR RAPORTIMIN E VEPRIMEVE TË KËMBIMEVE VALUTORE"</i>	128
	<i>RREGULLORE "PËR LICENCIMIN E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE"</i>	131
	<i>RREGULLORE "PËR MBIKËQYRJEN E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE"</i>	143
	<i>SISTEMI I RAPORTIMIT TË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT</i>	150
	<i>RREGULLORE "PËR NORMAT E MBIKËQYRJES TË SUBJEKTEVE JOBANKA QË USHTROJNË VEPRIMTARI FINANCIARE"</i>	156
	<i>RREGULLORE "PËR BANKAT KOOPERATIVË"</i>	159
	<i>RREGULLORE PËR MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONAT E LIDHUR ME TË</i>	164

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË

**Miratuar me vendimin nr.13, datë 21.02.2001, ndryshuar me vendimin nr. 32,
datë 08.05.2002 të Këshillit Mbikëqyrës**

Baza ligjore

Neni 1

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 12 gërma "a", të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 12 pika 3 gërma "b"; neni 28; neni 31, pika 2 ; neni 36 dhe neni 37.

Qëllimi

Neni 2

Qëllimi i kësaj rregulloreje është administrimi i rrezikut të kredisë në mënyrë që banka të minimizojë humbjet e mundshme nga kreditë dhe nga aktivet e tjera.

Në këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyrat e klasifikimit të kredive dhe të aktiveve të tjera të bankës, duke llogaritur një nivel të përshtatshëm fondesh rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë dhe, nga aktivet e tjera.

Për nevojat e kësaj rregulloreje me rrezik i kredisë kuptohet pamundësia e kredimarrësit dhe e garantuesit të kredisë ose kundërpartisë për aktivet e tjera për të përmbushur detyrimet ndaj bankës sipas kushteve të marrëveshjes të lidhur mes tyre.

Subjektet

Neni 3

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet e tjera jobanka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, për dhënien e kredive, që në vijim për thjeshtësi, në këtë rregullore, do të quhen "bankë".

Kërkesa të përgjithshme

Neni 4

Për të minimizuar humbjet nga kreditë, bankat identifikojnë, masin, monitorojnë dhe kontrollojnë rrezikun e kredisë. Për të realizuar këtë bankat, me miratim të këshillit drejtues :

- 4.1. hartojnë strategjinë e kreditimit ;
- 4.2. hartojnë politikat e normave të interesit dhe të madhësisë të kredive;
- 4.3. hartojnë procedura të miratimit dhe të administrimit të kredisë;
- 4.4. përcaktojnë dokumentacionin e nevojshëm të domosdoshëm për dhënien e kredive dhe për administrimin e tyre;
- 4.5. përcaktojnë procedura për ndjekjen në vazhdimësi të mbarëvajtjes së kredisë, për ndjekjen e kredive me probleme, për rivlerësimin e vazhdueshëm të garancive apo të kolateraleve dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga kreditë;
- 4.6. përcaktojnë procedura të kujdesshme për vlerësimin e cilësisë së aktiveve, për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i aktiveve, si dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së tyre;
- 4.7. përcaktojnë procedura për administrimin e rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, duke marrë në konsideratë edhe raportin e rrezikut të kredisë me rreziqet e tjera;
- 14.8. përcaktojnë procedura të miratimit dhe të administrimit për kreditë kufi.

¹ Nga ky paragraf deri në fund të nenit 4 janë shtesa të bëra me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 32, datë 08.05.2002 "Për një ndryshim në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë"

Kredia kufi ka të njëjtin kuptim me pikën 2.3.3. "kredi me llogari të zbuluar", të Manualit të Kontabilitetit Bankar, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 820, datë 30.12.98. Riklasifikimi në kategoritë e neneve 8, 9, 10, 11 e 12 të kësaj rregulloreje, kapitalizimi i interesave, kontabilizimi i interesave të llogaritur për kreditë kufi nuk konsiderohen lëvizje në llogari.

Rregulla të përgjithshëm të bankës

Neni 5

Manualet dhe politikat e shkruara të bankës, për vlerësimin në vazhdimësi të rrezikut të moskthimit të kredive dhe aktiveve të tjera, minimalisht përcaktojnë :

5.1- për aktivet:

- a) njësitë administrative që merren me vlerësimin e rrezikut,
- b) metodat e vlerësimit të garancive dhe të kolateraleve përkatëse,
- c) bashkëveprimin me njësitë e kontrollit të brendshëm,
- d) periodicitetin e vlerësimit, të klasifikimit dhe të parashikimit për fonde rezervë për mbulimin e rrezikut,
- e) periodicitetin e raportimit për administratorët e bankës;

5.2- për kreditë :

Përveç sa është përmendur në pikën 5.1 edhe :

5.2.1. gjendjen financiare të kredimarrësit dhe besueshmërinë e tij.

Analiza e gjendjes financiare të kredimarrësit dhe besueshmëria e tij janë parësore për vlerësimin e cilësisë të kredisë dhe për klasifikimin e saj.

Ajo bëhet në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

- a) biznesplani i kredimarrësit,
- b) bilanci kontabël,
- c) llogaritë e rezultatit financiar (Humbje e fitime),
- d) pasqyra e parashikimit të fluksit të rrjedhjes së parave;

5.2.2. analizën e sigurimit të kredisë dhe të gjendjes financiare të garantuesit të kredisë, kur është e mundur të analizohen.

Në kushtet kur, pozicioni parësor i kredimarrësit është i dobët atëherë marrim në konsideratë sigurimin e kredisë dhe analizën e gjendjes financiare të garantuesit të kredisë, si detyësore për vlerësimin e cilësisë të kredisë dhe, për klasifikimin e saj.

5.2.2.1. Sigurimi i mirë i kredisë :

Me kredi të siguruar mirë kuptojmë që kolaterali ose garancia është e mjaftueshme të mbrojë bankën nga humbja e kryegjësë dhe e interesit.

Me mjaftueshmëri do të kuptojmë ekzistencën e një dokumentacioni ligjor, që siguron bankën se me ekzekutimin e kolateralit ose të garancisë do të mbulojë sasinë e kryegjësë dhe të interesit si dhe koston e mbledhjes ose të ekzekutimit të këtij kolateralit.

Sigurimi do të quhet i mirë në qoftë se plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

- a. kredia është e garantuar në mënyrë të mjaftueshme (100 për qind) nga një garanci në lekë e Qeverisë ose e Bankës së Shqipërisë kur kredia jepet në lekë;
- b. kredia është e garantuar nga letra me vlerë të qeverisë. Vlera e kredisë nuk e kalon 80 për qind të vlerës së kolateralit ose garancisë;
- c. kredia është e garantuar në mënyrë të mjaftueshme (100 për qind) nga institucionet financiare ndërkombëtare;
- d. kredia është e garantuar në mënyrë të mjaftueshme (100 për qind) nga qeveritë qendrore ose nga bankat qendrore të vendeve të zonës A sipas valutës përkatëse (vendet e zonës A janë përcaktuar në rregulloren e mjaftueshmërisë të kapitalit të bankës);
- e. kredia është e garantuar nga një bankë tjetër solvente, për degët e bankave të huaja, e ndryshme nga banka-mëmë. Vlera e kredisë nuk e kalon 70 për qind të vlerës së kolateralit ose garancisë;
- f. kredia është garantuar kundrejt lënies peng të vlerave të luajtshme të kredimarrësit

- ose të garantuesit. Vlera e kredisë nuk e kalon 70 për qind të çmimit të tregut të pasurisë së lënë peng;
- g. kredia është e garantuar kundrejt hipotekës së pasurisë së patundshme të kredimarrësit ose të garantuesit. Vlera e kredisë nuk kalon 70 për qind të çmimit të tregut të pasurisë së hipotekuar, pasuria e patundshme duhet të jetë e inkskriptuar në favor të bankës;
 - h. kredia është e garantuar nga një institucion financiar i specializuar. Vlera e kredisë nuk kalon 50 për qind të shumës së garantuar;
 - i. kredia është e garantuar nga një depozitë e bllokuar në lekë ose në valutë. Kjo depozitë të jetë të paktën 25 për qind më e lartë se vlera e kredisë së dhënë, kur janë në monedha të ndryshme, dhe 20 për qind më e lartë se vlera e kredisë së dhënë, kur janë në monedhë të njëjtë.

5.2.2.2. Analiza e gjendjes financiare të garantuesit të kredisë, në rast se është e mundur, bëhet në përputhje me dokumentet e mëposhtme :

- a) bilanci kontabël;
- b) llogaritë jashtë bilancit;
- c) llogaritë e rezultatit financiar (humbje e fitime);
- d) pasqyra e parashikimit të fluksit të rrjedhjes së parave.

5.2.3. Kohën e pagesës së interesit dhe të ripagesës së kryegjësë, e cila vlerësohet nga analiza e dokumentacionit të përcaktuar nga vetë banka .

Kredi për personat e lidhur

Neni 6

Këshilli drejtues i bankës përcakton rregulla të veçantë, në lidhje me dhënien e kredive personave të lidhur me bankën, për monitorimin dhe për kontrollin e rrezikut të tyre. Kushtet dhe termat e dhënies së kredive janë të njëjta me ato të klientelës. Në qoftë se këto kredi nuk janë të kolateralizuara ose të garantuara sipas pikës 5.2.2.1. atëherë pjesa e pakolateralizuar i zbritet kapitalit rregullator të bankës.

Klasifikimi i kredive

Neni 7

Në bazë të kriterëve të mësipërme dhe me qëllim që të përcaktohet dhe të kufizohet rreziku i kredisë, bankat klasifikojnë kreditë e tyre në një nga 5 kategoritë e mëposhtme:

- 1. kredi standarde,
- 2. kredi në ndjekje,
- 3. kredi nënstandarde,
- 4. kredi të dyshimta,
- 5. kredi të humbura.

Kreditë standarde

Neni 8

Bankat klasifikojnë si kredi standarde, të gjitha kreditë, përveç atyre të klasifikuara sipas neneve 9,10,11,12.

Kur kësti i kredive standarde, që shlyhen me këste, nuk është paguar në afat për një periudhë prej 1 deri në 30 ditë, atëherë vetëm kësti klasifikohet në rubrikën 21 të "Manualit të Kontabilitetit" ("kredi dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientin") dhe kjo shumë përfshihet në kredinë standarde.

Kreditë në ndjekje

Neni 9

Bankat klasifikojnë si kredi në ndjekje, kreditë, të cilat paraqiten me një ose disa nga karakteristikat e mëposhtme:

- 1- gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet e mirë, por dobësi të mundshme që shoqërohen me një dobësim të gjendjes financiare të kredimarrësit në një kohë të ardhme;
- 2- kredia është e siguruar mirë, pra gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet e mirë;
- 3- kur kryegjëja ose interesi, nuk është paguar për një periudhë prej 1 deri 30 ditësh nga afati i maturimit në rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;
- 4- kur kryegjëja ose interesi, nuk është paguar për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga afati i maturimit në rastet kur kredia shlyhet me këste;
- 5- kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 31 deri 60 ditë për rastet kur kemi të bëjmë me kredi kufi.

Kreditë nënstandarde

Neni 10

Bankat klasifikojnë si kredi nënstandarde, kreditë, të cilat plotësojnë një ose disa nga karakteristikat e mëposhtme:

- 1- gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet jo e kënaqshme pasi të ardhurat e tij nga aktiviteti kryesor gjykohen të pamjaftueshme;
- 2- gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet e mirë, por parashikohen probleme në të ardhmen;
- 3- kredia nuk është e siguruar mirë, vlera e tregut të kolateralit të vënë nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 5.2.2.1;
- 4- kredia është ristrukturuar nga paaftësia për ta paguar atë;
- 5- kur kryegjëja ose interesi, nuk janë paguar për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;
- 6- kur kryegjëja ose interesi, nuk janë paguar për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia shlyhet me këste;
- 7- kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 61 deri 180 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredi kufi.

Kreditë e dyshimta

Neni 11

Bankat klasifikojnë si kredi të dyshimta, kreditë, të cilat plotësojnë një ose disa ndër karakteristikat e mëposhtme:

- 1- gjendja financiare e kredimarrësit jep të dhëna për ta konsideruar atë se nuk do të jetë në gjendje të paguajë në total detyrimin e tij mbi kredinë ose detyrime të tjera të tij ndaj bankës ose ndaj personave të tretë;
- 2- gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet se nuk është në gjendje të përmbushë angazhimet e dhëna ndaj kredimarrësit dhe bankës;
- 3- ekziston një rrezik real për kredimarrësin që të deklarohet jolikuid;
- 4- kur kryegjëja ose interesi, nuk janë paguar për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;
- 5- kur kryegjëja ose interesi, nuk janë paguar për një periudhë prej 181 deri 360 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia shlyhet me këste;
- 6- kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 181 deri 360 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredi kufi;
- 7- kredia është ristrukturuar dy herë për shkak të paaftësisë paguese .

Kreditë e humbura

Neni 12

Bankat klasifikojnë si kredi të humbura ato kredi, të cilat plotësojnë një ndër karakteristikat e mëposhtme:

- 1- gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë si e paaftë për përmbushjen e kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit;
- 2- gjendja financiare e garantuesit vlerësohet se nuk mund të përmbushë angazhimet e dhëna ndaj kredimarrësit dhe bankës;
- 3- kredimarrësi ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi dhe ekziston rreziku që disa kreditorë të mbeten të pakënaqur;
- 4- kur kryegjësja ose interesi, nuk janë paguar për një periudhë prej më shumë se 181 ditë nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;
- 5- kur kryegjësja ose interesi, nuk janë paguar për një periudhë prej më shumë se 360 ditësh nga afati i maturimit për rastet kur kredia shlyhet me këste;
- 6- kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për më shumë se 360 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredi kufi;
- 7- banka ka ngritur padi ndaj kredimarrësit;
- 8- kredia është ristrukturuar për më shumë se dy herë, për shkak të paafësisë paguese;
- 9- të njëjtat pasuri të kredimarrësit janë lënë peng ose janë hipotekuar edhe për kreditorë të tjerë;
- 10- kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë.

Neni 13

Për kreditë e klasifikuara sipas neneve 10, 11 dhe 12 interesat e llogaritur nuk kontabilizohen. Në rastet kur kredimarrësi shlyen detyrimin, në detyrim përfshihet edhe llogaritja e interesave të pakontabilizuar. Kjo bëhet për të mos rënduar bilancin për ata interesa, që janë të pasigurt për t'u arkëtuar.

Arkëtimet pasuese, që merr banka, duhet të përdoren më parë për shlyerjen e interesit të të gjithë periudhës dhe pastaj të kryegjësë .

Riklasifikimi i kredive

Neni 14

Nëse një kredi riklasifikohet nga njëra rubrikë tek tjetra, teprica gjithsej e kredisë dhe të gjitha shumat që lidhen me të (kryegjësja, interesat e përlllogaritur, garancitë e dhëna klientit ose kredi të tjera, që lidhen me të) kalojnë në atë rubrikë, e cila kërkon krijimin e një shume më të madhe të provigjoneve.

Në çdo rast riklasifikimi të kredive nga një rubrikë në tjetrën, provigjonet e krijuara më parë regjistrohen si të ardhura nga rimarrja e provigjoneve, dhe provigjonet e krijuara rishtas në rubrikën e re, regjistrohen si shpenzime.

Për vlerësimin e kredive, në përputhje me këtë rregullore, bankat dhe degët e bankave të huaja plotësojnë formularin nr. 1 bashkëlidhur, për çdo kredi, i cili do të ruhet në dosjen e kredimarrësit.

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

Neni 15

Për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive, banka krijon fondet përkatëse, provigjonet, duke rënduar periodikisht shpenzimet e saj, si:

A. për mbulimin e rrezikut statistikor, norma e provigjonimit është si më poshtë:

- për "kredinë standarde" dhe "kredi dhe paradhënie të pakthyer në afat për klientin"1% .
 - për kredinë në ndjekje.....5% .
- Provigjonet llogariten mbi vlerën (principal + interes) e kredive të mësipërme;

B. për mbulimin e rrezikut të zhvlerësimit të kredive, normat minimale të provigjonimit, janë si më poshtë:

për principalin:

- kredi nënstandarde.....20%
- kredi të dyshimta.....50%
- kredi të humbura.....100%

për interesin e llogaritur norma është 100 për qind në çdo rast .

Në asnjë rast norma e provigjonimit të një rubrike nuk duhet të jetë e barabartë ose të kalojë normën minimale të provigjonimit të rubrikës paraardhëse.

Klasifikimi i aktiveve të tjera dhe i angazhimeve të dyshimta

Neni 16

1. Banka analizon edhe cilësinë e aktiveve të tjera, përveç kredive, bën klasifikimin e tyre dhe llogarit fonde rezervë, kur e gjykon të arsyeshme.

Klasifikimi i aktiveve dhe madhësia e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga zhvlerësimi i tyre, caktohet me propozim të departamentit (drejtorisë) përkatës të bankës dhe me miratim të këshillit drejtues.

Fondet rezervë për aktivet e bankës kontabilizohen në debi të shpenzimeve për fonde rezervë dhe në kredi të llogarisë përkatëse të fondeve rezervë.

2. Banka klasifikon si angazhime të dyshimta, të drejtat jashtë bilancit të lidhura me :

a) kreditë e klasifikuara në nenet 10, 11, 12;

b) aktivet e klasifikuara sipas pikës 1 të këtij neni.

Ajo analizon rrezikun e tyre dhe llogarit fonde rezervë.

Madhësia e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga zhvlerësimi i tyre, caktohet me propozim të departamentit (drejtorisë) përkatës të bankës dhe me miratim të këshillit drejtues.

Fondet rezervë për angazhimet e dyshimta kontabilizohen në debi të shpenzimeve për fonde rezervë dhe në kredi të llogarisë përkatëse të fondeve rezervë për angazhimet e dhëna.

Kapitalizimi i interesit

Neni 17

Kapitalizimi i interesit është procesi nga ku interesi i llogaritur bashkohet me kryegjënë deri në shlyerjen përfundimtare të kredisë. Kapitalizimi i interesit lejohet në rast se është përmbushur të paktën njëri nga kushtet e mëposhtme:

- 1- kredimarrësi është në gjendje të paguajë detyrimet e tij nga të ardhurat e veprimtarisë;
- 2- kapitalizimi i interesit është parashikuar në kushtet dhe në afatet e marrëveshjes fillestare të kredisë, në rast vështirësie likuiditeti të kredimarrësit;
- 3- kredia përfshirë dhe interesin e kapitalizuar është garantuar mirë;
- 4- planbiznesi i kredimarrësit krijon besim që në të ardhmen gjendja financiare do të përmirësohet ndjeshëm ose të ardhurat e tij të veprimtarisë do të rriten në mënyrë të konsiderueshme;
- 5- nuk ka rrezik të menjëhershëm për humbje të kredisë, përfshirë dhe interesin e kapitalizuar;
- 6- kredimarrësi mund të sigurojë fonde për shlyerjen e kredisë nga burime të tjera në shumën dhe në kohën e njëjtë me maturimin e kredisë.

Ristrukturimi i kredisë

Neni 18

Bankat, në marrëveshje me kredimarrësin, rristrukojnë kredinë në rastin kur kredimarrësi nuk shlyen kredinë në përputhje me afatet dhe me kushtet e marrëveshjes fillestare, sipas kriterëve të përcaktuara në manualin e kredisë të miratuar nga këshilli drejtues i bankës.

Në rast të riskstrukturimit të kredisë, në dosje shtohet dhe marrëveshja e rristrukurimit e lidhur midis bankës dhe kredimarrësit.

Fshirja e kredive të humbura

Neni 19

1. Fshirja e kredive të humbura bëhet me vendim të këshillit drejtues kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme :

- bankës i ka mbetur një kredimarrës i pashlyer tërësisht pas përfundimit të procesit ligjor të kërimit të kthimit të kredisë nga kredimarrësi;
- këshilli drejtues i bankës e ka përfshirë kredinë në listën e kredive të humbura, të cilat mund të fshihen menjëherë;
- kur kredia është e klasifikuar si e humbur dhe nuk është shlyer për më tepër se dy vite kalendarike.

2. Dosjet e kredive të fshira ruhen dhe ndiqen në vazhdimësi duke u shqyrtuar jo më pak se dy herë në vit nga këshilli drejtues i bankës. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

Raportimi

Neni 20

Bankat bëjnë klasifikimin e kredive dhe të aktiveve të bankës dhe llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve, jo më pak se një herë në tre muaj.

Ato hartojnë dhe paraqesin në Bankën e Shqipërisë, si pjesë përbërëse të sistemit raportues, formularët nr. 2 dhe 3 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 21

Banka e Shqipërisë mund të kërkojë, në çdo kohë nga bankat, të dhëna shtesë dhe analitike mbi çdo çështje të raportimit mbi rrezikun e kredisë dhe të fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, që përfshin çdo faktor të llogaritur.

Dispozita përfundimtare

Neni 22

Për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, Banka e Shqipërisë zbaton nenet 44 dhe 45 "Për shkeljet dhe dënimet" të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 23

Rregullorja nr. 51, datë 29.04.1998 "Mbi klasifikimin e huave dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e rreziqeve nga huatë", miratuar me vendimin nr. 50, datë 22.04.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

Neni 24

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë .

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

FORMULAR 1

TË DHËNA PËR TEPRICËN E KREDISË SË KLIENTIT

Nr		31.03.....
1	Sfera e aktivitetit	
2	Forma e pronësisë	
3	Qëllimi i dhënies të kredisë	
4	Lloji i kredisë (sipas afatit)	
5	Detyrimi në garanci dhënë bankës	
6	Shuma totale e papaguar :	
	- kryegjëja	
	- interesi	
7	Pozicioni financiar i huamarrësit :	
	- i besueshëm , i mirë	
	- jo i besueshëm	
	- jo i kënaqshëm	
	- i keqësuar	
	- i falimentuar	
8	Sigurimi i kredisë	
	- i mjaftueshëm , i siguruar mirë	
	- i pamjaftueshëm , jo i siguruar mirë	
9	Ripagimi i kryegjësë dhe pagimi i interesit :	
	- i paguar në afatin e maturimit	
	- nuk është paguar për 1-30 ditë	
	- nuk është paguar për 31-90 ditë	
	- nuk është paguar për 91-180 ditë	
	- nuk është paguar mbi 181 ditë	
	- kësti nuk është paguar për 1-30 ditë	
	- kësti nuk është paguar për 31-90 ditë	
	- kësti nuk është paguar për 91-180 ditë	
	- kësti nuk është paguar për 181-360 ditë	
	- kësti nuk është paguar mbi 361 ditë	
10	Numri i ristrukturimit të kredisë	
11	Klasifikimi i kredisë :	
	- kredi standarde , hua dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientin (kësti)	
	- kredi në ndjekje	
	- kredi nënstandarde	
	- kredi të dyshimta	
	- kredi të humbura	
12	Provizione për kreditë (sipas afatit)	
13	Provizione për garancitë e dhëna	

FORMULAR 2

FONDE REZERVË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NGA KREDITË

Tabela nr.1		Kryegjëja				K ç klier 5=
Nr	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën 1	Kredi ndër bankare 2	Angazhime të dyshimta 3	Norma për provigjone 4	
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)				0.01	
2	Kredi në ndjekje				0.05	
3	Kredi nënstandarde				0.20	
4	Kredi të dyshimta				0.50	
5	Kredi të humbura				1.00	
6	TOTALI					

Tabela nr.2		Interesat e llogaritur		
Nr	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën 1	Kredi ndër bankare 2	Norma për provigjone 3
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)			0.01
2	Kredi në ndjekje			0.05
3	Kredi nënstandarde			1.00
4	Kredi të dyshimta			1.00
5	Kredi të humbura			1.00
6	TOTALI			

Tabela nr.3		Rimarrje e fondit rezervë për kryegjënë				F kli
Nr	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën 1	Kredi ndër bankare 2	Angazhime të dyshimta 3	Shuma për kryegjënë 4=1+2+3	
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)					
2	Kredi në ndjekje					
3	Kredi nënstandarde					
4	Kredi të dyshimta					
5	Kredi të humbura					
6	TOTALI					

FORMULAR NR. 3

FONDET REZEVË TË KRIJUARA NGA BANKA
PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NGA KREDITË

Numrat e llogarive	Emërtimi i llogarive	Teprica në fillim 1(+)	Shtimi i provigjoneve 2(+)	Rimarrja e provigjoneve 3(+)	Kre fshir: peri 4
128					
198					
238					
248					
258					
268					
298					
3128					
3138					
3228					
418					
518					
528					
538					
551					
558					

UDHËZIM

PËR

KAPITALIN RREGULLATOR TË BANKËS

Miratuar me vendimin nr. 57, datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin nr.40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës

KAPITULLI I

TË PËRGJITHSHME

1- Ky udhëzim është përgatitur në zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

2- Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

3- Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së llogaritjes së kapitalit rregullator të bankës për mbulimin e rrezikut të kredisë.

4-Përcaktim: me rrezik të kreditit do të kuptojmë efektin negativ në kapitalin e bankës si rezultat i falimentimit të kundërpartisë (të të tretëve).

KAPITULLI II

KAPITALI RREGULLATOR PËR MBULIMIN E RREZIKUT TË KREDISË

1- Kapitali rregullator i bankës përbëhet nga **kapitali bazë** dhe **kapitali shtesë**.

2- Elementet përbërëse të kapitalit rregullator:

2.1. kapitali bazë përbëhet nga dy grupe :

2.1.1.elementet përbërëse që shtohen **(A)**:

- kapitali i nënshkruar ;
- rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit) ;
- primet e emetimit dhe të fuzionimit (shkrirjes, bashkimit) ;
- fitimet e pashpërndara (të bartura);
- fitimi ushtrimor i fundit të vitit (përcaktuar në pikën 5);
- fitimi ushtrimor i periudhës raportuese (përcaktuar në pikën 4.1);
- diferenca rivlerësimi kreditore.

2.1.2.Elementet përbërëse që zbriten **(B)**:

- kapitali i nënshkruar i papaguar;
- vlera emërore e aksioneve të bankës të mbajtura nga banka (të pashitura ,të riblera);
- humbjet e pashpërndara (të bartura);
- humbja ushtrimore (përcaktuar në pikën 4.2.);
- diferenca rivlerësimi debitore;
- aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara.

Totali i kapitalit bazë është i barabartë me $C = [(A) - (B)]$

2.2. Elementet përbërëse të kapitalit shtesë:

2.2.1. kapitali shtesë përbëhet nga këto elemente **(j)**:

- rezervat e rivlerësimit;
- rezervat e përgjithshme (përcaktuar në pikën 6.);
- detyrimet e varura:

- i) instrumentet hibride (përcaktuar në pikën 8.1.),
- ii) detyrimet e varura me afat (përcaktuar në pikën 8.2.).

2.2.2. KUFIZIMET

Elementet përbërëse të kapitalit shtesë kanë këto kufizime në përfshirjen e tyre në llogaritjen e kapitalit rregullator:

2.2.2.1. totali i kapitalit shtesë të jetë jo më i madh se 100 për qind e totalit të kapitalit bazë,

2.2.2.2. totali i detyrimeve të varura me afat që bëjnë pjesë në kapitalin shtesë të jetë jo më i madh se 50 për qind e totalit të kapitalit bazë.

3. Për llogaritjen e kapitalit rregullator, nga shuma e kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë të llogaritur sipas pikës 2 të këtij kapitulli, zbriten këto elemente:

3.1. pjesëmarrjet dhe të drejtat e varura në banka dhe institucionet e tjera financiare **(p)**:

i) pjesëmarrjet në banka dhe institucione të tjera financiare me një shumë më të madhe se 10 për qind e kapitalit të tyre ose me një shumë më të vogël se 10 për qind e kapitalit të tyre, por që ushtron ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve në to.

Pjesëmarrjeve i shtohen edhe të drejtat e varura në të njëjtat banka dhe institucione financiare;

ii) shuma totale e pjesëmarrjeve në banka dhe në institucione të tjera financiare, që nuk plotësojnë kushtet e pikës së mësipërme, së bashku me të drejtat e varura të tjera në të njëjtat banka dhe institucione të tjera financiare, pasi të jenë pakësuar në masën 10 për qind, pra $[10\% \times (C + J)]$.

3.2. Garancitë e dhëna Fondit të Garancisë Reciproke sipas kushteve të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë **(q)**.

Totali i kapitalit rregullator është $[c + j - (p + q)]$.

4. REZULTATI I NDËRMJETËM :

Me rezultat të ndërmjetëm do të kuptojmë fitimin ose humbjen ushtrimore të çdo periudhe ushtrimore, me përjashtim të periudhës ushtrimore të çdo fundviti.

4.1. Fitimi ushtrimor i periudhës do të përfshihet në totalin e kapitalit rregullator, të llogaritur sipas metodologjisë të përshkruar në këtë kapitull si pjesë përbërëse e kapitalit bazë në qoftë se plotëson në mënyrë të njëkohëshme kushtet e mëposhtme:

4.1.1. përcaktohet pasi të jenë kontabilizuar të gjitha shpenzimet e periudhës korresponduese, përfshirë këtu edhe shpenzimet për amortizime dhe provigjonet;

4.1.2. të jenë llogaritur për neto pasi të jenë zbritur tatimi mbi fitimin e parashikuar dhe dividendët e parashikuar;

4.1.3. të jetë verifikuar nga komiteti i kontrollit të bankës dhe nga eksperti kontabël i autorizuar.

4.2. Humbja ushtrimore e periudhës për arsye kujdesi dhe mbikëqyrjeje në çdo rast, pavarësisht nga periudha ushtrimore në të cilën bën pjesë, do të përfshihet në totalin e kapitalit rregullator si pjesë përbërëse e kapitalit bazë, llogaritur sipas metodologjisë të përshkruar në këtë kapitull.

5. FITIMI USHTRIMOR I FUNDIT TË VITIT :

Për nevojat e këtij udhëzimi me fitim ushtrimor të fundit të vitit do të kuptojmë fitimin ushtrimor të periudhës të çdo fundviti, i cili është i pashpërndarë deri në momentin e raportimit të kapitalit rregullator dhe do të përfshihet në kapitalin bazë, i pakësuar me masën e dividendëve të parashikuar për t'u shpërndarë.

6. REZERVAT E PËRGJITHSHME :

Me rezerva të përgjithshme do të kuptojmë elementet që përmbushin kushtet e mëposhtme:

- 6.1. përdoren lirisht nga banka për mbulimin e rreziqeve të paidentifikuara lidhur me aktivitetin e bankës dhe nuk reflektojnë reduktimin e vlerës të një aktivi të caktuar ;
- 6.2. figurojnë në kontabilitetin e bankës ;
- 6.3. shuma përcaktohet nga drejtuesit dhe verifikohet nga komiteti i kontrollit të bankës dhe nga eksperti kontabël i autorizuar.

7. DETYRIMET E VARURA

Detyrimet e varura përcaktohen si **“burime me origjinë emetimin e titujve ose të huave të varura me afat ose pa afat, shlyerja e të cilave në rast likuidimi bëhet pas shlyerjes së detyrimeve të tjera”** .

Klasifikimi i tyre varet nga respektimi i kushtit të varësisë dhe jo nga forma e emetimit (titull apo hua) ose kriteri i afatit (me afat apo pa afat).

Në kontabilitet ato paraqiten në kredi të llogarisë 56 “Detyrime të Varura” dhe në debi të llogarisë 112 “Banka Qendrore” ose në debi të llogarisë 131 “Llogari rrjedhëse me bankat.....” ose në debi të llogarisë 271 “Operacione me klientelën” në varësi të kundërpartisë .

8. LLOJET E DETYRIMEVE TË VARURA :

8.1.Instrumente hibride:

- janë të pasiguruara, të varura dhe plotësisht të paguara;
- shlyhen vetëm me iniciativën e huamarrësit dhe me miratimin e Bankës së Shqipërisë;
- kushtet e kontratës përmbajnë mundësinë e shtyrjes në kohë të pagimit të interesave, në rast se subjektet e kësaj rregulloreje janë me humbje;
- kushtet e kontratës përcaktojnë që shlyerja e kryegjësë dhe e interesave të papaguar mund të përdoren për absorbimin e humbjeve, pa qenë nevoja që subjektet në fjalë të ndërpresin aktivitetin;
- përfshihen në kapitalin rregullator për sasi të efektive të arkëtuara.

8.2.Detyrim i varur me afat:

- në rast se kontrata parashikon një datë të caktuar për shlyerje, periudha fillestare e maturimit duhet të jetë jo më e vogël se 5 vjet;
- në rast se kontrata nuk parashikon një datë të caktuar, detyrimi mund të shlyhet me një paralajmërim prej 5 vjetësh;
- në asnjë rast nuk parashikohet shlyerja para afatit, përveç rasteve të likuidimit pa miratimin e Bankës së Shqipërisë;
- shlyerjet nuk përdoren për mbulimin e humbjeve;
- përfshihen në kapitalin rregullator për sasi të arkëtuara në fakt, të cilat reduktohen progresivisht me 20 për qind në pesë vitet e fundit para maturimit.

8.3. Miratimi nga Banka e Shqipërisë jepet në rast të plotësisht njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:

8.3.1. subjektet e këtij udhëzimi janë me fitim;

8.3.2. çdo shlyerje si e kryegjësë ashtu edhe e interesit të instrumenteve të përcaktuara në pikat 8.1. dhe 8.2. nuk e zvogëlon mjaftueshmërinë e kapitalit nën kufirin e caktuar nga Banka e Shqipërisë.

9. PERIUDHA E RAPORTIMIT

Kapitali rregullator raportohet në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, çdo muaj.

10. MËNYRA E RAPORTIMIT

Mënyra e raportimit të kapitalit rregullator të llogaritur nga banka bëhet sipas formularit të mëposhtëm, i cili është pjesë e sistemit raportues.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi më 01.06.1999.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

FORMULARI I RAPORTIMIT
(kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë)

Emri i bankës
 Periudha raportuese
 Data e raportimit
 Përgatiti (Emër,mbiemër,firmë)
 Drejtuesi (Emër,mbiemër,firmë)

në mijë Lekë.

KAPITALI BAZË	
	I . Elementet përbërëse që shtohen (A) :
1	Kapitali i nënshkruar
2	Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)
3	Primet e emetimit dhe të fuzionimit
4	Fitimet e pashpërndara (e bartura)
5	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit
6	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese
7	Diferenca rivlerësimi kreditore
	Nëntotali A= (1+2+3+4+5+6+7)
	II . Elementet përbërëse që zbriten (B) :
1	Kapitali i nënshkruar i papaguar
2	Vlera nominale e aksioneve (të pashitura , të riblera)
3	Humbjet e pashpërndara (të bartura)
4	Humbja ushtrimore
5	Diferenca rivlerësimi debitore (negative)
6	Aktive ¹ të qëndrueshme të patrupëzuara
	Nëntotali B= (1+2+3+4+5+6)
	Totali i kapitalit bazë C= (A-B)
KAPITALI SHITESË	
	III . Elementet përbërëse (J) :
1	Rezervat e rivlerësimit
2	Rezerva të përgjithshme
3	Istrumente hibride
4	Detyrime të varura me afat
	N.q.s. $F \leq C/2$ atëherë $G = F$
	N.q.s. $F > C/2$ atëherë $G = C/2$
	Nëntotali i kufizuar H = (EA + EB + EC + G) :
	Kufizimi i parë: n.q.s. $H \leq C$ atëherë $J = H$
	Kufizimi i dytë: n.q.s. $H > C$ atëherë $J = C$
	Totali i kapitalit shtesë para zbritjes (J)

¹ sipas Manualit të Kontabilitetit Bankar duhet të zëvendësohet me fjalën "mjete".

	IV . Elementet përbërëse që zbriten (P +Q) :
1	Pjesëmarrje në banka e institucione financiare (P):
--	Pjesëmarrje mbi 10 për qind në kapitalin e tyre ose nën 10 për qind por që ushtron një ndikim të rëndësishëm mbi të duke shtuar edhe të drejtat e varura në të njëjtën bankë ose institucion financiar .
--	Shuma e pjesëmarrjeve, që nuk plotësojnë kushtet e mësipërme , së bashku me të drejtat e varura të tjera ndihmojnë të njëjtave banka ose institucione financiare i zbritet 10 për qind të fondeve të veta (C+J) :
	Për shembull $M = (C+J) * 10\%$
--	Mbetur pas zbritjes : $N = (L - M)$ n.q.s. është pozitive .
	Nëntotali $P = (K+N)$
2	Garancitë e dhëna fondeve të garancive reciproke sipas kushteve të bankës qendrore.
	Nëntotali i pjesës që zbritet është (P+Q)
	Llogaritja përmbljedhëse e kapitalit bazë dhe e kapitalit shtesë pas zbritjes IV :
1	N.q.s. $J \leq (P+Q)$ atëherë :
--	Kapitalit shtesë pas zbritjes $JA = 0$
--	Kapitalit bazë $CA = C + J - (P+Q)$
2	N.q.s. $J > (P+Q)$ atëherë :
--	Kapitalit shtesë pas zbritjes $JA = J - (P+Q)$
--	Kapitalit bazë $CA = C$
	Totali i kapitalit bazë dhe i kapitalit shtesë : $E = (JA+CA)$

	¹Totali i kapitalit bazë dhe i kapitalit shtesë : $EA = (JA+CA)$
	Zbritjet sipas rregulloreve përkatëse :
	- rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, miratuar me vendimin nr.13, datë 21.02.01 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
	- rregullorja “Për pjesëmarrjet në kapitalin e shoqërive të tregut nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin nr.107, datë 03.11.99 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
	- rregullorja “Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillester minimal për veprimtaritë e lejuara të bankave dhe të degëve të bankave të huaja të licencuara”, miratuar me vendimin nr 22.04.99 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
	Totali i kapitalit bazë dhe i kapitalit shtesë pas zbritjes

¹ Ndryshimi është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.40, datë 16.05.2001.

RREGULLORE

PËR

RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

Miratuar me vendimin nr. 58 datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin nr.86, datë 07.11.2001, ndryshuar me vendimin nr.72, datë 11.09.2002, ndryshuar me vendimin nr.30, datë 16.04.2003 dhe me vendimin nr.82, datë 08.10.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

KAPITULLI I

TË PËRGJITHSHME

- 1- Kjo rregullore është hartuar në zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për "Bankën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 2- Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Këto subjekte, për efekt të kësaj rregulloreje do të quhen "bankë".
- 3- Qëllimi i kësaj rregulloreje është llogaritja e raportit ndërmjet kapitalit rregullator me aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rreziqet që quhet "Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit" dhe vendosja e një kufiri minimal të raportit që quhet "Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit".
- 4- Përcaktime:
 - 4.1. **Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit** është raporti i kapitalit rregullator me aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun përkatës, i shprehur në përqindje.
 - 4.2. **Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit** është raporti i kapitalit bazë me aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun përkatës, i shprehur në përqindje.

KAPITULLI II

5. Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12 për qind. ¹Inspektorët e Bankës së Shqipërisë, kur gjykojnë të arsyeshme, mund të kërkojnë për çdo bankë, për afate kohore të përcaktuara ose të pacaktuara, një raport mjaftueshmërie më të madh se raporti minimal.

ELEMENTET PËRBËRËSE

- 5.1. Në numëruesin e raportit bën pjesë kapitali rregullator i bankës i llogaritur sipas metodologjisë të përshkruar në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës".
- 5.2. Në emëruesin e raportit bëjnë pjesë shumat e elementeve të ponderuara si vijon:
 - 5.2.1. aktivet e bilancit;
 - 5.2.2. zërat jashtë bilancit që përfaqësojnë kontratat e instrumenteve financiare me afat, të lidhura me normat e interesit dhe me kurset e këmbimit;
 - 5.2.3. zërat e tjerë jashtë bilancit.
6. ZERAT QË ZBRITEN
Nga aktivet e bilancit përpara ponderimit zbriten zërat vijues:
 - 6.1. zërat e aktivitetit të bilancit që bëjnë pjesë në kapitalin rregullator si elemente zbritëse;
 - 6.2. zërat e aktivitetit të bilancit që bëjnë pjesë në portofolin e tregtueshëm të titujve që analizohen në kuadrin e rreziqeve të tregut;
 - 6.3. fondet e rezervës specifike, të krijuara për kreditë standarde në të cilat përfshihet dhe

¹ Shtuar me vendimin nr.86, datë 07.11.2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

- 6.4. kredia e pakthyer në afat (kësti) dhe kreditë në ndjekje nga aktivet përkatëse; pjesa e rezervave të rivlerësimit apo zërave të ngjashëm me to, të lidhura drejtpërdrejt me zërat përkatës të aktivitetit të bilancit që klasifikohen si elemente përbërëse të kapitalit shtesë, por nuk përfshihen në të si kufizim i pikës 2.2.2.1. të udhëzimit "Për kapitalin rregullator të bankës".

7. METODOLOGJIA E LLOGARITJES

- 7.1. Në formularin 1 llogaritet totali e aktiveve të ponderuara me rrezikun.
7.2. Në formularin 2 llogaritet totali i zërave jashtë bilancit të lidhur me normat e interesit dhe me kurset e këmbimit të ponderuara me rrezikun.
7.3. Në formularin 3 llogaritet totali i zërave të tjerë jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun.
7.4. Në formularin 4 llogaritet shuma e aktiveve dhe e zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun.
7.5. Në formularin 5 llogaritet raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit dhe bëhet krahasimi me raportin minimal të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

8. MËNYRA E LLOGARITJES

- 8.1. Ponderimi i aktiveve të bilancit bëhet si vijon:
8.1.1. aktivet pa rrezik ponderohen me koeficient 0 për qind;

Përfshihen si të tillë të gjithë zërat e mëposhtëm:

- a) arka dhe zërat e ngjashëm me të,
b) të drejtat ndaj bankës qendrore dhe ndaj Qeverisë Shqiptare kur këto shprehen në monedhën kombëtare,
c) të drejtat ndaj bankave qendrore dhe qeverive qendrore të vendeve të zonës A (siç përcaktohet në pikën 12.1.) dhe shprehimisht të garantuara prej tyre dhe nga institucionet ndërkombëtare (siç përcaktohet në pikën 12.3),
d) të drejtat ndaj bankave qendrore dhe qeverive qendrore të vendeve të zonës B (siç përcaktohet në pikën 12.2.) të nënshkuara, të garantuara, të financuara në monedhën e vendit huamarrës,
e) të drejtat ndaj një debitori të zonës B shprehimisht të garantuara nga bankat qendrore dhe nga qeveritë e vendeve të zonës B të nënshkuara, të garantuara, të financuara në monedhën e tyre kombëtare,
f) të drejtat ndaj Komunitetit Evropian dhe shprehimisht të garantuara prej tij,
g) aktive të garantuara me kolateral ose me garanci të ngjashme si vijon:
i) letra me vlerë të emetuara nga bankat qendrore, nga qeveritë e vendeve të zonës A ose nga Komuniteti Evropian;
ii) depozita pranë bankave huadhënëse;
iii) çertifikata depozite ose instrumente të ngjashme të emetuara nga dhe të depozituara pranë bankave huadhënëse;
h)² të drejtat ndaj Bankës së Shqipërisë ose të garantuara plotësisht prej saj në valutë.
i)³ të drejtat në lekë dhe/ose në valutë ndaj Export-Import Bank of the United States ("Ex-Im Bank") ose të garantuara plotësisht prej saj.

- 8.1.2. aktivet me rrezik të ulët ponderohen me koeficient 20 për qind;

Përfshihen si të tillë të gjithë zërat e mëposhtëm:

- a) të drejta me afat deri në maturim jo më shumë se një vit ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë,
b) të drejta ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit (siç përcaktohet në pikën 12.4.),
c) të drejta ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në vendet e zonës A dhe shprehimisht të garantuara prej tyre, me përjashtim të rastit kur këto të drejta, sipas rregullave në fuqi, përfshihen në kapitalin rregullator të tyre,
d) të drejta ndaj organeve të qeverisjes qendrore rajonale dhe lokale, të vendeve të zonës A,

² Ndryshuar me vendimin nr. 30, datë 16.04.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

³ Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 08.10.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

- e) të drejta me afat deri në maturim jo më shumë se një vit ndaj bankave dhe institucioneve financiare të vendeve të zonës B ose të drejta, mbi ose të garantuara shprehimisht nga bankat qendrore dhe nga qeveritë qendrore të vendeve të zonës B, me përjashtim të rastiit kur këto të drejta sipas rregullave në fuqi përfshihen në kapitalin rregullator të tyre,
- f) aktive të garantuara me kolateral ose me garanci të ngjashme si vijon:
 - i) letra me vlerë të emetuara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit;
 - ii) letra me vlerë të emetuara nga organet e qeverisjes lokale dhe rajonale të vendeve të zonës A;
 - iii) depozita pranë bankave të vendeve të zonës A;
 - iv) çertifikata depozite ose instrumente të ngjashme të emetuara nga bankat e vendeve të zonës A;
- g) vlera në udhëtim dhe të drejta mbi instrumentet e pagesës menjëherë të ekzekutueshme (çeqe udhëtarësh , karta krediti etj.).

8.1.3. aktivet me rrezik të mesëm ponderohen me koeficient 50 për qind;

Përfshihen si të tillë të gjithë zërat e mëposhtëm:

- a) pronat e patundshme të poseduara nga banka, të drejta të siguruara me hipotekën e parë të pronave të patundshme kur për to ekziston një treg shitjeje me vlerë të plotë (kredi hipotekare);
- b) operacionet e qirasë financiare të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara;
- c) llogaritë rregulluese në aktiv (të pakompensuara me ato të pasivit), të cilat nuk janë të lidhura me një kundërparti të saktë.

8.1.4. aktivet me rrezik të lartë ponderohen me koeficient 100 për qind;

Përfshihen si të tillë të gjithë zërat e mëposhtëm:

- a) ⁴të drejtat ndaj Qeverisë Shqiptare ose të garantuara plotësisht prej saj në valutë;
- b) të drejtat me afat maturimi mbi një vit ndaj bankave që veprojnë në Shqipëri;
- c) të drejtat ndaj bankave qendrore dhe ndaj qeverive të vendeve të zonës B, të cilat nuk janë nënshkruar, garantuar apo financuar në monedhën e vendit huamarrës;
- d) të drejtat ndaj organeve të qeverisjes lokale të vendeve të zonës B;
- e) të drejtat me afat maturimi mbi një vit ndaj bankave të tjera të vendeve të zonës B;
- f) ⁵kredi të tjera ndaj klientelës dhe të drejta të tjera, përveç atyre të përmendura më sipër, të vlerësuara nga vetë banka;
- g) aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe ato aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, të cilat nuk janë zbritur nga kapitali shtesë;
- h) të gjitha pjesëmarrjet në masën 100 për qind, që nuk bëjnë pjesë në grupin e pjesëmarrjeve që zbriten nga kapitali rregullator.

8.2. Ponderimi i zërave jashtë bilancit që përfaqësojnë kontrata financiare me afat, lidhur me normat e interesit dhe me kurset e këmbimit vlerësohen sipas metodës “të vlerësimit të rrezikut fillestar”, në rastin kur midis palëve nuk ka marrëveshje të dyanshme rinovimi ose kompensimi:

8.2.1. kontratat financiare me afat lidhur me normat e interesit ponderohen mbi shumën e kontraktuar si vijon:

- 8.2.1.1. me 0.5 për qind kur afati i maturimit është më pak se 1 vit;
- 8.2.1.2. me 1 për qind kur afati i maturimit është nga 1 deri në 2 vjet;
- 8.2.1.3. me 1 për qind për çdo vit shtesë kur afati i maturimit është mbi 2 vjet;

8.2.2. kontratat financiare me afat lidhur me kurset e këmbimit ponderohen mbi shumën e kontraktuar si vijon:

- 8.2.2.1. me 2 për qind kur afati i maturimit është më pak se 1 vit;
- 8.2.2.2. me 5 për qind kur afati i maturimit është nga 1 deri në 2 vjet;
- 8.2.2.3. me 3 për qind për çdo vit shtesë kur afati i maturimit është mbi 2 vjet.

⁴ Ndryshuar me vendimin nr. 30, datë 16.04.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

⁵ Shtuar me vendimin nr.86, datë 07.11.2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

- 8.3. Ponderimi i zërave jashtë bilancit të tjerë (angazhimet e dhëna):
- 8.3.1. zërat jashtë bilancit me rrezik të lartë të ponderuar me koeficient 100 për qind janë si vijon:
- garanci të dhëna për financim kredie në zëvendësim të një banke tjetër që e ka dhënë fillimisht;
 - pranimet bankare;
 - xhirime me firmë në shpinë që nuk përmbajnë firmë të një banke tjetër;
 - transferime me të drejtë rekursi për blerësin;
 - angazhime për çelje kredie të pakushtëzuar ose të kushtëzuar në rastin e letërkredive në zëvendësim të një banke tjetër origjinuese;
 - angazhime për blerje në një afat të caktuar, angazhimet e pakushtëzuara për të blerë çdo aktiv me një çmim të fiksuar në avancë;
 - letra me vlerë për t'u marrë në kuadër të një operacioni dhënieje me zgjedhje për t'u riblerë ose për t'u rimarrë;
 - zëra të tjerë me rrezik të madh ⁶të vlerësuar nga vetë banka.
- 8.3.2. zërat jashtë bilancit me rrezik të mesëm të ponderuar me koeficient 50 për qind janë si vijon:
- angazhime për të paguar kredinë dokumentare, të dhënë ose të konfirmuar, pa garancinë e mallrave korrespondues;
 - garancitë për finalizim të mirë të operacionit dhe angazhimet doganore dhe fiskale me kusht që të mos përbëjë zëvendësim të dhënësit fillestar të kredisë;
 - angazhimet për të marrë aktivet e dhëna për sa kohë mbajtësi i tyre ka një opsion rishitjeje;
 - angazhime për çelje letërkredie;
 - angazhime për lehtësi në llogari të zbuluara të papërdorura, që kanë të bëjnë me huadhënien, me blerjen e letrave me vlerë, të pranimeve bankare me afat fillestar maturimi më shumë se një vit. Lehtësitë në llogari të zbuluara janë të konfirmuara dhe të pakthyeshme;
 - angazhime për lehtësi në emetimin e letrave me vlerë;
 - zëra të tjerë me rrezik të mesëm ⁷të vlerësuar nga vetë bankat .
- 8.3.3. zërat jashtë bilancit me rrezik të moderuar të ponderuar me koeficient 20 për qind janë si vijon:
- angazhime për kredinë dokumentare, të dhënë ose të konfirmuar, me garancinë e mallrave korrespondues dhe operacione të tjera të ngjashme;
 - zëra të tjerë me rrezik të moderuar, ⁸të moderuar dhe të vlerësuar nga vetë banka.
- 8.3.4. zërat jashtë bilancit me rrezik të vogël të ponderuar me koeficient 0 për qind:
- angazhime për lehtësi në llogari të zbuluar të papërdorura, që kanë të bëjnë me huadhënien, me blerjen e letrave me vlerë, të pranimeve bankare me afat fillestar maturimi jo më shumë se një vit. Lehtësitë në llogari të zbuluar mund të anulohen në çdo kohë, pa kushte dhe pa paralajmërim;
 - zëra të tjerë me rrezik të vogël ⁹të vlerësuar nga vetë banka.

9. PERIUDHA E RAPORTIMIT

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit raportohet në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, çdo tremujor me të dhënat e bilancit kontabël të periudhës përkatëse.

10. KONTROLLI

Kur konstatohet se raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është nën nivelin e përcaktuar nga pika 5, banka:

- raporton çdo muaj në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, për madhësinë e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit për një periudhë kohore jo më pak se 6 muaj;
- raporton çdo muaj në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, raportin e modifikuar të mjaftueshmërisë së kapitalit, që shprehet në përqindje dhe është jo më i vogël se 6 për qind;

⁶ Shtuar me vendimin nr.86, datë 07.11.2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

⁷ Shtuar me vendimin nr.86, datë 07.11.2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

⁸ Shtuar me vendimin nr.86, datë 07.11.2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

⁹ Shtuar me vendimin nr.86, datë 07.11.2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

- 10.3. të përmbushë detyrimin e pikës 5 jo më vonë se fundi i muajit pasardhës;
- 10.4. në rast mospërmbushjeje nga bankat e detyrimeve të pikës 10.3. atëherë Banka e Shqipërisë vepron ndaj saj në përputhje me ligjin nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 44, neni 45 pika 3.

11. MËNYRA E RAPORTIMIT

Çdo bankë është e detyruar të raportojë në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, sipas formularëve të mëposhtëm, të cilët janë pjesë përbërëse e sistemit raportues.

12. PËRCAKTIME

12.1. Lista e vendet të zonës "A" është:

¹⁰Australia, Austria, Arabia Saudite, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Irlanda, Islanda, Italia, Japonia, Kanadaja, Luksemburgu, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, Portugalia, Spanja, Suedia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zelanda e Re, Zvicra .

12.2. Të gjitha vendet e tjera që nuk përmenden në këtë listë i përkasin zonës B.

12.3. Lista e institucioneve ndërkombëtare:

- Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare (BIS);
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH);
- Banka Botërore (WB);
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF);
- Komisioni i Komunitetit Evropian ;
- të tjera institucione nga Banka Botërore.

12.4. Lista e bankave shumëpalëshe të zhvillimit :

- Banka Evropiane e Investimit (BEI);
- Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BIRD-WB);
- Shoqëritë financiare ndërkombëtare;
- Banka Ndëramerikane e Zhvillimit;
- Banka Aziatike e Zhvillimit;
- Banka Afrikane e Zhvillimit;
- Fondi i Zhvillimit Social i Këshillit të Evropës;
- Banka Nordike e Investimit;
- Banka e Zhvillimit të Karaibeve;
- Fondi Evropian i Investimeve (FEI);
- Shoqëritë Ndëramerikane të Investimeve.

13. Rregullorja nr. 2, datë 16.08.1996 "Për mjaftueshmërinë e fondeve të veta (kapitalit) të bankës", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

14. Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.06.1999.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

¹⁰ Ndryshuar me vendimin nr.72, datë 11.09.2002 të Këshillit Mbikëqyrës.

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.1

ZËRAT E AKTIVIT TË PONDERUAR ME RREZIKUN

(në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Kodi	EMËRTIMI
	1 – Aktivet pa rrezik me koeficient ponderimi 0 për qind:
	-arka dhe zërat e ngjashëm me të;
	-të drejtat ndaj bankës qendrore dhe Qeverisë të Republikës së Shqipërisë, kur këto shprehen në monedhën kombëtare;
	-të drejtat ndaj bankave qendrore dhe qeverive të vendeve të zonës A (P.12.1.) ose shprehimisht të garantuara prej tyre dhe r institucionet ndërkombëtare (P.12.3.);
	-të drejtat ndaj bankave qendrore dhe qeverive të vendeve të zonës B (P.12.2.) të nënshkruara, të garantuara apo të financuara në monedhën e vendit huamarrës;
	-të drejtat ndaj një debitori të zonës B shprehimisht të garantuara nga bankat qendrore dhe nga qeveritë e vendeve të zonës B të nënshkruara, të garantuara apo të financuara në monedhën e tyre kombëtare;
	-të drejtat ndaj Komunitetit Evropian ose shprehimisht të garantuara prej tij;
	-aktive të garantuara me kolateral ose me garanci të ngjashme; -letra me vlerë të emetuara nga bankat qendrore, nga qeveritë vendeve të zonës A ose nga Komuniteti Evropian; -depozita pranë bankave huadhënëse; -çertifikata depozite ose instrumente të ngjashme të emetuara nga dhe të depozituara pranë bankave huadhënëse.
	2 – Aktive me rrezik të ulët me koeficient ponderimi 20 për qind:
	-të drejta ndaj institucioneve të kreditit me afat deri në maturim më shumë se një vit që veprojnë në Republikën e Shqipërisë;
	-të drejta ndaj bankave multilaterale të zhvillimit të listuara sipas (P.12.4.);
	-të drejta ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në vendet e zonës A ose shprehimisht të garantuara prej tyre, në përjashtim të rastit kur këto të drejta, sipas rregullave në fuqi përfshihen në fondet e veta të institucioneve të kreditit;
	-të drejtat ndaj organeve të qeverisjes rajonale dhe lokale të vendeve të zonës A;
	-të drejta me afat deri në maturim jo më shumë se një vit ndaj bankave dhe institucioneve financiare të vendeve të zonës ose të garantuara shprehimisht nga bankat qendrore dhe qeveritë e vendeve të zonës B, me përjashtim të rastit kur këto të drejta, sipas rregullave në fuqi, përfshihen në kapitalin rregullator të bankave;

	<p>-aktive të garantuara me kolateral ose me garanci të ngjashme;</p> <p>-letra me vlerë të emetuara nga bankat multilaterale të zhvillimit;</p> <p>-letra me vlerë të emetuara nga organet e qeverisjes lokale dhe rajonale të vendeve të zonës A;</p> <p>-depozita pranë bankave dhe institucioneve financiare të vendeve të zonës A , të ndryshme nga ai huadhënës;</p> <p>-çertifikata depozitash ose instrumente të ngjashme të emetuara nga bankat dhe institucionet financiare të vendeve të zonës A, të ndryshme nga ai huadhënës;</p>
	-vlera në udhëtim dhe të drejta mbi instrumentet e pagesës, menjëherë të ekzekutueshme (çeçe udhëtarësh, karta krediti etj)
	3-Aktive me rrezik të mesëm me koeficient ponderimi 50 përqind:
	-kredi hipotekare dhënë klientelës për blerjen , lëshimin me qira ose përmirësimin e ndërtesës, e cila është objekt hipoteke (sipas 8.1.3.a);
	-operacionet <i>leasing</i> të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (sipas 8.1.3.b);
	-llogaritë rregulluese në aktiv (të pakompensuara me ato të pasiveve të cilat nuk janë të lidhura me një kundërparti të saktë.
	4-Aktive me rrezik të lartë me koeficient ponderimi 100 përqind:
	-të drejtat ndaj Qeverisë Shqiptare dhe Bankës së Shqipërisë ose të garantuara plotësisht prej tyre kur ato janë të nënshkruara, të garantuara, të financuara në valutë;
	-të drejtat me afat deri në maturim mbi një vit të bankave që veprojnë në Shqipëri;
	-të drejtat ndaj bankave qendrore dhe qeverive të vendeve të zonës B, të cilat nuk janë nënshkruar, garantuar apo financiarmonedhën e vendit huamarrës;
	-të drejtat ndaj organeve të qeverisjes lokale të vendeve të zonës B;
	-të drejtat me afat deri në maturim mbi një vit ndaj bankave të vendeve të zonës B;
	-kredi ndaj klientelës, të tjera, përveç atyre të përmendura më sipër;
	-aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara të cilat nuk janë zbritur nga kapitali rregullator;
	-të gjitha pjesëmarrjet në masën 100 përqind, që nuk bëjnë pjesë në grupin e pjesëmarrjeve që zbriten nga kapitali rregullator.
	TOTALI I AKTIVIT TË PONDERUAR ME RREZIKUN

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.2

ZËRAT JASHTË BILANCIT QË PËRFAQËSOJNË KONTRATAT E INSTRUMENTEVE FINANCIARE MBI NORMAT E INTERESIT DHE KURSET E KËMBIMIT TË PONDERUARA ME RREZIKUN

(në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

5-KONTRATA ME KURS KËMBIMI DHE NORMË INTERESI TË NDRYSHUESHME		k
1. Zëra me kurs këmbimi të ndryshueshëm:		
-me afat maturimi më pak se 1 vit;		
-me afat maturimi 1 deri në 2 vjet;		
-me afat maturimi mbi 2 vjet për çdo vit pasues.		
2. Zëra me normë interesi të ndryshueshme:		
-me afat maturimi më pak se një vit;		
-me afat maturimi 1 deri në 2 vjet;		
-me afat maturimi mbi 2 vjet për çdo vit pasues.		
TOTALI JASHTË BILANCIT I PONDERUAR ME RREZIKUN		

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.3

ZËRA TË TJERË JASHTË BILANCIT

(në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Kodi	EMËRTIMI	I
	1 – Zërat jashtë bilancit me rrezik të lartë me koeficient ponderimi 100 për qind:	
	-garanci të dhëna për financim kredie në zëvendësim të një banke tjetër që e ka dhënë fillimisht;	
	-pranimet bankare;	
	-xhirime me firmë në shpinë që nuk përmbajnë firmë të një banke tjetër;	
	-transferime me të drejtë rekursi për blerësin;	
	-angazhime për çelje kredie të pakushtëzuar ose të kushtëzuar në rastin e letërkredive në zëvendësim të një banke tjetër që e ka dhënë fillimisht;	
	-angazhime për blerje me afat të caktuar: angazhimet e pakushtëzuara për të blerë çdo aktiv me një çmim të fiksuar në avancë;	
	-letra me vlerë për t'u marrë, në kuadër të një operacioni dhënieje me zgjedhje për t'u riblerë ose rimarrë;	
	-zëra të tjerë me rrezik të madh.	
	2 – Zërat jashtë-bilancit me rrezik të mesëm me koeficient ponderimi 50 për qind:	
	-angazhime për të paguar kredinë dokumentare , të dhëna ose të konfirmuara, pa garancinë e mallrave korrespondues;	
	-garancitë për finalizim të mirë të operacionit dhe angazhimet doganiere dhe fiskale me kusht që të mos përbëjë zëvendësim të dhënësit fillestar të kredisë;	
	-angazhimet për të marrë aktivet e dhëna për sa kohë mbajtësi i tyre ka një opsion rishitjeje;	
	-angazhime për çelje letërkredie;	
	-angazhime për lehtësira në llogari të zbuluar të papërdorura. Këto angazhime kanë të bëjnë me huadhënien, blerjen e letrave me vlerë, të pranimeve bankare me afate fillestare maturimi më shumë se një vit. Lehtësirat në llogari të zbuluar janë të konfirmuara dhe të pakthyeshme;	
	-angazhime për lehtësira në emetimin e letrave me vlerë;	
	-zëra të tjerë me rrezik të mesëm.	
	3 – Zërat jashtë-bilancit me rrezik të moderuar me koeficient ponderimi 20 për qind:	
	-angazhime për kredinë dokumentare, të dhënë ose të konfirmuar, me garancinë e mallrave korrespondues dhe operacione të tjera të ngjashme;	
	-zëra të tjerë me rrezik të moderuar.	
	4 – Zërat jashtë-bilancit me rrezik të ulët me koeficient ponderimi 0 për qind:	
	-angazhime për lehtësira në llogari të zbuluar të papërdorura. Këto angazhime kanë të bëjnë me huadhënien, blerjen e letrave me vlerë, të pranimeve bankare me afat fillestar maturimi jo më shumë se një vit. Lehtësirat në llogari të zbuluar mund të anulohen në çdo kohë, pa kushte dhe pa paralajmërim;	
	-zëra të tjerë me rrezik të vogël.	

Totali i zërave jashtë bilancit të tjerë

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.4

SHUMA E ZËRAVE TË AKTIVIT, SHUMA E ZËRAVE JASHTË BILANCIT TË PONDERUAR ME RREZIKUN PËRKATËS DHE SHUMA E ZËRAVE TË TJERË JASHTË BILANCIT

(në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	LLOJI I FORMULARIT	EMËRTIMI
1	Formulari 1	Totali i zërave të aktivit të ponde
2	Formulari 2	Totali i zërave jashtë bilancit që kontratat e instrumenteve financ interesit dhe kurset e këmbimit t rrezikun
3	Formulari 3	Totali i zërave të tjerë jashtë bile
		SHUMA (1 + 2 + 3)

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.5

RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

(në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	EMËRTIMI
1	Kapitali rregullator i llogaritur sipas udhëzimit "Për kapitalin bankës"
2	Shumat e raportuara sipas formularit 4
3	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit [(1 : 2)*100] (sh përqindje)
4	Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.6

RAPORTI I MODIFIKUAR I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

(në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	EMËRTIMI
1	Kapitali rregullator i llogaritur sipas udhëzimit "Për kapitalin bankës"
2	Kapitali bazë i llogaritur sipas kapitullit II të udhëzimit "Për kapitalin bankës"
3	Shumat e raportuara sipas formularit 4
4	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit [(1 : 3)*100] i shprehur
5	Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit [(2 : 3) përqindje]
6	Raporti minimal i modifikuar
7	Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit

RREGULLORE

PËR POZICIONET E HAPURA VALUTORE

Miratuar me vendim nr. 59, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr.118,
datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës .

1. TË PËRGJITHSHME

1. Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", kreu VII, neni 61 si dhe ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 " Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 27.
2. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i nivelit maksimal të pozicioneve të hapura valutore neto për subjekte të tilla si banka dhe degë të bankave të huaja, të cilat janë licencuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer veprimtari bankare në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto subjekte, për efekt të kësaj rregulloreje do të quhen "bankë".
3. Qëllimi i saj është përcaktimi i rregullave për matjen e pozicionit të hapur valutore për bankat. Këta rregulla synojnë kufizimin e humbjeve të bankave nga transaksionet në valutë dhe në metale të çmuara .
4. Kuptimi i termave të mëposhtëm do të jetë:

Të drejta gjithsej konsiderohen shumat në valutë të aktiveve në bilanc, plus të drejta të lindura nga zërat jashtë bilancit (angazhimet e dhëna).

Detyrime gjithsej konsiderohen shumat në valutë të pasiveve në bilanc plus detyrimet e lindura nga zërat jashtë bilancit (angazhimet e marra).

"Pozicion i hapur valutore neto në një valutë të caktuar " është shuma ekuivalente në lekë e diferencës midis të drejtave gjithsej dhe detyrimeve gjithsej të bankës në këtë valutë .

Banka ka një "pozicion të hapur valutore neto në blerje" (*long*), kur shuma ekuivalente në lekë e të drejtave gjithsej të saj në një valutë të caktuar, tejkalon shumën ekuivalente në lekë të detyrimeve gjithsej të saj në këtë valutë.

Banka ka një "pozicion të hapur valutore neto në shitje" (*short*), kur shuma ekuivalente në lekë e detyrimeve gjithsej të saj në një valutë të caktuar, tejkalon shumën ekuivalente në lekë të të drejtave gjithsej të saj në këtë valutë.

"Pozicion i hapur valutore total neto" është diferenca midis shumës së "pozicioneve të hapura valutore neto në blerje" (*long*) dhe shumës së "pozicioneve të hapura valutore neto në shitje" (*short*).

¹Metalet e çmuara të mbajtura në një formë të negociueshme trajtohen si monedha të huaja.

²Për të llogaritur pozicionet e hapura të gjitha monedhat që këmbehen me kurs fiks me euron (janë përbërësit e saj) konvertohen në euro dhe në Bankën e Shqipërisë raportohet pozicioni neto në euro. Monedhat konvertohen në euro me kursin fiks të publikuar.

Në pasqyrat e raportimit të pozicionit në monedhë të huaj, monedhat përbërëse të euros do të zëvendësohen me euro (pra nuk do të raportohen në DM,ILT etj.).

Me "Pozicion strukturor në valutë" kuptojmë shumën ekuivalente në lekë të elementeve të mëposhtme:

- a) teprica e rubrikës "Interesat në pjesëmarrje";
- b) teprica e rubrikës "Filialet";
- c) teprica e rubrikës "Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara dhe të trupëzuara";
- e) dhurimi i kapitalit për degët e bankës të hapura jashtë vendit .

¹ Ndryshim i bërë me vendimin nr.118, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

² Ndryshim i bërë me vendimin nr.118, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

Me "Pozicion operacional në valutë", kuptojmë shumën ekuivalente në lekë të të gjitha elementeve që nuk bëjnë pjesë në elementet e "Pozicionit strukturor në valutë".

Me "Pozicion global në valutë", kuptojmë shumën e "Pozicionit strukturor në valutë" dhe të "Pozicionit operacional në valutë".

II. NORMAT E LEJUARA PËR POZICIONET E HAPURA NË VALUTË.

1. Të gjitha bankat e licencuara për të kryer transaksione bankare me monedha të huaja duhet të mbikëqyrin dhe të mos tejkalojnë në fund të çdo dite pune normat e mëposhtme:
 - 1.1³ një raport maksimal prej 20 për qind të pozicionit të hapur valutor neto në çdo monedhë të huaj ndaj kapitalit rregullator të bankës;
 - 1.2⁴ një raport maksimal prej 30 për qind të pozicionit të hapur valutor total neto ndaj kapitalit rregullator të bankës.

III. LLOGARITJA E TREGUESVE

1. Kapitali rregullator i bankës përcaktohet në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për kapitalin rregullator të bankës".
2. Pozicionet të hapura valutore në blerje ose në shitje përcaktohen duke marrë parasysh elementet e mëposhtme:
 - 2.1. diferenca midis të drejtave dhe detyrimeve në valutë, përfshirë interesat e përlogaritur, kapitalin e paguar dhe primet e tij në valutë;
 - 2.2. zërat jashtë bilancit në valutë.
3. Në përcaktimin e pozicioneve valutore, të dhënat merren nga librat e tyre kontabël dhe vlerësimi i tyre bëhet me kursin e ditës së fundit të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë.
4. Në llogaritjen e "pozicionit të hapur valutor neto në blerje dhe në shitje" dhe të "pozicionit të hapur valutor total neto" përjashtohen elementet e mëposhtme:
 - 4.1. operacionet në valutë në të cilat rreziku i këmbimit valutor mbulohet nga shteti;
 - 4.2. pozicioni strukturor në valutë kur burimi i financimit të tij është në monedhë vendase (Lek).

IV. RREGULLA PËR ADMINISTRIMIN E POZICIONIT VALUTOR

1. Bankat që veprojnë rregullisht me monedha të huaja duhet të kenë:
 - 1.1 një sistem të përhershëm kontabilizimi me qëllim që të regjistrojnë transaksionet, të llogarisin rezultatet dhe të përcaktojnë një pozicion total të këmbimit valutor si dhe pozicionin neto sipas çdo monedhe;
 - 1.2. një sistem mbikëqyrjeje që të administrojë rreziqet në vazhdim, kufijtë e përcaktuar nga institucioni si edhe kushtet për të siguruar që këto norma janë respektuar;
 - 1.3. një sistem të përhershëm kontrolli, i cili të sigurojë se janë zbatuar procedurat e nevojshme për të plotësuar masat e përmendura më sipër.
2. Bankat do të përgatisin politikat e shkruara të aktivitetit me monedhat e huaja. Këto politika të shkruara të jenë të miratuara nga këshilli drejtues i bankës dhe të përmbajnë, të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - 2.1. llojet e transaksioneve në valutë që janë të autorizuara të kryejnë;
 - 2.2. kufijtë e brendshëm të bankës për mbajtjen e pozicioneve të hapura valutore.
 - 2.3. sistemin raporues të brendshëm;
 - 2.4. strukturën dhe masat organizative që sigurojnë ndarjen e aktivitetit, të kompetencave dhe të përgjegjësisë në lidhje me ata persona që janë përgjegjës për kryerjen e operacioneve valutore;
 - 2.5. rregulla të tjerë lidhur me kriteret dhe me kompetencat për përcaktimin e kurseve të këmbimit për operacionet valutore, nivelin e njohurive të njerëzve që përfshihen në këto operacione si dhe teknikën e drejtimit të rreziqeve.

³ Ndryshim i bërë me vendimin nr.118, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

⁴ Ndryshim i bërë me vendimin nr.118, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

3. Bankat që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, politikat e përcaktuara më sipër i dërgojnë në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë brenda një muaji nga dita që kjo rregullore hyn në fuqi dhe brenda 10 ditësh nga data e ndryshimit të tyre, për bankat e reja që në fillimin e këtyre operacioneve.

V. RAPORTIMI

1. Në fund të çdo dite pune, të gjitha bankat e licencuara për të kryer operacione me monedhat e huaja përpilojnë një raport dhe e dërgojnë atë në Departamentin e Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë në lidhje me pozicionet e tyre valutore ditore të tregtimit.
2. Pozicionet e hapura valutore për çdo monedhë të huaj dhe në total, raportohen në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë çdo muaj. Raportimi behet sipas formularëve bashkëlidhur, të miratuar nga Banka e Shqipërisë, dhe janë pjesë përbërëse e sistemit raportues.

VI. DISPOZITA TË TJERA

1. Bankat, që në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje nuk respektojnë normat e vendosura, të hartojnë një program të pranueshëm në afate kohore për sjelljen e pozicioneve të hapura në normë. Këto plane i dërgohen për miratim Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes, i cili pasi i miraton ndjek zbatimin e tyre.
2. Për shkelje të normave të mbikëqyrjes "Për pozicionet e hapura valutore", bankat ose administratorët e tyre janë subjekte të neneve 44 dhe 45 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të hartojë udhëzimin metodik për llogaritjen e pozicioneve të hapura valutore.
4. Rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për pozicionet e hapura valutore" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrjes të Bankës të Shqipërisë nr. 42 datë 31.03.1998, shfuqizohet.
5. Kjo rregullore hyn në fuqi me 1.06.1999.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

POZICIONET VALUTORE

në mijë lekë

EMRI :

DATA E MBYLLJES :

Monedha	Shuma në monedhë të huaj					Kë
	Te drejtat	Detyrimet	Jashtë bilancit	Pozicioni neto		
				Në blerje	Në shitje	
USD						
DEM						
EURO						
GRD						
.....						
.....						
1. Shuma e pozicioneve në shitje						
2. Shuma e pozicioneve në blerje						
Pozicioni neto për të gjitha monedhat (1 - 2)						
Pozicioni neto në total (në % ndaj kapitalit rregulator)						
Kapitali rregulator						

Norma e miratuar për një monedhë

Norma e miratuar për të gjitha monedhat së bashku

Pergatiti (emer, mbiemer, firme)

Drejtuesi (emer, mbiemer, firme)

UDHËZIM METODIK

PËR RREZIQET NGA KËMBIMET VALUTORE

MIRATOHET
Shkëlqim CANI
Guvernator

Me qëllim që të zbatohen dispozitat e ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për pozicionet e hapura valutore" miratuar me vendimin nr. 59, datë 05.05.99 e Këshillit Mbikëqyrës, lëshohet ky udhëzim, i cili ka për qëllim të japë disa njohuri dhe udhëzime proceduriale në fushën e këmbimeve valutore.

I. KONCEPTI I RREZIQEVE NGA POZICIONET E HAPURA NGA KËMBIMET VALUTORE.

Bankat në veprimtarinë e tyre, për të plotësuar nevojat e klientëve të tyre në valutë të huaj, nëpërmjet dhënies së kredive, pranimit të depozitave, dhënies/ marrjes së garancive, angazhimeve ose nëpërmjet veprimeve *spot¹*, *forward²*, *swap*, *futures*, *options* etj., apo për të ndërmarrë veprime të këmbimeve valutore, nëse janë të licencuara për veprime të tilla nga Banka e Shqipërisë, marrin mbi vete rreziqe për arsye të ndryshmeve të kurseve të këmbimit pas kryerjes së transaksioneve në valutë të huaj.

Raportet e këmbimit të monedhave ndërmjet njëra-tjetrës, siç quhen ndryshe kurset e këmbimit të monedhave, duhet të kërkohen në tregun e brendshëm si dhe në tregun ndërkombëtar. Mjetet për të marrë informacion lidhur me këto raporte dhe për parashikimin e tyre në të ardhmen, janë të ndryshme. Rreziqet burojnë në rrugët e mëposhtme :

1. Pozicioni i hapur neto- gjatë operacioneve të këmbimit një bankë mund të ndodhet në një pozicion blerjeje ose shitjeje për një monedhë të caktuar. Këto pozicione janë njëlloj të rrezikshme ndaj kursit të këmbimit, por kushtëzohen nga drejtimi që merr kjo monedhë, domethënë nga forcimi apo nga zhvlerësimi i saj.

Një bankë ka një pozicion të hapur neto në një valutë të huaj kur aktivet e saj (duke përfshirë gjendjen në arkë, depozitat në bankat e huaja, depozitat në bankat qendrore apo në bankat e tjera, kreditë e dhëna në valutë, metalet e çmuara, kontratat për blerje *spot*, *forward*, *swap*, *future*, *option* etj. ose zëra të tjerë jashtë bilancit) dhe pasivet (duke përfshirë huatë e marra në valutë nga bankat e vendit apo të huaja, depozitat në valutë të të gjitha llojeve, kapitalin e paguar, kur ai paguhet në valutë, kontratat për shitje *spot* dhe *forward*, *swap*, *future*, *option* etj. ose zëra të tjerë jashtë bilancit) nuk janë të barabarta. Kur aktivet janë më të mëdha se pasivet kemi "pozicion në blerje" (+) (long), ndërsa kur pasivet janë më të mëdha se aktivet kemi "pozicion në shitje" (-) (short). Një "pozicion neto në blerje" në një valutë të caktuar (për shembull, lireta) që është duke u zhvlerësuar, do të çojë në një humbje të saj, nga ana tjetër një "pozicion neto në shitje" (-) në monedhë që vlerësohet (rriten kurset e këmbimit në monedhë kombëtare) përfaqëson një humbje, sepse për të plotësuar detyrimet ndaj të tretëve duhet më shumë monedhë kombëtare.

¹ Spot kemi kur operacioni kryhet pas dy ditësh pune nga data e marrëveshjes. Ky lloj operacioni përdoret në pjesën më të madhe të veprimeve bankare dhe si rezultat i kësaj në pjesën më të madhe të operacioneve kemi nënkuptimin e çmimeve spot kur nuk është theksuar ndonjë operacion tjetër.

² Forward kemi kur operacioni kryhet në një afat të dytë pas datës së marrëveshjes. Ky afat përcaktohet në momentin kur bëhet marrëveshja. Teorikisht çmimi forward duhet të jetë i barabartë me çmimin spot, por praktikisht nuk ndodh kështu. Në praktikë çmimi forward mund të jetë më i lartë (Premium) ose më i ulët (diskaunt) se çmimi i spotit. Veprimet forward në shumicën e rasteve, mund të shërbejnë për të shmangur rrezikun e ndryshimit të kurseve të këmbimit, si për fushën tregtare ashtu edhe për fushën financiare. Gjithashtu, forward mund të përdoret edhe për veprime spekulative sidomos në tregjet e kapitalit. Për të shmangur ngatërresat, kur flitet për operacionet forward të mirëfillta quhen "outright" për t'i dalluar ato nga operacionet forward si pjesë përbërëse e operacionit swap.

Shembull:

Në 1 janar kursi i këmbimit të usd në lekë ishte 1usd = 160 lekë. Banka ka një pozicion neto në shitje prej 2000 usd.

	Aktivet	Pasivet	Pozicioni
Usd	3.000	5.000	-2.000
Ekuivalenti në lekë	480.000	800.000	-320.000

Në qoftë se në 1 shkurt, vlera e lekut kundrejt usd zbritet (Leku zhvlerësohet) nga 160 në 170 lekë për 1 usd, pozicioni ekuivalent i lekut do të jetë:

	Aktivet	Pasivet	Pozicioni
Usd	3.000	5.000	-2.000
Ekuivalenti në lekë	510.000	850.000	-340.000

Përderisa vlera e lekut kundrejt usd bie, "pozicioni neto në shitje" bën që banka të rezultojë me humbje. Megjithëse vlera e aktiveve të bankës e shprehur në usd rritet në krahasim me një muaj më parë me 30.000 lekë = (510.000 - 480.000), kostoja e plotësimit të detyrimeve (pasivet) rritet për 50.000 lekë (850.000 - 800.000) duke çuar në një humbje neto prej 20 mijë lekësh (50.000-30.000).

2. Mospërputhja e maturitetit. Rreziku nga veprimet me monedhat e huaja mund të burojë, edhe si rrjedhojë e mospërputhjes së maturitetit, madje kur bankat nuk kanë "pozicion neto" të hapur (aktivet = pasivet). Mospërputhjet janë rrjedhojë e mosbalancimeve të maturiteteve të ardhshme, duke krijuar mospërputhje në blerjet apo në shitjet në atë valutë, ditore apo për periudha më të gjata. Për shembull, një mospërputhje maturiteti e aktiveve dhe e pasiveve të bankës, mund të çojë që një shumë e konsiderueshme nga një valutë e veçantë të arkëtohet në një kohë që pagesat me këtë valutë janë parashikuar të bëhen më vonë. Për ta ilustruar marrim një shembull :

Supozojmë që një bankë ka vendosur një depozitë në një bankë të huaj për 20.000 usd me një afat një muaj. Këto para i ka siguruar nga një depozitë që ka krijuar një klient i saj me afat 3 muaj. Si pozicion bilanci nuk kemi pozicion të hapur.

Aktivet	Pasivet
Depozitë në bankë të huaj 20.000 usd	Depozitë me afat 20.000 usd

Por, përsa i përket maturimit kemi një mospërputhje :

Aktivi	Pasivi
një muaj	tre muaj

Rasti i mësipërm quhet "mospërputhje pozitive ". Në këtë rast, me kalimin e afatit njëmuaj maturohet depozita që kemi vendosur në bankën e huaj, ndërkohë që maturimi i pasiveve (depozitë krijuar nga klientë) kërkon edhe 2 muaj të tjerë. Në këtë rast, banka duhet të vendosë nëse duhet:

- të vazhdojë të mbajë paratë në bankën korrespondente;
- të investojë ose të japë me to hua afatshkurtër;
- t'i shesë (*spot* ose *forward* etj.) derisa të mënjanohet mospërputhja (2 muaj).

Situatë e kundërt ngjjet kur mospërputhja pasqyron maturitet afatshkurtër të pasiveve e, për rrjedhojë, dalje shumë të konsiderueshme valute nevojiten para maturimit të aktiveve "mospërputhja negative". Ky rast përbën rrezik për likuiditetin e bankës. Kjo mund të paraqitet:

Aktivitet = Pasivitet në usd , por

Aktivitet	Pasivitet
3 muaj	1 muaj

Banka duhet t'i plotësojë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Prandaj, ajo ose duhet të marrë borxh ose të blejë (*spot*, *forward* etj.) me afat derisa të arrihet afati i maturimit të aktiveve. Vendimi për të mbyllur mospërputhjen apo për ta lënë atë të hapur, përcaktohet nëpërmjet analizës së normës së interesave të aplikueshëm *spot* dhe *forward*, ose midis dy kursesh këmbimi *forward*. Humbja apo fitimi potencial për bankën është përcaktuar nga ndryshimet e ardhshme apo aktuale në kursin "*swap*" midis kohës kur mospërputhja krijohet dhe mbyllet.

3. Besueshmëria dhe aftësia paguese e klientit. Kur një bankë futet në transaksion në një valutë të huaj, ajo duhet të sigurohet që pala tjetër(klienti) të jetë në situatë të mirë financiare dhe të jetë në gjendje për të plotësuar detyrimet e saj në kohën e maturimit.

II. MËNYRAT E ADMINISTRIMIT TË RREZIQEVE NGA KËMBIMET VALUTORE.

Bankat duhet t'i kenë të qarta rreziqet që përmbajnë transaksionet në valutë të huaj, të përcaktojnë me shkrim objektivat dhe politikat, në lidhje me shumën e rreziqeve që ato do të marrin përsipër, të krijojnë sistemin e nevojshëm të informacionit e të mbrojtjes për të pasqyruar e për të kontrolluar rreziqet. Si minimum, duhen përcaktuar kufijtë, treguesit që duhen raportuar, format e kontrollit për të siguruar ndjekjen në vazhdimësi të kufijve siç përcaktohen në rregullore.

1. Norma e mbikëqyrjes.

Nga Banka e Shqipërisë janë përcaktuar normat në përqindje të pozicioneve të hapura valutore në raport me kapitalin rregullator të bankës (përcaktuar në udhëzimin e Bankës të Shqipërisë "Për kapitalin rregullator të bankës"). Janë përcaktuar norma si për pozicionin e hapur valutore neto për çdo monedhë të huaj ashtu dhe për pozicionin e hapur valutore total neto. Çdo bankë, duhet të mbajë pozicionin e hapur valutore neto për çdo valutë të veçantë në fund të çdo dite dhe pozicionin e hapur valutore total, jo më të lartë se përqindjet e caktuara nga Banka e Shqipërisë ndaj kapitalit rregullator.

2. Ekspozimi i përgjithshëm i rreziqeve nga veprimet me monedhat e huaja.

Ekspozimi i përgjithshëm i rreziqeve nga veprimet me monedhat e huaja llogaritet si totali i shumave në lekë i të gjitha "pozicioneve neto në shitje" (-) ose i të gjitha "pozicioneve neto në blerje"(+), në valutat në të cilat banka përkatëse ka pozicion të hapur neto.

3.Mënyra e llogaritjes së ekspozimit të rreziqeve nga veprimet me monedhat e huaja.

Një shembull si bëhet llogaritja :

Bilanci kontabël më 31 dhjetor.

Valutat	Gjendja në aktivin e bilancit kontabël të bankës	Gjendja në pasivin e bila kontabël të bankës
Usd	11.000.000	10.000.
Dem	7.000.000	6.000.
Frf	19.000.000	20.000.
Nlg	2.200.000	2.000.
Bef	8.000.000	5.000.
Ats	1.000.000	2.000.
Jpy	7.200.000	7.000.

Nga llogaritja e kapitalit rregullator sipas udhëzimit "Për kapitalin rregullator të bankës", për të njëjtën periudhë rezulton se ato janë 350.000.000 lekë.

Duke përdorur kursin e këmbimit (kurs i cili përdoret për vlerësimin e bilancit kontabël sipas procedurave kontabël) në lekë të çdo valute për ditën raportuese, llogarisim pozicionet ekuivalente në lekë të valutave :

Valutat	Pozicionet në valutë	Kursi në lekë
Usd	-1.000.000	160
Dem	+ + 500.000	88
Frfr	-1.000.000	26
Nlg	+ 200.000	78
Bef	+3.000.000	4
Ats	-1.000.000	13
Jpy	+ 200.000	117

Mbledhim së bashku ekuivalentin në lekë për të gjitha "pozicionet në shitje" (-) të valutave:

Pozicioni në shitje i bankës në valutë	Ekuivalenti i tyre në lekë
Usd -1.000.000	-160.000.000
Frfr - 1.000.000	- 26.000.000
Ats - 1.000.000	- 13.000.000
Totali	-199.000.000

E njëjta rrugë ndiqet për "pozicionet në blerje" për të gjitha valutat që kanë këtë shenjë (+) :

Pozicioni në blerje i bankës në valutë (+)	Ekuivalenti i tyre në lekë
Dem + 500.000	+ 44.000.000
Nlg + 200.000	+ 15.600.000
Bef + 3.000.000	+ 12.000.000
Jpy + 200.000	+ 23.400.000
Totali	+ 95.000.000

Llogaritim raportin e pozicionit të hapur valutor neto për të gjitha monedhat e huaja së bashku, ndaj kapitalit rregullator :

$$R = 104.000.000 / 350.000.000 \times 100 = 29.7 \text{ p\%r qind.}$$

Këtë raport e krahasojmë me normën maksimale të lejuar për ekspozim total, që aktualisht është 20 p%r qind ç'ka rezulton se e kemi më të lartë se kufiri normativ i lejuar (29,7 p%r qind - 20 p%r qind).

Llogarisim raportin e ekspozimit të çdo valute në veçanti, për të cilat banka ka pozicione të hapura e, për rrjedhojë, është e ekspozuar kundrejt rreziqeve.

Ekuivalenca në lekë e pozicioneve të hapura të valutave (A)	Kapitali rregullator (B)
Usd lekë 160.000.000	350.000.00
Dem lekë 44.000.000	350.000.00
Frfr lekë 26.000.000	350.000.00
Nlg lekë 5.600.000	350.000.00
Bef lekë 12.000.000	350.000.00
Ats lekë 13.000.000	350.000.00
Jpy lekë 23.400.000	350.000.00

Çdo raport individual për valutat e krahasojmë me kufirin maksimal, që është përcaktuar nga Banka e Shqipërisë (aktualisht 10 p%r qind). Siç shihet për valutat Usd dhe Dem banka e ka tejkaluar kufirin e përcaktuar dhe duhet të marrë masa për respektimin e normës së përcaktuar.

III. RAPORTIMET PËR POZICIONET E HAPURA.

Evidencat raportuese të ndërtuara siç duhet, janë mjeti më i dobishëm për pasqyrimin dhe për administrimin e rreziqeve nga veprimet me monedhat e huaja. Drejtuesit e bankave duhet të marrin njoftim (evidencën) ditor për pozicionet e hapura për çdo valutë si dhe për të gjitha valutat së bashku.

IV. RIVLERËSIMI DHE PASQYRIMI KONTABËL.

Rivlerësimi i valutave bëhet me kursin e ditës së fundit, të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë. Fitimet apo humbjet që rezultojnë nga rivlerësimi i valutave kontabilizohen si e ardhur apo si shpenzim në llogarinë e rezultatit .

Të gjitha të dhënat për llogaritjen e pozicioneve të hapura në valutë merren nga bilanci kontabël i bankës për datën kur bëhet raportimi.

Nuk merren në konsideratë zërat në të cilët:

- a) rreziku valutor mbulohet nga shteti,
- b) të gjitha mjetet strukturore në valutë që shërbejnë për një periudhë të gjatë kohe siç janë interesat në pjesëmarrje (banka dhe institucione financiare), shumat e akorduara për degët jashtë vendit, aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara kur burimi i financimit të tyre është në monedhën vendase (lekë). Gjithashtu, duhen mbajtur parasysht dhe duhen respektuar standardet e mbajtjes së kontabilitetit në valutë dhe në lekë, dhe se zërat e poshtëshënuar janë përmbledhës dhe ata mund të kenë nënzëra për çdo monedhë të huaj.

Çfarë zërash të bilancit kontabël merren për bazë për llogaritjen e gjendjes së valutave të ndryshme:

NË AKTIV

- Zëri 1.1.1.2 : Arka në valutë.
- Zëri 1.1.1.4: Çeqe të udhëtarëve në monedha të tjera.
- **Grupi 1.1.2** : Marrëdhënie me Bankën e Shqipërisë (në valutë).
 - Zëri 1121 Llogaritë rrjedhëse.
 - Zëri 1122 Rezervat e detyrueshme.
 - Zëri 1123 Llogaritë e depozitave në bankat qendrore.
 - Zëri 1124 Hua dhënë bankave qendrore.
 - Zëri 1127 Llogari të pakthyera në afat në bankën qendrore.
 - Zëri 1128 Llogari të tjera me bankat qendrore.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlllogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.2** Bono thesari dhe bono të tjera të përshtatshme për rrefinancim me bankën qendrore.

- Grupi 121 Bono thesari.
- Grupi 122 Bono të tjera të përshtatshme për rrefinancim nga banka qendrore.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlllogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.3** Llogari rrjedhëse në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare.

- Grupi 131 Llogari rrjedhëse në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare rezidente.
- Grupi 132 Llogari rrjedhëse në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare jorezidente.
- Grupi 137 Llogari rrjedhëse të parregullta me bankat, me institucionet e kreditit dhe me institucionet e tjera financiare.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlllogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.4** Depozita në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare.

- Grupi 141 Depozita në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare rezidente.
- Grupi 142 Depozita në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare jorezidente.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.5** Hua dhënë bankave, institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare.

- Grupi 151 Hua dhënë bankave, institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare rezidente.
- Grupi 152 Hua dhënë bankave, institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare jorezidente.
- Grupi 153 Letra tregtare dhe shumat e të hollave të marra sipas një marrëveshjeje riblerje.
- Grupi 157 Hua të pakthyer në afat ndaj bankave, institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.8** Llogari të tjera me bankat, me institucionet e kreditit dhe me institucionet e tjera financiare.

- Zëri 1821 Garanci paguar bankave (në valutë).
- Zëri 1822 Interesi i përlogaritur (në valutë).
- Zëri 1831 Shuma të depozituara në një llogari të bllokuar për garanci në një bankë (në valutë).
- Zëri 1832 Interesi i përlogaritur (në valutë).
- Grupi 186 Llogari të tjera në banka, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare.
- Grupi 187 Llogari të tjera të pakthyer në banka, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare.

- **Rubrika 1.9** Llogari për t'u arkëtuar të dyshimta nga bankat, nga institucionet e kreditit dhe nga institucionet e tjera financiare.

- **Rubrika 2.0** Hua dhe paradhënie standarde dhënë klientëve.

- Grupi 201 Hua afatshkurtër.
- Grupi 202 Hua afatmesme.
- Grupi 203 Hua afatgjatë.
- Grupi 204 Hua për prona të patundshme.
- Grupi 205 Kontrata e qiradhënies financiare.

- **Rubrika 2.1** Hua dhe paradhënie e pakthyer në afat për klientë.

- Njëlloj si në rubrikën 2.0.

- **Rubrika 2.2** Hua dhe paradhënie në ndjekje.

- Njëlloj si në rubrikën 2.0.

- **Rubrika 2.3** Hua nënstandarde.

- Grupi 231 Hua afatshkurtër.
- Grupi 232 Hua afatmesme.
- Grupi 233 Hua afatgjatë.
- Grupi 234 Hua për prona të patundshme.
- Grupi 235 Kontrata e qiradhënies financiare.
- Grupi 238 Fonde rezervë për huanë nënstandarde.

- **Rubrika 2.4** Hua të dyshimta.

- Njëlloj si në rubrikën 2.3.

- **Rubrika 2.5** Hua të humbura.

- Njëlloj si në rubrikën 2.3.

- **Rubrika 2.6** Qeveria Shqiptare dhe administrata publike.

- Grupi 261 Llogari rrjedhëse.
- Grupi 262 Hua dhënë Qeverisë Shqiptare dhe administratës publike.
- Grupi 266 Llogari për t'u arkëtuar të Qeverisë Shqiptare dhe të administratës publike me status të dyshimtë.
- Grupi 267 Llogari të pakthyera në afat të Qeverisë Shqiptare dhe të administratës publike.
- Grupi 268 Fonde rezervë për llogari për t'u arkëtuar të Qeverisë Shqiptare dhe të administratës publike me status të dyshimtë.
- Grupi 269 Llogari të tjera të Qeverisë Shqiptare dhe të administratës publike me status të dyshimtë.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 2.7** Llogari rrjedhëse të klientëve.

- Grupi 271 Llogari rrjedhëse.
- Grupi 277 Llogari rrjedhëse të parregullta të klientëve debitorë.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 2.8** Llogari të tjera me klientët.

- Grupi 286 Llogari të tjera me klientët.
- Grupi 288 Llogari të tjera të klientëve të pakthyera në afat.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 2.9** Llogari për t'u arkëtuar të klientëve përveç huave.

- **Rubrika 3.1** Letra me vlerë me të ardhura fikse.

- Grupi 311 Letra me vlerë të tregtueshme.
- Grupi 312 Letra me vlerë të vendosjes.
- Grupi 313 Letra me vlerë të investimit.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 3.2** Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme.

- Grupi 321 Letra me vlerë të tregtueshme.
- Grupi 322 Letra me vlerë të vendosjes.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 3.4** Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes.

- Grupi 341 Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes së rishitjes.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 3.5** Garancia e ofruar për transaksionet me letra me vlerë.

- Grupi 351 Garanci e dhënë në lidhje me letrat me vlerë të dhëna hua.

- **Rubrika 3.6** Çmimet (primet) për instrumentet financiare.

- Grupi 361 Të arkëtuara.

- **Rubrika 4.1** Mjete të tjera.

- Grupi 411 Debitorë të ndryshëm.

- Grupi 412 Mjete inventari.
- Grupi 418 Fonde rezervë për aktive të tjera.
- Grupi 419 Të ardhura të llogaritura dhe shpenzime të shtyra.

- **Rubrika 4.3** Transaksione në rolin e agjentit.

- **Rubrika 4.5** Llogaritë pezull, të diferencave dhe të pozicionit.

- Grupi 451 Llogaritë pezull.

- **Rubrika 5.1** Interesa pjesëmarrës.

- **Rubrika 5.2** Filialet.

- **Rubrika 5.3** Mjete të qëndrueshme.

(Bëhet fjalë për mjete të qëndrueshme që mbahen të vlerësuara në valutë.)

- **Rubrika 9.0** Angazhime financimi.

- Grupi 901 Angazhime të dhëna.

- **Rubrika 9.1** Garancitë.

- Grupi 911 Garancitë e dhëna.

- **Rubrika 9.2** Angazhimet për letrat me vlerë.

- Grupi 922 Letra me vlerë për t'u marrë.
- Grupi 924 Letra me vlerë të dhëna si garanci për një kredi ose refinancim.
- Grupi 926 Letra me vlerë të marra hua.

- **Rubrika 9.3** Transaksione valutore.

- Grupi 931 Valutë e blerë sipas kontratave me afat.

- **Rubrika 9.4** Angazhime të tjera.

- **Rubrika 9.5** Angazhime për instrumente financiare.

- Grupi 952 Të dhëna.

NË PASIV

- **Grupi 1.1.2** : Marrëdhënie me Bankën e Shqipërisë (në valutë).

- Zëri 1121. Llogaritë rrjedhëse.
- Zëri 1125 Depozita të marra nga banka qendrore.
- Zëri 1126 Huamarrje nga banka qendrore.
- Zëri 1128 Llogari të tjera me bankat qendrore.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e llogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.2** Bono thesari dhe bono të tjera të përshtatshme për refinancim me bankën qendrore.

- Zëri 1215 Bono thesari të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes.
- Zëri 1225 Bono të tjera të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes.

- **Rubrika 1.3** Llogari rrjedhëse në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare.

- Grupi 131 Llogari rrjedhëse në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare rezidente.
- Grupi 132 Llogari rrjedhëse në bankat, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare jorezidente.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përlogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.6** Depozita nga bankat, nga institucionet e kreditit dhe nga institucionet e tjera financiare.

- Grupi 161 Depozita nga bankat, nga institucionet e kreditit dhe nga institucionet e tjera financiare rezidente.
- Grupi 162 Depozita nga bankat, nga institucionet e kreditit dhe nga institucionet e tjera financiare jorezidente.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përllogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.7** Hua e marrë nga bankat, nga institucionet e kreditit dhe nga institucionet e tjera financiare.

- Grupi 171 Hua e marrë nga bankat, nga institucionet e kreditit dhe nga institucionet e tjera financiare rezidente.
- Grupi 172 Hua e marrë nga bankat, nga institucionet të kreditit dhe nga institucionet e tjera financiare jorezidente.
- Grupi 173 Letra tregtare dhe shumat e të hollave të dhëna sipas një marrëveshjeje riblerje.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përllogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 1.8** Llogari të tjera me bankat, me institucionet e kreditit dhe me institucionet e tjera financiare.

- Zëri 1823 Garanci të marra nga bankat (në valutë).
- Zëri 1829 Interesi i përllogaritur (në valutë).
- Zëri 1833 Shuma të marra në një llogari të bllokuar për garanci nga një bankë (në valutë).
- Zëri 1839 Interesi i përllogaritur (në valutë).
- Grupi 186 Llogari të tjera në banka, në institucionet e kreditit dhe në institucionet e tjera financiare.

- **Rubrika 2.6** Qeveria Shqiptare dhe administrata publike.

- Grupi 261 Llogari rrjedhëse.
- Grupi 263 Llogari depozitash.
- Grupi 264 Depozita me afat nga Qeveria Shqiptare dhe nga administrata publike.
- Grupi 265 Hua të marra nga Qeveria Shqiptare dhe nga administrata publike.
- Grupi 269 Llogari të tjera të Qeverisë Shqiptare dhe të administratës publike me status të dyshimtë.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përllogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 2.7** Detyrime ndaj klientëve për llogari rrjedhëse dhe për depozitat.

- Grupi 271 Llogari rrjedhëse.
- Grupi 272 Llogaritë e depozitave pa afat.
- Grupi 273 Llogaritë e depozitave me afat.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e llogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 2.8** Llogari të tjera me klientët.

- (e gjithë rubrika, përveç grupit 288)

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e llogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 3.3** Borxhi i përfaqësuar nga letrat me vlerë.

- **Rubrika 3.4** Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes.

- Grupi 342 Letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes.

(Këtu futen si principali ashtu edhe interesat e përllogaritur për nënzërat në valutë, në çdo lloj valute që të jetë.)

- **Rubrika 3.5** Garancia e ofruar për transaksionet me letra me vlerë.
 - Grupi 352 Garanci të arkëtuara në lidhje me letrat me vlerë të marra hua.
- **Rubrika 3.6** Çmimet (primet) për instrumente financiare.
 - Grupi 362 Të paguara.
- **Rubrika 4.2** Detyrime të tjera.
 - Grupi 421 Kreditorë të ndryshëm.
 - Grupi 429 Shpenzime të llogaritura dhe të ardhura të shtyra.
- **Rubrika 4.3** Transaksione në rolin e agjentit.
- **Rubrika 4.5** Llogaritë pezull, të diferencave dhe të pozicionit.
 - Grupi 451 Llogaritë pezull.
- **Rubrika 5.4** Ndhimat dhe financimi publik.
- **Rubrika 5.5** Fonde rezervë specifike.
 - Grupi 551 Fonde rezervë për rreziqe dhe për shpenzime.
 - Grupi 558 Fonde rezervë specifike të tjera.
- **Rubrika 5.6** Borxhi i varur.
- **Rubrika 5.7** Kapitali i aksionerëve.
 - Grupi 571 Kapitali i paguar.
 - Grupi 572 Primet e aksioneve.
- **Rubrika 9.0** Angazhime financimi.
 - Grupi 902 Angazhime të marra.
- **Rubrika 9.1** Garancitë.
 - Grupi 912 Garancitë e marra.
- **Rubrika 9.2** Angazhimet për letrat me vlerë.
 - Grupi 921 Letra me vlerë për t'u dhënë.
 - Grupi 923 Letra me vlerë të marra si garanci për një kredi ose për një rifinancim.
 - Grupi 925 Letra me vlerë të marra hua.
- **Rubrika 9.3** Transaksione valutore.
 - Grupi 932 Valutë e shitur sipas kontratave me afat.
- **Rubrika 9.4** Angazhime të tjera.
- **Rubrika 9.5** Angazhime për instrumente financiare.
 - Grupi 952 Të marra.

Duke marrë shkas nga sa vepohet në disa banka ose degë bankash të huaja, sqarojmë se në asnjë rast llogaria e rezultatit financiar nga veprimet në valutë nuk merret si zë përbërës në llogaritjen e pozicionit të hapur valutor. Kjo, për arsye se rezultati financiar i bankës, në çdo rast, mbahet në monedhë vendase, në lekë.

Aktivi gjithsej = Aktivi i bilancit + aktivi jashtë bilancit; dhe
 Pasivi gjithsej = Pasivi i bilancit + pasivi jashtë bilancit,
 ose një mënyrë tjetër paraqitjeje:

A. Aktivi i bilancit
B. Pasivi i bilancit
Diferenca (A-B)

C. Aktivi i zërave jashtë bilancit
D. Pasivi i zërave jashtë bilancit
Diferenca (C- D)

E.Totali i aktivitet (A +C)
F.Totali i pasivitet(B+D)
Totali diferencave(E-F)

Mbi bazën e këtyre të dhënave që kemi nxjerrë nga bilanci kontabël i periudhës raportuese bëjmë llogaritjen e :

a- shumës së pozicioneve të hapura në blerje (+);

b- shumës së pozicioneve të hapura në shitje (-).

Diferencën midis shumave "a" dhe "b" më sipër e vëmë në raport me kapitalin rregullator.

DREJTORE
Miranda RAMAJ

RREGULLORE

MBI RREZIQET E TREGUT

Miratuar me vendim nr. 72, datë 02.06.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr.98, datë 19.12.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KAPITULLI I

TË PËRGJITHSHME

- 1- Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 2- Subjekte të analizës së rreziqeve të tregut janë të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat për efekt të kësaj rregulloreje në vazhdim do të quhen "bankë", që plotësojnë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:
 - 2.1. vlera kontabile e letrave me vlerë të portofolit të tregtueshëm është mesatarisht më e madhe se 5 për qind e shumës të totalit të aktivitetit dhe të totalit të jashtë-bilancit gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit ose më e madhe, në çdo kohë, se 6 për qind e shumës të totalit të aktivitetit dhe të totalit të jashtë-bilancit;
 - 2.2. totali i letrave me vlerë të portofolit të tregtueshëm është mesatarisht më i madh se 15 milionë euro gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit ose më i madh në çdo kohë se 20 milionë euro.

Llogaritja e plotësimin të kushteve të mësipërme bëhet në formularin e raportimit nr. 1.

- 3- Qëllimi i kësaj rregulloreje është llogaritja e kërkesës për kapitalin rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut. Me rrezik të tregut kuptojmë rrezikun e humbjes në pozicionin në bilanc dhe jashtë-bilancit si rezultat i ndryshimeve të çmimeve në tregun financiar. Ai ka të bëjë me analizën e rrezikut të pozicionit:
 - 3.1. të normës të interesit për letra me vlerë me të ardhura fikse;
 - 3.2. të çmimit të tregut të letrave me vlerë me të ardhura variabël;
 - 3.3. të rregullimeve të shlyerjes me kundërpartinë;
 - 3.4. të tejkallimeve të kufijve për rreziqet e mëdha;
 - 3.5. të këmbimeve në valutë.
- 4¹- Raportimi bëhet në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, në varësi të pikës 2:
 - 4.1. në rast mosplotësimi të kushteve të pikës 2.1. dhe të pikës 2.2. raportohen formularët 1, 2, 6, 7, ndërsa portofoli i tregtueshëm integrohet në llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas rregullores "Për mjaftueshmërinë e kapitalit";
 - 4.2. në rast plotësimi të kushteve të pikës 2.1. dhe të pikës 2.2. raportohen të gjithë formularët e bashkëngjitur në këtë rregullore.

Formularët e raportimit janë pjesë përbërëse e sistemit raportues.

- 5- Kontrolli për mbulimin e rreziqeve të tregut ka të bëjë me:
 - 5.1. kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut të jetë jo më e madhe se vetë kapitali rregullator që banka ka për mbulimin e rrezikut të tregut.

Në rast mosplotësimi të kushtit të mësipërm:

- 5.2. banka merr masa për ta plotësuar atë brenda një periudhe tremujore;

¹ Ky ndryshim është bërë me vendimin nr.98, datë 19.12.2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

- 5.3. në rast mospërbushjeje nga bankat të detyrimeve të pikës 5.2. dhe përsëritjes së mosplotësimit të detyrimit të pikës 5.1. atëherë Banka e Shqipërisë vepron ndaj tyre në përputhje me ligjin nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 44 , neni 45, pika 3.
- 6- Përcaktimet e mëposhtme jepen në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
- 6.1. Letrat me vlerë të portofolit të tregtueshëm përfshijnë :
- 6.1.1. letra me vlerë të tregtueshme: letra me vlerë të blera ose të përfituara me synim rishitjeje ose riblerjeje brenda një periudhe të shkurtër kohe. Ato duhet të tregtohen në një treg të organizuar dhe likuid. Çmimet e tregut të këtyre letrave me vlerë në mënyrë konstante janë të përdorshme nga të tretët dhe ruhen nga bankat subjekte në mënyrë të tillë që ato të verifikohen kur mbyllen llogaritë;
- 6.1.2. letra me vlerë të vendosjes: letra me vlerë të përfituara me synim mbajtjen për një periudhë mbi 6 muaj, përveç letrave me vlerë me të ardhura fikse, të cilat mbahen deri në maturi (investimit). Në llogaritjen e vlerës të portofolit të tregtueshëm, bankat mund të përjashtojnë nga totali i portofolit të tregtueshëm letrat me vlerë të vendosjes, në rast se madhësia e portofolit të tregtueshëm së bashku me letrat me vlerë të vendosjes është jo më e madhe se 10 për qind e shumës së totalit të aktivitetit dhe të totalit të zërave jashtë-bilancit, mesatarisht gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit;
- 6.1.3. instrumentet derivate që kanë për objekt:
- 6.1.3.1. mbajtjen hapur të pozicioneve me qëllim që, rast pas rasti, të përfitojnë nga evolucioni i çmimeve,
- 6.1.3.2. mundësinë e administrimit të specializuar të letrave me vlerë të tregtueshme, të cilat përmbledhin: instrumentet derivate, letrat me vlerë dhe veprimtaritë financiare të ngjashme, me rezervën e plotësimit të njëkohshëm të kushteve të mëposhtme:
- i) banka është e aftë të sigurojë një pjesëmarrje në mënyrë të qëndrueshme dhe në vazhdimësi, në tregun e instrumenteve derivate si kontrata këmbimi mbi normat e interesit dhe mbi kontrata këmbimi në valutë,
- ii) portofoli i tregtueshëm që përmbledh këto instrumente derivate ka një vëllim të madh operacionesh në treg,
- iii) portofoli i tregtueshëm qarkullon në mënyrë të vazhdueshme dhe në tërësi;
- 6.1.3.3. mbylljen në mënyrë të qartë, që në origjinë, të rrezikut të tregut me të cilin përballen bankat gjatë veprimtarisë me letra me vlerë të portofolit të tregtueshëm .
- 6.2. Emetuesit e kualifikuar kanë këto karakteristika:
- 6.2.1. emetuesit që ponderohen me 20 për qind në llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit;
- 6.2.2. emetuesit që plotësojnë tre kushtet e mëposhtme:
- 6.2.2.1. një nga letrat me vlerë e emetuar nga këta emetues kuotohet në tregje të rregulluara ose në tregje të njohura nga vende të treta;
- 6.2.2.2. banka në fjalë mund t'i konsiderojë letra me vlerë të emetuara nga këta emetues likuidë në mënyrë të mjaftueshme, ndërsa Banka e Shqipërisë mund ta kundërshtojë një konsideratë të tillë;
- 6.2.2.3. banka në fjalë mund të konsiderojë se rreziku i emetuesit nuk është më i lartë se ai i pikës 6.2.2.1., ndërsa Banka e Shqipërisë mund ta kundërshtojë një konsideratë të tillë.

KAPITULLI II

KAPITALI RREGULLATOR PËR MBULIMIN E RREZIQEVE TË TREGUT

- 1- Struktura e kapitalit rregullator të bankës për mbulimin e rreziqeve të tregut është:
- 1.1. kapitali bazë i mbetur (CB) ;
- 1.2. kapitali shtesë i mbetur (JB) ;
- 1.3. kapitali mbishtesë .
2. Elementet përbërëse të kapitalit rregullator të bankës për mbulimin e rreziqeve të tregut janë:

2.1. kapitalit rregullator të llogaritur në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës" i zbritet ajo pjesë e tij që shërben për respektimin e normës të mjaftueshmërisë (12 për qind e totalit të zërave të aktivitetit dhe zërave jashtë-bilancit të ponderuar me rrezikun përkatës) llogaritur sipas rregullores "Për mjaftueshmërinë e kapitalit rregullator". Diferenca përbën kapitalin rregullator të mbetur.

Kapitali rregullator i mbetur është i përbërë nga:

- 2.1.1. kapitali bazë i mbetur i llogaritur sipas tabelës 5 të formularit nr. 2,
- 2.1.2. kapitali shtesë i mbetur i llogaritur sipas tabelës 5 të formularit nr.2;

2.2. kapitali mbishtesë përbëhet nga:

- 2.2.1. fitimi i ndërmjetëm që nuk plotëson në mënyrë të njëkohëshme kushtet e mëposhtme:
 - përcaktohet pasi të jenë kontabilizuar të gjitha shpenzimet e periudhës korresponduese, përfshirë këtu edhe shpenzimet për amortizime dhe provigjone,
 - të jenë llogaritur për neto pasi të jenë zbritur tatimi mbi fitimin i parashikuar dhe dividendët e parashikuar,
 - të jetë verifikuar nga komiteti i kontrollit të bankës dhe nga eksperti kontabël i autorizuar.

2.2.2. Detyrimet e varura me karakteristikat e mëposhtme :

- detyrimet e varura me afat, të përcaktuara në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës", që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit rregullator për arsye të kufizimit 2.2.2.2. në të njëjtin udhëzim ;
- instrumentet hibride dhe detyrimet e varura me afat, të përcaktuara në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës", që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit rregullator për arsye të kufizimit 2.2.2.1. në të njëjtin udhëzim ;
- detyrimet e varura, me afat maturimi fillestar jo më të vogël se 2 vjet, që plotësojnë kushtet e mëposhtme :
 - i) shlyhen në mënyrë të plotë dhe kontrata e emetimit ose e huasë nuk duhet të parashikojë asnjë rast të shlyerjes para afatit pa miratim të Bankës të Shqipërisë;
 - ii) pagimi i principalit apo i interesave të këtyre detyrimeve të varura nuk duhet, në asnjë rast, të pakësojë kapitalin rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut në mënyrë të tillë, që ky kapital të mos bjerë nën nivelin e kërkuar për mbulimin e rreziqeve të tregut.

2.3. Shuma e kapitalit shtesë të mbetur së bashku me kapitalin mbishtesë të jetë jo më e madhe se 250 për qind e kapitalit bazë të mbetur .

2.4. Shuma e elementeve të përcaktuara në pikat 2.1. dhe 2.2. me kufizimin e pikës 2.3. përbën kapitalin rregullator global të bankës.

3. Kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut raportohet periodikisht në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, çdo gjashtëmuajor.

Me kërkesë të Bankës të Shqipërisë, të Departamentit të Mbikëqyrjes, mund të kërkohej raportimi i tij çdo tremujor.

4. Mënyra e raportimit të kapitalit rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut të llogaritur nga banka, bëhet sipas formularit të raportimit nr. 2.

KAPITULLI III

PËRCAKTIMI I POZICIONIT NETO

1- Me përkufizim: pozicioni neto përfaqëson tepricën në blerje (pozicioni neto në blerje) ose tepricën në shitje (pozicioni neto në shitje) të operacioneve të regjistruara nga banka me

secilën nga letrat me vlerë dhe instrumentet e portofolit të tregtueshëm, që kanë të bëjnë me rreziqet e tregut.

- 2- Llogaritja e pozicioneve neto të letrave me vlerë të portofolit të tregtueshëm bëhet duke:
 - 2.1. vlerësuar ato çdo ditë me çmimin e tregut valutë për valutë;
 - 2.2. kompensuar pozicionet neto në blerje (ose pozicioni neto *long*) me pozicionet neto në shitje (ose pozicioni neto *short*) kur plotësohen në mënyrë të njëkohshme kushtet e mëposhtme:
 - 2.2.1. mbi letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme të të njëjtit emetues;
 - 2.2.2. mbi letra me vlerë me të ardhura fikse të të njëjtit emetues, me të njëjtin maturim, të ngjashëm midis tyre në bazë të kontratës së emetimit;
 - 2.2.3. mbi letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme dhe mbi letra me vlerë me të ardhura fikse të tregtueshme në tregje të rregulluara nga pjesëtarët e Bashkimit Evropian apo në tregje të njohura nga Ministria e Financave.
- 3- Pozicionet neto të titujve të portofolit të tregtueshëm raportohen në lekë, pozicionet neto në valutë konvertohen në lekë çdo ditë me kursin e ditës, nxjerrë nga Banka e Shqipërisë.
- 4- Në rastet e veçanta kemi:
 - 4.1. huadhënia e letrave me vlerë dhe shitjet sipas kontratës repo përfshihen në llogaritjen e pozicioneve neto sipas natyrës së letrave me vlerë të kontraktuar. Nga ana tjetër, huamarrja e letrave me vlerë dhe blerja sipas kontratës repo nuk përfshihet në pozicionet neto;
 - 4.2. pozicionet e krijuara nga angazhime për blerje të përvokueshme të letrave me vlerë përfshihen në llogaritjen e pozicioneve neto vetëm duke filluar nga dita parë e punës domethënë, pas dy ditësh kur banka është angazhuar në mënyrë të përvokueshme për të pranuar një sasi të njohur të letrave me vlerë me çmim të përcaktuar më parë.

Në këtë rast duhet të plotësohen në mënyrë të njëkohshme dy kufizime:

- 4.2.1. pozicionet e nënshkruara nga të tretët mbi bazën e një marrëveshjeje formale zbriten nga pozicionet e krijuara nga angazhime për blerje të përvokueshme nga banka;
- 4.2.2. pozicionet neto të përcaktuara si më sipër ponderohen me koeficientët përkatës, në varësi të ditëve të punës:

DITËT E PUNËS TË HAPURA	KOEFICIENTËT E PONDERIMIT
Dita zero	0 për qind
Dita e parë	10 për qind
Dita e dytë dhe e tretë	25 për qind
Dita e katërt	50 për qind
Dita e pestë	70 për qind
Pas ditës të pestë	100 për qind

Ndërmjet momentit të parë të angazhimit dhe ditës së parë të punës, banka duhet të marrë përsipër një masë të tillë rreziqesh, të afta për t'u mbuluar nga niveli i kapitalit rregullator .

KAPITULLI IV

RREZIKU NGA NORMAT E INTERESIT

- 1- Subjektet janë ato të përcaktuara në pikën 2 të kapitullit I dhe analiza e rrezikut të normave të interesit bëhet për elementet e portofolit të tregtueshëm të përcaktuar në pikën 6.1. të kapitullit I të kësaj rregulloreje .
- 2- Qëllimi është llogaritja e kërkesës për kapital rregullator për mbrojtjen dhe për mbulimin nga ana e bankës ndaj rreziqeve të lidhura me normat e interesit. Këto rreziqe janë dy llojesh:

- 2.1. rreziku specifik, që ka të bëjë me evolucionin e pafavorshëm të çmimit të letrës me vlerë si rezultat i përkeqësimit të gjendjes financiare të emetuesit;
 - 2.2. rreziku i përgjithshëm, që ka të bëjë me rrezikun e humbjes si rezultat i ndryshimeve të pafavorshme të normave të interesave në treg.
- 3- Bankat i klasifikojnë pozicionet neto, të deklaruara me vlerën e tregut, për secilën valutë duke llogaritur për secilën prej tyre kërkesën për kapital rregullator si për rrezikun specifik ashtu dhe për rrezikun e përgjithshëm, sipas metodologjisë të përshkruar në kapitullin III.
- 4- Metodologjia e llogaritjes së kërkesës për kapital rregullator për rrezikun specifik është :
- 4.1. përcaktimi i pozicionit neto për çdo letër me vlerë sipas metodologjisë së kapitullit III;
 - 4.2. ponderimi i pozicionit neto me koeficientët përkatës ;
 - 4.3. përcaktimi i kërkesës për kapital rregullator.
- 5- Mënyra e llogaritjes të kërkesës për kapital rregullator për rrezikun specifik është: pozicionet neto në varësi të natyrës së emetuesit dhe të afatit të mbetur deri në maturim i ponderon me koeficientët e mëposhtëm:
- 5.1. letra me vlerë të administratës dhe të bankave qendrore të zonës A me 0 për qind;
 - 5.2. letra me vlerë të emetuesve të kualifikuar (kap.I pika 3) me afat të mbetur deri në maturim:
 - 5.2.1. nga 0 deri në 6 muaj me..... 0.25 për qind;
 - 5.2.2. nga 6 deri në 24 muaj me..... 1.00 për qind;
 - 5.2.3. mbi 24 muaj me.....1.60 për qind;
 - 5.3. letra me vlerë të emetuesve të tjerë....8.00 për qind.

Shuma e pozicioneve neto të ponderuara si më sipër përbën kërkesën për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut specifik.

- 6- Përdoren dy metoda për llogaritjen e kërkesës për kapital rregullator për mbulimin nga rreziku i përgjithshëm, metodologjia e të cilave është :
- 6.1. për metodën e maturimit:
 - 6.1.1. përcaktohet pozicioni neto për çdo letër me vlerë sipas metodologjisë të kapitulli II;
 - 6.1.2. ponderohet pozicioni neto për secilën letër me vlerë sipas afatit. Ky ponderim reflekton ndjeshmërinë ndaj ndryshimit të përgjithshëm të normave të interesit;
 - 6.1.3. bëhet kompensimi i pozicioneve neto të ponderuara sipas rradhës:
 - 6.1.3.1. kompensimi brenda secilës hapësirë kohore,
 - 6.1.3.2. kompensimi i secilës hapësirë kohore brenda secilës zonë,
 - 6.1.3.3. bëhet kompensimi ndërmjet zonave;
 - 6.1.4. përcaktimi i kërkesës për kapital rregullator.
 - 6.2. për metodën e "kohëzgjatjes " :
 - 6.2.1. llogaritja e kohëzgjatjes së modifikuar për çdo letër me vlerë;
 - 6.2.2. shpërndarja e pozicioneve sipas zonave ;
 - 6.2.3. kompensimi brenda secilës zonë ;
 - 6.2.4. kompensimi ndërmjet zonave ;
 - 6.2.5. përcaktimi i kërkesës për kapital rregullator .
- 7- Mënyra e llogaritjes së kërkesës për kapital rregullator prej rrezikut të përgjithshëm është :
- 7.1. për metodën e maturimit:
 - 7.1.1. Etapa e parë : përcaktimi i pozicioneve neto të ponderuara.

Çdo pozicion i hapësirës kohore përkatëse ponderohet me koeficientët e kolonës (4). Subjektet e kësaj rregulloreje, i klasifikojnë pozicionet neto sipas tabelës së mëposhtme në funksion të:

- 7.1.1.1. maturimit mbetës për letra me vlerë me normë interesi fikse;
- 7.1.1.2. kohëzgjatjes deri në ndryshimin e normës së interesit për letra me vlerë me normë interesi të ndryshueshme;
- 7.1.1.3. normës së kuponit, duke bërë dallimin për letra me vlerë me normë kuponit më të vogël se 3 për qind dhe për letra me vlerë me normë kuponit jo më të vogël se 3 për qind.

Hapësira kohore sipas maturimit			
Zona	Kuponi jo më i vogël se 3 për qind	Kuponi më i vogël se 3 për qind	Pon (pë
(1)	(2)	(3)	(
1	0 <= 1 muaj	0 <= 1 muaj	0
1	> 1 <= 3 muaj	> 1 <= 3 muaj	0
1	> 3 <= 6 muaj	> 3 <= 6 muaj	0
1	> 6 <= 12 muaj	> 6 <= 12 muaj	0
2	> 1 <= 2 vjet	> 1 <= 1,9 vjet	1
2	> 2 <= 3 vjet	> 1,9 <= 2,8 vjet	1
2	> 3 <= 4 vjet	> 2,8 <= 3,6 vjet	2
3	> 4 <= 5 vjet	> 3,6 <= 4,3 vjet	2
3	> 5 <= 7 vjet	> 4,3 <= 5,7 vjet	3
3	> 7 <= 10 vjet	> 5,7 <= 7,3 vjet	3
3	> 10 <= 15 vjet	> 7,3 <= 9,3 vjet	4
3	> 15 <= 20 vjet	> 9,3 <= 10,6 vjet	5
3	Mbi 20 vjet	> 10,6 <= 12 vjet	6
3		> 12 <= 20 vjet	8
3		mbi 20 vjet	1:

7.1.2. Etapa e dytë : kryerja e kompensimeve .

7.1.2.1. për secilën hapësirë kohore:

pozicionet *short* të ponderuara kompensohen me pozicionet *long* të ponderuara:

- më i vogli midis tyre përbën pozicionet e ponderuara të kompensuar të secilës hapësirë kohore;
- teprica midis tyre *long* apo *short* përbën pozicionet e ponderuara të pakompensuar të secilës hapësirë kohore;

7.1.2.2. për secilën zonë :

- i) mbliidhen të gjitha pozicionet e ponderuara të pakompensuar *long* të secilës hapësirë kohore, duke formuar shumën e tyre;
- ii) mbliidhen të gjitha pozicionet e ponderuara të pakompensuar *short* të secilës hapësirë kohore, duke formuar shumën e tyre;
- iii) shuma e pozicioneve të ponderuara të pakompensuar *long* të secilës hapësirë kohore kompensohet me shumën e pozicioneve të ponderuara të pakompensuar *short* të secilës hapësirë kohore:
 - më e vogla midis tyre përbën pozicionet e ponderuara të kompensuar të secilës zonë.
 - teprica midis tyre *long* apo *short* përbën pozicionet e ponderuara të pakompensuar të secilës zonë.

7.1.2.3. ndërmjet zonave:

A) sipas rradhës rritëse :

- i) kryhen kompensimet midis pozicioneve të ponderuara të pakompensuar *long* (*short*) të zonës 1 me pozicionet e ponderuara të pakompensuar *short* (*long*) të zonës 2:

- më e vogla midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të kompensuar midis zonës 1 dhe zonës 2;
- teprica midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës .
- ii) kryhen kompensimet midis pozicioneve të ponderuara të pakompensuara mbetës *long (short)* të zonës 2 me pozicionet e ponderuara të pakompensuara *short (long)* të zonës 3:
 - më e vogla midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të kompensuar midis zonës 2 dhe zonës 3;
 - teprica midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës .
- B) sipas rradhës zbritëse:
 - i) kryhen kompensimet midis pozicioneve të ponderuara të pakompensuara *long (short)* të zonës 2 me pozicionet e ponderuara të pakompensuara *short (long)* të zonës 3:
 - më e vogla midis tyre përbën pozicionin të ponderuar të kompensuar midis zonës 2 dhe zonës 3 ;
 - teprica midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës .
 - ii) kryhen kompensimet midis pozicioneve të ponderuara të pakompensuara mbetës *long (short)* të zonës 2 me pozicionet e ponderuara të pakompensuara *short (long)* të zonës 1:
 - më e vogla midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të kompensuar midis zonës 2 dhe zonës 1 ;
 - teprica midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës.

Në fund, si të metodës rritëse ashtu dhe të metodës zbritëse kryhet kompensimi midis pozicionit të pakompensuar mbetës të zonës 1 dhe pozicionit të pakompensuar mbetës të zonës 3 duke përfutur pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës final.

7.1.3. Etapa e tretë: përcaktimi i kërkesës për kapital rregullator:

kërkesa për kapital rregullator është e barabartë me shumën e elementeve të mëposhtme :

- 10 për qind e shumës të pozicioneve të ponderuara të kompensuara të të gjitha hapësirave kohore;
- 40 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar të "zonës 1";
- 30 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar të "zonës 2";
- 30 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar të "zonës 3";
- 40 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar midis "zonës 1" dhe "zonës 2";
- 40 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar midis "zonës 2" dhe "zonës 3";
- 150 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar midis "zonës 1" dhe "zonës 3";
- 100 për qind të pozicionit të ponderuar të pakompensuar mbetës final.

7.2. Për metodën e "kohëzgjatje":

7.2.1. Etapa e parë: llogaritja e kohëzgjatjes së modifikuar për çdo letër me vlerë:

7.2.1.1. për letra me vlerë me normë interesi fikse:

banka, duke u nisur nga vlera e tregut të titullit, llogarit rendimentin në maturim që është dhe norma e aktualizimit të vlerës titullit;

7.2.1.2. për letra me vlerë me normë interesi të ndryshueshme:

banka, duke u nisur nga vlera e tregut të titullit, llogarit rendimentin në maturim duke supozuar si maturim afatin kohor deri në ndryshimin e normës së interesit;

7.2.1.3. llogaritet kohëzgjatje e modifikuar me formulën:

$$\text{"Kohëzgjatje = D"} = \frac{\sum_{t=1}^m \frac{t \cdot Ct}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^m \frac{Ct}{(1+r)^t}} ;$$

$$\text{"Kohëzgjatje e modifikuar = Dm"} = \frac{D}{(1+r)^t}$$

- **Ct** është fluksi financiar i marrë nga mbajtësi i letrës me vlerë në momentin e kohës "t";
- **m** është kohëzgjatja e mbetur;
- **r** është rendimenti në maturim (norma e përfitueshmërisë ose e aktualizimit).

7.2.2. Etapa e dytë: përcaktimi i pozicioneve neto të ponderuara.

Çdo pozicion në varësi të kohëzgjatjes së modifikuar (kolona 2) ponderohet me koeficientët e kolonës (3) duke dhënë pozicionet e ponderuara të çdo zone.

Zonë	Kohëzgjatja e modifikuar (në vite)	Interesi mundshëm (Ndry)
(1)	(2)	(3)
1	0 <= 1,0	1,00
2	> 1,0 <= 3,6	0,85
3	> 3,6	0,70

7.2.3. Etapa e tretë : kryerja e kompensimeve.

7.2.3.1. për secilën zonë :

përcaktohen pozicioni i ponderuar *long* dhe pozicioni i ponderuar *short*:

- më i vogli midis tyre përbën pozicionet e ponderuara të kompensuar të secilës zonë;
- teprica midis tyre *long* apo *short* përbën pozicionet e ponderuara të pakompensuar të secilës zonë .

7.2.3.2. Ndërmjet zonave:

a) sipas rradhës rritëse:

i) kryhen kompensimet midis pozicioneve të ponderuara të pakompensuar *long* (*short*) të zonës 1 me pozicionet e ponderuara të pakompensuar *short* (*long*) të zonës 2:

- më e vogla midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të kompensuar midis zonës 1 dhe zonës 2,

— teprica midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës .

ii) kryhen kompensimet midis pozicioneve të ponderuara të pakompensuar mbetëse *long* (*short*) të zonës 2 me pozicionet e ponderuara të pakompensuar *short* (*long*) të zonës 3:

- më e vogla midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të kompensuar midis zonës 2 dhe zonës 3,

— teprica midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës.

b) sipas rradhës zbritëse .

i) kryhen kompensimet midis pozicioneve të ponderuara të pakompensuar *long* (*short*)

- të zonës 2 me pozicionet e ponderuara të pakompensuara *short (long)* të zonës 3 : më e vogla midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të kompensuar midis zonës 2 dhe zonës 3,
 - teprica midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës;
 - ii) kryhen kompensimet midis pozicioneve të ponderuara të pakompensuara mbetëse *long (short)* të zonës 2 dhe pozicionit të ponderuar të pakompensuar *short (long)* të zonës 1:
 - më e vogla midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të kompensuar midis zonës 2 dhe zonës 1,
 - teprica midis tyre përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës;
- në fund, si të metodës rritëse ashtu dhe të metodës zbritëse, kryhet kompensimi midis pozicionit të pakompensuar mbetës të zonës 1 dhe pozicionit të pakompensuar mbetës të zonës 3, duke përfutur pozicionin e ponderuar të pakompensuar mbetës përfundimtar.

7.2.4. Etapa e katërt : përcaktimi i kërkesës për kapital rregullator :

kërkesa për kapital rregullator është e barabartë me shumën e elementeve të mëposhtme :

- 2 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar të "zonës 1" ;
- 2 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar të "zonës 2" ;
- 2 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar të "zonës 3" ;
- 40 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar midis "zonës 1" dhe "zonës 2";
- 40 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar midis "zonës 2" dhe "zonës 3";
- 150 për qind të pozicionit të ponderuar të kompensuar midis "zonës 1" dhe "zonës 3";
- 100 për qind të pozicionit të ponderuar të pakompensuar mbetës përfundimtar.

- 8- Mënyra e raportimit të kërkesës për kapital rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut, të llogaritur nga banka dhe krahasimi i kërkesës për kapital rregullator me kapitalin rregullator, bëhet sipas formularëve të raportimit nr. 3, 4, 5, 6.

KAPITULLI V

RREZIKU NGA KËMBIMET NË VALUTË

- 1- Subjektet janë ato të përcaktuara në pikën 2 të kapitullit I dhe analiza e rrezikut të këmbimeve në valutë bëhet përjashtimisht vetëm në këtë rast, për të gjitha elementet e aktivitetit të bilancit dhe të jashtë-bilancit në valutë.
- 2- Qëllimi është llogaritja e kërkesës për kapital rregullator për mbrojtjen dhe për mbulimin e bankës ndaj rrezikut të këmbimeve në valutë në rastet kur pozicioni neto global në valutë është më i madh se 2 për qind i kapitalit rregullator global.
- 3- Si elemente përbërëse kemi :
 - 3.1. kapitalin rregullator global të llogaritur në kapitullin II të kësaj rregulloreje;
 - 3.2. pozicionin neto global me të cilin kuptojmë më të madhin midis shumës së "pozicioneve të hapura valutore neto në blerje (*long*)" dhe shumës së "pozicioneve të hapura valutore neto në shitje (*short*)".

"Pozicionet e hapura valutore neto në blerje (*long*)" dhe "pozicionet e hapura valutore neto në shitje (*short*)" llogariten sipas metodologjisë së përcaktuar në rregulloren "Për pozicionet e hapura në valutë" dhe udhëzimit përkatës .
- 4- Kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rreziqeve të këmbimit në valutë është e barabartë me 8 për qind të tepricës të pozicionit neto global mbi kapitalin rregullator global.

- 5- Llogaritja e kërkesës për kapital rregullator bëhet sipas formularit nr.7 bashkëngjitur, që është pjesë përbërëse e sistemit raportues.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kërkesat e parashikuara në këtë rregullore të plotësohen me të dhënat e kontabilitetit të datës 31.12.1999.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 1

Llogaritja e kufirit të mbikëqyrjes të rreziqeve të tregut (në mijë lekë).

Emri i bankës
 Periudha raportuese
 Data e raportimit
 Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
 Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

LLOGARITJA E PORTOFOLIT TË TREGTUESHËM DHE E KUFIZIMIT TË PIKËS 2 TË KAPITULLIT I
I.Llogaritja e portofolit të tregtueshëm në vlerë kontabile :
1- Elementet përbërëse të portofolit tregtueshëm :
--Letra me vlerë e tregtueshme
--Letra me vlerë e tendosjes
--Operacionet jashtë-bilancit me letra me vlerë
--Instrumentet derivate të përcaktuara në pikën 6.3.1. të kapitullit I
2-Llogaritja e portofolit me rezervën e pikës 6.2.1 të kapitullit I :
--Totali i bilancit dhe jashtë-bilancit
-- E x 10 për qind :
- Në qoftë se $A+B+C+D > F$ mesatarisht gjatë dy gjashtëmujorëve atëherë $G = A+B+C+D$
- Në qoftë se $A+B+C+D < F$ mesatarisht gjatë dy gjashtëmujorëve atëherë banka mund të zgjedhi si $G = A+B+C$
II. Llogaritja e kufizimit të pikës 2.1. të kapitullit I :
--E x 5 për qind
--E x 6 për qind
III. Llogaritja e pozicionit të portofolit të tregtueshëm :
--Letra me vlerë e tregtueshme
--Letra me vlerë e vendosjes
--Operacionet jashtë-bilancit me letra me vlerë
-- Instrumentet derivate të përcaktuara në pikën 6.1.3. të kapitullit I
- Në qoftë se $G = A+B+C+D$ atëherë $N = J+K+L+M$
- Në qoftë se $G = A+B+C$ atëherë $N = J+K+L$
IV. Llogaritja e kufizimit të pikës 2.2. të kapitullit I :
--Kundërvlera në lekë e 15 milionë eurove në ditën e mbylljes.
--Kundërvlera në lekë e 20 milionë eurove në ditën e mbylljes.

Rasti i parë: banka raporton në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes të tregut, formularëve të mëposhtëm, për të gjitha operacionet e lidhura me tregtimin të vlerës kontabile të gjithë formularët e mëposhtëm atëherë kur :

- 1) në momentin e raportimit plotësohet kushti që $G > I$ ose $N > P$;
- 2) në momentin e raportimit plotësohet kushti që $G > H$ ose $N > O$ të fundit.

Rasti i dytë: në rast të mosplotësimit të kushteve të mësipërme Mbikëqyrjes, në Departamentin e Mbikëqyrjes, vetëm formularin 1

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 2

Llogaritja e kapitalit rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut në mijë lekë

Emri i bankës
 Periudha raportuese
 Data e raportimit
 Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
 Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

KAPITALI BAZË	
I-Elementet përbërëse që shtohen (A) :	
1	Kapitali i nënshkruar
2	Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)
3	Primet e emetimit dhe të fuzionimit
4	Fitimet e pashpërndara (të bartura)
5	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit (kapitulli IV p.2)
6	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese (kapitulli IV p. 3.1.)
7	Diferenca rivlerësimi kreditore (pozitive)
Nëntotali A= (1+2+3+4+5+6+7)	
II-Elementet përbërëse që zbriten (B) :	
1	Kapitali i nënshkruar i papaguar
2	Vlera nominale e aksioneve (të pashitura , të riblera)
3	Humbjet e pashpërndara (të bartura)
4	Humbje ushtrimore (kapitulli IV p.3.2.)
5	Diferenca rivlerësimi debitore (negative)
6	Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara
Nëntotali B= (1+2+3+4+5+6)	
Totali i kapitalit bazë C= (A-B)	
KAPITALI SHITESË	
III-Elementet përbërëse që shtohen (J) :	
1	Rezervat e rivlerësimit
2	Rezerva të tjera (që plotësojnë kushtet e kapitullit IV p.4)
3	Detyrimet e varura (që plotësojnë kushtet e kapitullit IV p.5.1.)
4	Detyrimet e varura (që plotësojnë kushtet e kapitullit IV p.5.2.)
Në qoftë se $F \leq C/2$ atëherë $G = F$	
Në qoftë se $F > C/2$ atëherë $G = C/2$	
Nëntotali i kufizuar $H = (EA + EB + EC + G) :$	
Kufizimi parë : Në qoftë se $H \leq C$ atëherë $J = H$	
Kufizimi dytë : Në qoftë se $H > C$ atëherë $J = C$	
Totali i kapitalit shitesë para zbritjes (J)	

	IV-Elementet përbërëse që zbriten (P +Q) :
1	Pjesëmarrje në banka e institucione financiare (P):
--	Pjesëmarrje mbi 10 për qind në kapitalin e tyre ose ushtror një ndikim të rëndësishëm mbi to së bashku me të drejtat e varura sipas (kapitulli IV p.5.1.) në të njëjtën bankë .
--	Shumës së pjesëmarrjeve, që nuk plotësojnë kushtet e mësipërme , së bashku me të drejtave të varura (kapitulli I p.5.1.) të tjera ndaj të njëjtave banka, i zbriten 10 për qind fondeve të veta (C+J) :
	Për shembull $M = (C+J) * 10$ për qind.
--	Mbetur pas zbritjes : $N = (L - M)$ n.q.s. është pozitive .
	Nëntotali $P = (K+N)$.
2	Garancitë e dhëna fondeve të garancive reciproke sipas kushteve të bankës qendrore.
	Nëntotali i pjesës që zbritet është (P+Q).
	Llogaritja përmbledhëse e kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë pas zbritjes IV :
1	Në qoftë se $J \leq (P+Q)$ atëherë :
--	Fondet e veta shtesë pas zbritjes $JA = 0$
--	Fondet e veta bazë $CA = C + J - (P+Q)$
2	Në qoftë se $J > (P+Q)$ atëherë :
--	Fondet e veta shtesë pas zbritjes $JA = J - (P+Q)$
--	Fondet e veta bazë $CA = C$
	Totali i kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë : $E = (JA+CA)$
	V .LLOGARITJA E KAPITALIT TË MBETUR
A	Kapitali rregullator për mbulimin e raportit të mjaftueshmërisë
B	Llogaritje e kapitalit të mbetur : $R = E - D$
C	Shpërndarja e kapitalit të mbetur midis kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë dhe përcaktimi i kapitalit bazë të mbetur dhe kapitalit shtesë të mbetur :
	1- Në qoftë se $JA \leq (D/2)$ atëherë :
	Mbetja e kapitalit shtesë është : $JB = 0$
	Mbetja e kapitalit bazë është : $CB = R$
	2- Në qoftë se $JA > (D/2)$ atëherë :
	Mbetja e kapitalit shtesë është : $JB = JA - (D/2)$
	Mbetja e kapitalit bazë është : $CB = CA - (D/2)$
	VI . KAPITALI MBISHTESË
1.	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese (kapitulli IV p. 3.1.)
2.	Letra me vlerë dhe detyrimet e varura për nevojat e rreziqeve të tregut :
	- Pjesa e detyrimeve të varura me afat, të cilat nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit shtesë për shkak të kufizimit 2.2.2.2. në kapitulli II, në udhëzimin "Për kapitalin

3	Detyrimet e varura, që nuk plotësojnë kushtet e nevojshme për t'u përfshirë në kapitalin shtesë , por që plotësojnë kërkesat e Bankës të Shqipërisë.
4	Detyrimet e tjera të varura me afat maturimi fillestar jo më vogël se 2 vjet .
	TOTALI I KAPITALIT MBISHTESË:OF=(OA+OB+OC+OD+OE)
	VII . LLOGARITJA E KUFIRIT MAKSIMAL TË TOTALIT NDËRMJET MBETJES TË KAPITALIT SHITESË DHE KAPITALIT MBISHTESË .
A	Shuma e kapitalit shtesë të mbetur me kapitalin mbishtesë para kufizimit: $S = JB + OF$
B	Kufiri maksimal :
	1- Në qoftë se $S \leq CB*2.5$ atëherë $U = S$
	2- Në qoftë se $S > CB*2.5$ atëherë $U = CB*2.5$
	VIII . TOTALI I KAPITALIT RREGULLATOR PËR MBULIMIN E RREZIQEVE TË TREGUT .
A	Shuma e kapitalit bazë të mbetur me "U" (Shuma "U" është shuma e kapitalit shtesë të mbetur me kapitalin mbishtesë pas kufizimit 4.1.) për mbulimin e rreziqeve të tregut: (W = CB + U)
B	Totali i kapitalit rregullator për mbulimin e rreziqeve të treg (X = D+W)

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 3

Llogaritja e kërkesës për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të përgjithshëm të lidhur me normat e interesit (në mijë lekë)

Emri i bankës
 Periudha raportuese
 Data e raportimit
 Metoda e maturimit
 Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
 Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

A) LLOGARITJA E POZICIONEVE TË PONDERUARA PËR ÇD

Zona 1 :

Totali i pozicioneve të ponderuara të kompensuar për hapësirë të zonës

Shuma e pozicioneve të ponderuara të pakompensuara *long*

Shuma e pozicioneve të ponderuara të pakompensuara *short*

Pozicioni i ponderuar i kompensuar

Pozicioni i ponderuar i pakompensuar

Zona 2 :

Totali i pozicioneve të ponderuara të kompensuar për hapësirë të zonës

Shuma e pozicioneve të ponderuara të pakompensuara *long*

Shuma e pozicioneve të ponderuara të pakompensuara *short*

Pozicioni i ponderuar i kompensuar

Pozicioni i ponderuar i pakompensuar

Zona 3 :

Totali i pozicioneve të ponderuara të kompensuar për hapësirë të zonës

Shuma e pozicioneve të ponderuara të pakompensuara *long*

Shuma e pozicioneve të ponderuara të pakompensuara *short*

Pozicioni i ponderuar i kompensuar

Pozicioni i ponderuar i pakompensuar

Totali i pozicioneve të ponderuara të kompensuar për të gjitha kohore të të tre zonave : $PPK = (PPKT1 + PPKT2 + PPKT3)$

B) LLOGARITJA E POZICIONEVE TË PONDERUARA MIDIS Z

1 -- sipas rradhës rritëse :

Kompensimi midis zonës 1 dhe zonës 2 :

Pozicioni i kompensuar midis PPpK1 dhe PPpK2

Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 2

Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 1

Kompensimi midis zonës 2 dhe zonës 3 :

Pozicioni i kompensuar midis PPpKZ2 dhe PPpK3

Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 3

Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 2

Kompensimi midis zonës 1 dhe zonës 3 :
Pozicioni i kompensuar midis PPKZ1 dhe PPKZ3
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 1
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 3
2 -- sipas rradhës rritëse :
Kompensimi midis zonës 2 dhe zonës 3 :
Pozicioni i kompensuar midis PPK2 dhe PPK3
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 2
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 3
Kompensimi midis zonës 2 dhe zonës 1:
Pozicioni i kompensuar midis PPKZ2 dhe PPK1
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 1
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 2
Kompensimi midis zonës 1 dhe zonës 3 :
Pozicioni kompensuar midis PPKZ1 dhe PPKZ3
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 1
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 3
C) LLOGARITJA E POZICIONIT MBETËS FINAL :
Pozicioni mbetës final : $PF = (R1 + R2 + R3)$
D) LLOGARITJA E KËRKESËS PËR KAPITAL RREGULATOR MBULIMIN E RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM TË NORMAVE INTERESIT :
PPK x 0.10
PPK1 x 0.40
PPK2 x 0.30
PPK3 x 0.30
PPKZ1/2 x 0.40
PPKZ2/3 x 0.40
PPKZ1/3 x 1.50
PF x 1.00
Kërkesa për kapital rregullator: $VA2 =$ $(S1+S2+S3+S4+S5+S6+S7+S8)$

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 4

Llogaritja e kërkesës për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të përgjithshëm të lidhur me normat e interesit (në mijë lekë)

Emri i bankës
 Periudha raportuese
 Data e raportimit
 Metoda e kohëzgjatjes .
 Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
 Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

A) LLOGARITJA E POZICIONEVE TË PONDERUARA PËR ÇD
Zona 1 :
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar <i>long</i>
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar <i>short</i>
Pozicioni i ponderuar i kompensuar
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar
Zona 2 :
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar <i>long</i>
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar <i>short</i>
Pozicioni i ponderuar i kompensuar
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar
Zona 3 :
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar <i>long</i>
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar <i>short</i>
Pozicioni i ponderuar i kompensuar
Pozicioni i ponderuar i pakompensuar
B) LLOGARITJA E POZICIONEVE TË PONDERUARA MIDIS Z
1 -- sipas rradhës rritëse:
Kompensimi midis zonës 1 dhe zonës 2 :
Pozicioni i kompensuar midis PPpK1 dhe PPpK2
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 2
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 1
Kompensimi midis zonës 2 dhe zonës 3 :
Pozicioni i kompensuar midis PPpKZ2 dhe PPpK3
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 3
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 2

Kompensimi midis zonës 1 dhe zonës 3 :
Pozicioni i kompensuar midis PpKZ1 dhe PpKZ3
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 1
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 3
2 -- sipas rradhës rritëse:
Kompensimi midis zonës 2 dhe zonës 3 :
Pozicioni i kompensuar midis PpK2 dhe PpK3
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 2
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 3
Kompensimi midis zonës 2 dhe zonës 1:
Pozicioni i kompensuar midis PpKZ2 dhe PpK1
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 1
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 2
Kompensimi midis zonës 1 dhe zonës 3 :
Pozicioni i kompensuar midis PpKZ1 dhe PpKZ3
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 1
Pozicioni i pakompensuar mbetës i zonës 3
C) LLOGARITJA E POZICIONIT MBETËS FINAL :
Pozicioni mbetës final : $PF = (RR1 + R2 + RR3)$
D) LLOGARITJA E KËRKESES PËR KAPITAL RREGULATOR MBULIMIN E RREZIKUT TË PËRGGJITHSHËM TË NORMAVE TË INTERESIT :
$PPK1 \times 0.40$
$PPK2 \times 0.30$
$PPK3 \times 0.30$
$PPKZ1/2 \times 0.40$
$PPKZ2/3 \times 0.40$
$PPKZ1/3 \times 1.50$
$PF \times 1.00$
Kërkesa për kapital rregullator :
$VA3 = (S1+S2+S3+S4+S5+S6+S7)$

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 5

Kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut të lidhur me normat e interesit (në mijë lekë)

Emri i bankës
 Periudha raportuese
 Data e raportimit
 Metoda e kohëzgjatjes .
 Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
 Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

A) PËR RREZIKUN SPECIFIK :

1) Letra me vlerë të emetuesve të kualifikuar : $RS1 = (sh1 + sh2$
 --Nga 0 deri në 6 muaj ponderohen me..... 0.25 për qinc
 --Nga 6 deri në 24 muaj ponderohen me..... 1.00 për qinc
 --Mbi 24 muaj ponderohen me..... 1.60 për qinc
 2) Fondet reciproke të normave ponderohen me4.00 për qinc
 3) Emetues të tjerë ponderohen me8.00 për qinc
 Kërkesa totale : $VA1 = (RS1 + RS2 + RS3)$

B) PËR RREZIKUN E PËRGJITHSHËM :

1 - Rreziku i përgjithshëm për çdo valutë :
 -- Sipas formularëve 3 dhe 4..... $VA10 = (VA2 -$

 -- Sipas formularëve 3 dhe 4..... $VA10 = (VA2 +$

 Kërkesa totale : $VA100 = \Sigma VA10$

C) Kërkesa për kapital rregullator për rrezikun e normave të inte

1) për rrezikun specifik :
 2) për rrezikun e përgjithshëm :
 Totali i kërkesës për kapital rregullator : $VA = (VA1 + VA100)$

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 6

Krahasimi i madhësisë të kapitalit rregullator të bankës me kërkesën për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut të lidhur me normat e interesit (në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Metoda e kohëzgjatjes.

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

A) MADHËSIA E KAPITALIT RREGULLATOR :

-- Sipas formularit 2 : $X = D + W$

B) KËRKESA PËR KAPITAL RREGULLATOR :

1 -- Për portofolin e tregtueshëm :

-- Sipas formularit 5 për rrezikun e normave të interesit :

-- Për rrezikun e ndryshimit të çmimit të tregut të titujve me të ar variabël :

-- Për rrezikun e rregullimeve të shlyerjes me kundërpartinë :

-- Për rrezikun e tejkalimeve të kufijve për rreziqet e mëdha:

2 -- Për këmbimet në valutë :

Shuma e tyre : $VF = (VA + VB + VC + VD + VE)$

Kërkesa totale për kapital rregullator : $Y = D + VF$

C) KRAHASIMI I (A) ME (B) :

Norma e përgjithshme e mbulimit : $Z = 100 \times (X/Y)$

Norma e përgjithshme minimale :

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 7

Kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut të lidhur me këmbimet në valutë (në mijë lekë)

Emri i bankës
 Periudha raportuese
 Data e raportimit
 Metoda e kohëzgjatjes .
 Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
 Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

	Kodi	Pozici neto
A) KRAHASIMI NDËRMJET :		
-Pozicionit neto global	VD1
-2 për qind e kapitalit rregullator global	XA
B) KËRKESA PËR KAPITAL RREGULLATOR:		
Në qoftë se $VD1 > XA$ atëherë :		
$VD = VD1 - XA$	VD

- 5- Kontrolli për mbulimin e rreziqeve të tregut konsiston në:
- 5.1. krahasimin e kërkesës për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut me kapitalin rregullator që banka ka për mbulimin e rrezikut të tregut, kërkesë e cila të jetë jo më e madhe se kapitali rregullator i bankës;
 - 5.2. në rast mosplotësimi të kushtit të mësipërm banka merr masa për ta plotësuar atë brenda një periudhe tremujore;
 - 5.3. në rast mosplotësimi nga banka të detyrimeve të pikës 5.2. dhe përsëritjes së mosplotësimit të detyrimit të pikës 5.1. atëherë Banka e Shqipërisë vepron ndaj saj në përputhje me nenin 44 dhe nenin 45, pika 3 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

KAPITULLI II

KAPITALI RREGULLATOR PËR MBULIMIN E RREZIQEVE TË TREGUT

- 1- Struktura e kapitalit rregullator të bankës për mbulimin e rreziqeve të tregut është:
 - 1.1. kapitali bazë i mbetur (CB) ;
 - 1.2. kapitali shtesë i mbetur (JB) ;
 - 1.3. kapitali mbishtesë .

2. Elementet përbërëse të kapitalit rregullator të bankës për mbulimin e rreziqeve të tregut janë:
 - 2.1. kapitali rregullator i mbetur, që është diferenca midis kapitalit rregullator të llogaritur sipas udhëzimit "Për kapitalin rregullator të bankës" me atë pjesë të tij, që shërben për respektimin e normës të mjaftueshmërisë (12 për qind e totalit të zërave të aktivit dhe të zërave jashtë-bilancit të ponderuar me rrezikun përkatës) të llogaritur sipas rregullores "Për mjaftueshmërinë e kapitalit rregullator".

Kapitali rregullator i mbetur është i përbërë nga:

 - 2.1.1. kapitali bazë i mbetur, i llogaritur sipas tabelës 5 të formularit nr. 2,
 - 2.1.2. kapitali shtesë i mbetur, i llogaritur sipas tabelës 5 të formularit nr.2,

 - 2.2. kapitali mbishtesë që përbëhet nga:
 - 2.2.1. fitimi i ndërmjetëm që nuk plotëson në mënyrë të njëkohëshme kushtet e mëposhtme:
 - të përcaktohet pasi të jenë kontabilizuar të gjitha shpenzimet e periudhës korresponduese, përfshirë këtu edhe shpenzimet për amortizime dhe provigjone ;
 - të jetë llogaritur për neto pasi të jenë zbritur tatimi mbi fitimin e parashikuar dhe dividendët e parashikuar;
 - të jetë verifikuar nga komiteti i kontrollit të bankës dhe nga eksperti kontabël i autorizuar;

 - 2.2.2. detyrimet e varura me karakteristikat e mëposhtme :
 - detyrimet e varura me afat, të përcaktuara në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës", që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit rregullator për arsye të kufizimit 2.2.2.2. në të njëjtin udhëzim,
 - instrumentet hibride dhe detyrimet e varura me afat, të përcaktuara në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës", që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit rregullator për arsye të kufizimit 2.2.2.1. në të njëjtin udhëzim,
 - detyrimet e varura, me afat maturimi fillestar jo më të vogël se 2 vjet, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - i) shlyhen në mënyrë të plotë dhe kontrata e emetimit ose e huasë nuk duhet të parashikojë asnjë rast të shlyerjes para afatit pa miratim të Bankës të Shqipërisë,
 - ii) pagimi i principalit apo i interesave të këtyre detyrimeve të varura nuk duhet, në asnjë rast, të pakësojë kapitalin rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut në mënyrë të tillë që ky kapital të mos bjerë nën nivelin e kërkuar për mbulimin e rreziqeve të tregut.

3. Shuma e kapitalit shtesë të mbetur së bashku me kapitalin mbishtesë të jetë jo më e madhe se 250 për qind e kapitalit bazë të mbetur .

4. Shuma e elementeve të përcaktuara në pikat 2.1. dhe 2.2. me kufizimin e pikës 3. përbën kapitalin rregullator global të bankës.
5. Kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut raportohet periodikisht në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, çdo gjashtëmuajor.

Me kërkesë të Bankës të Shqipërisë, në Departamentit të Mbikëqyrjes, mund të kërkohet raportimi i tij çdo tremujor.

6. Mënyra e raportimit të kapitalit rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut të llogaritur nga banka, bëhet sipas formularit të raportimit nr. 2.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

RREGULLORE

PËR KONTROLLIN E RREZIQEVE TË MËDHA

Miratuar me vendim nr. 78, datë 07.07.1999, ndryshuar me vendimin nr.119, datë 01.12.1999 dhe me vendimin nr.92, datë 05.12. 2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

TË PËRGJITHSHME

- 1- Kjo rregullore nxirret në zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 2- Subjektet e kësaj rregullore janë bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Në vazhdim të kësaj rregulloreje këto subjekte do të quhen "banka".
- 3- Qëllimi i rregullores është matja dhe kontrolli i përqëndrimit të rrezikut për të njëjtin përfitues, për të shmangur efektet negative financiare të bankës, si rezultat i përqëndrimit të tepërt të rrezikut mbi të njëjtin përfitues.

Kjo realizohet nëpërmjet respektimit të përhershëm dhe të njëkohshëm të :

- 3.1. një raport maksimal deri në 20 për qind ndërmjet tërësisë së rreziqeve që banka merr përsipër gjatë operacioneve të saj mbi çdo përfitues dhe kapitalit rregullator të vetë bankës;
 - 3.2. një raport maksimal deri në 700 për qind ndërmjet shumës së rreziqeve të mëdha dhe kapitalit rregullator të vetë bankës, duke kuptuar me rreziqe të mëdha të gjitha rreziqet që banka merr përsipër gjatë operacioneve të saj me të njëjtin përfitues, kur raporti i tyre me kapitalin rregullator është më i madh se 10 për qind;
 - 3.3¹. një raport maksimal deri në 30 për qind ndërmjet tërësisë të rreziqeve që banka merr përsipër gjatë operacioneve me çdo bankë dhe kapitalit rregullator të vetë bankës.
- 4- Për përdorimin e kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm përcaktohen si më poshtë :
- 4.1. me rrezik kuptojmë zërat e aktivitetit të bilancit dhe zërat jashtë-bilancit kur ata janë subjekt i falimentimit të kundërpartisë,
 - 4.2². me përfitues kuptojmë një person ose persona juridikë të lidhur midis tyre në marrëdhënie të tilla, që vështirësitë financiare të njërit apo të disave shkaktojnë vështirësi financiare në drejtim të aftësisë për të shlyer detyrimet e të tjerëve.
- Kuptimi i termit "persona juridikë të lidhur" është përcaktim i bërë në nenin 2, pika f, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.98 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 5- Raste të veçanta :
- 5.1 për personat e lidhur me bankën dhe me personelin e bankës, madhësia e rrezikut raportohet përpara këshillit drejtues çdo tremujor.

Niveli maksimal i madhësisë së rrezikut për personat e lidhur dhe për personelin e bankës fiksohet çdo vit nga këshilli drejtues.³

¹ Ndryshuar me vendimin nr.92, datë 5.12.2001 të Këshillit Mbikëqyrës.

² Ndryshuar me vendimin nr.119, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

³ Pika 5.2 është shfuqizuar me vendimin nr.119, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

PËRBËRJA, MÉNYRA E LLOGARITJES

- 6- Raportet e përcaktuara në pikat 3.1 dhe 3.2⁴ përbëhen nga :
- 6.1 kapitali rregulator i llogaritur sipas udhëzimit "Për kapitalin rregullator";
 - 6.2 rreziqet e lidhura me zërat e aktivitetit dhe me zërat jashtë-bilancit.
- 7- Për të llogaritur raportet e rreziqeve nga zërat e aktivitetit dhe zërat jashtë-bilancit përpara ponderimit:
- 7.1 përjashtohen zërat e aktivitetit dhe zërat jashtë-bilancit, që bëjnë pjesë në kapitalin rregullator si elemente zbritëse;
 - 7.2 zbriten :
 - 7.2.1 nga aktivitetet përkatëse të gjitha fondet rezervë të llogaritura për mbulimin e humbjeve të mundshme,
 - 7.2.2 garancitë dhe kolateratet e marra, në qoftë se ato janë efektive për një periudhë kohore jo më të vogël se periudha kohore e rreziqeve, të cilën mbulojnë. Në to përfshihen :
 - letra me vlerë të emetuara nga qeveritë dhe nga bankat qendrore të vendeve të zonës A, nga Komuniteti Evropian dhe nga administrata lokale dhe rajonale e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian ;
 - depozita në *cash* pranë bankës kredidhënëse, pranë bankës-mëmë të bankës kredidhënëse ose pranë bankave të kontrolluara nga banka kredidhënëse ;
 - çertifikata depozitash apo instrumente të ngjashme me to, të emetuara nga banka kredidhënëse, nga banka-mëmë e bankës kredidhënëse ose nga banka të kontrolluara nga banka kredidhënëse;
 - garancitë e lëshuara nga një palë e tretë që ka këto karakteristika :
 - A)⁵ Me palë të tretë kuptojmë:
 - administratat qendrore të vendeve të zonës A, organizma të njohur dhe të specializuar në emetimin e garancive në emër të vendeve të treta, veçanërisht në lidhje me sigurimin e tregtisë së jashtme;
 - bankat qendrore të vendeve të zonës A;
 - institucionet financiare ndërkombëtare.
 - B) Rreziku konsiderohet nga banka që përfiton garancinë si rrezik i marrë përsipër nga pala e tretë dhe jo nga klienti. Banka garantuuese merr përsipër në çdo rast rrezikun mbi klientin.
 - C) Garancia e dhënë nga pala e tretë duhet të jetë direkte dhe e pakushtëzuar.

Banka e Shqipërisë kërkon një marrëveshje formale për garancinë dhe mund të kundërshtojë marrjen në konsideratë të saj .

- 8⁶ - Rreziqet e pakësuara me madhësinë e fondeve rezervë dhe me madhësinë e garancive dhe të kolateraleve të marra (sipas pikës 7.2.2 të rregullores), ponderohen me normat e përcaktuara në pikën 8 të rregullores "Për mjaftueshmërinë e kapitalit", të miratuar me vendimin nr.58, datë 05.05.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- 9- Bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë, Departamenti Mbikëqyrës, çdo tremujor. Në raste të veçanta, kur Banka e Shqipërisë e shikon të arsyeshme, mund të kërkojë përpilimin e raporteve në çdo kohë. Raportimi bëhet sipas formularëve të mëposhtëm të cilët janë pjesë e sistemit raportues .

⁴ Ndryshuar me vendimin nr.119, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

⁵ Ndryshuar me vendimin nr.119, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

⁶ Ndryshuar me vendimin nr.119, datë 01.12.1999 të Këshillit Mbikëqyrës.

10- Kontrolli :

- 10.1. bankat duhet të kenë një sistem të brendshëm drejtimi dhe mbikëqyrjeje. Ky sistem të jetë i aftë të masë, të kontrollojë dhe të respektojë në çdo kohë raportet e vendosura në këtë rregullore. Banka e Shqipërisë kërkon, sa herë e gjykon të arsyeshme, një raport me shkrim lidhur me sistemin e mësipërm, gjithashtu ai është objekt edhe i inspektimit në vend nga Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë ;
 - 10.2. në rast se banka nuk respekton raportet e vendosura në këtë rregullore atëherë ajo raporton në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, në periudha kohore më të shpeshta, të përcaktuara nga Departamenti Mbikëqyrjes. Banka është e detyruar të respektojë raportet e vendosura jo më larg se muaji i parë i tremujorit pasardhës;
 - 10.3. në rast mospërbushjeje nga bankat të detyrimeve të pikës 10.1. dhe të pikës 10.2. Banka e Shqipërisë vepron ndaj tyre në përputhje me ligjin nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 44 , neni 45 pika 3.
11. Rregullorja nr. 7/4, datë 26 shkurt 1997 "Për normat e mbikëqyrjes për nivelin maksimal të kredive", shfuqizohet.
 12. Kjo rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 1

MATJA DHE KONTROLLI I RREZIKUT TË PËRQENDRIMIT (në mijë lekë)

Emri i bankës
 Periudha raportuese
 Data e raportimit
 Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
 Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

KAPITALI RREGULLATOR
KAPITALI RREGULLATOR NË FILLIM TË PERIUDHËS :
SHTESAT (+) / PAKËSIMET (-) GJATË PERIUDHËS :
KAPITALI RREGULLATOR NË FUND TË PERIUDHËS :
(20 për qind) E KAPITALIT RREGULLATOR :
(10 për qind) E KAPITALIT RREGULLATOR :
(700 për qind) E KAPITALIT RREGULLATOR :

RREZIKU I PËRQENDRIMIT				
Emri, mbiemri, adresa e përfituesit	Klasifikimi i rrezikut bruto të ponderuar me rrezikun përkatës			
	0 për qind	20 për qind	50 për qind	100 për qind
	(1)	(2)		

RREZIKU I PËRQENDRIMIT	
Emri, mbiemri, adresa e përftuesit	Klasifikimi i të gjithë
.....	
.....	
.....	
TOTALI I RREZIQEVE TË MËDHA:	
RAPORTI MAKSIMAL :	600 p

RREGULLORE

“PËR INVESTIMET NGA BANKAT NË KAPITALIN E SHOQËRIVE TREGTARE”

Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 42, datë 06.06.2001.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” neni 12, gërma (a) dhe të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” neni 31, pika 4 dhe neni 33, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton rregulloren “Për investimet nga bankat në kapitalin e subjekteve tregtare” (si më poshtë “Rregullore”).

Neni 1

Subjektet e kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Në vazhdim, për plotësimin e kërkesave të kësaj rregulloreje këto subjekte do të quhen “bankë”.

Neni 2

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekuilibrit ndërmjet aktivitetit të lirë të investimit të bankave në kapitalin e shoqërive tregtare dhe respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrëse.

Neni 3

Me investim të bankave në kapitalin e shoqërive tregtare, sipas përdorimit në këtë rregullore, konsiderohen blerjet e aksioneve të shoqërive tregtare që nuk janë banka apo institucione financiare ose pjesëmarrja si ortak në këto shoqëri tregtare me një shumë më të madhe se 10 për qind të kapitalit të tyre ose vënia në pronësi të përbashkët, apo bashkimi me shoqëri të tjera .

Nuk kërkohet miratim nga Banka e Shqipërisë për :

- a) pjesëmarrjet në kapitalin e bankave;
- b) pjesëmarrjet në kapitalin e subjekteve financiare jobanka, të licencuara ose jo nga Banka e Shqipërisë.

Neni 4

Objektivi i vendosjes së këtyre raporteve mbikëqyrëse është që bankat të mos ushtrojnë në mënyrë të pakufizuar investimin në kapitalin e shoqërive tregtare, në mënyrë që ato të mos përballen në mënyrë të pakontrolluar, me rreziqe të kësaj natyre.

Neni 5

Bankat lejohet të investojnë në kapitalin e subjekteve tregtare :

- 5.1. Pa miratim të Bankës të Shqipërisë :
 - a) kur investimi në kapital është jo më i madh se 10 për qind e kapitalit të shoqërisë tregtare;
 - b) kur secili investim në kapital është jo më i madh se 15 për qind e kapitalit rregullator të bankës;
 - c) kur totali i investimeve në kapital është jo më i madh se 60 për qind e kapitalit rregullator të bankës.
- 5.2. Me miratim të Bankës të Shqipërisë :
 - a) kur investimi në kapital është më i madh se 10 për qind, por më i vogël se 50 për qind, i kapitalit të shoqërisë tregtare;
 - b) kur investimi në kapital është më i madh se 15 për qind, por më i vogël se 25 për qind, i kapitalit rregullator të bankës.
- 5.3. Teprica e investimit në kapital mbi raportet e pikës 5.1., gërma b, zbritet nga kapitali rregullator.

Neni 6

Banka e Shqipërisë miraton kryerjen e investimeve në kapital, të parashikuara në pikën 5.2., kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme :

- a) subjektet tregtare të jenë me fitim, të paktën dy vitet e fundit, dhe kapitali i tyre të jetë jo më i vogël se kapitali minimal i themelimit (themeltar) ;
- b) norma e mjaftueshmërisë të kapitalit të bankës, pas investimit në kapitalin e subjekteve tregtare, të jetë jo më e vogël se 12 për qind ;
- c) në qoftë se subjektet tregtare janë shoqëri anonime rezidente, të jenë të listuara në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve.

Neni 7

Për respektimin e raporteve të vendosura në nenin 5 të kësaj rregulloreje :

- a) si kapital rregullator shërben ai i përcaktuar në udhëzimin "Për kapitalin rregullator", pasi janë bërë zbritjet e parashikuara në pikën 5.3. ;
- b) çdo pjesëmarrje të vlerësohet me vlerën neto kontabile.

Neni 8

Në rast mospërmbushjeje nga bankat të detyrimeve të neneve 5 dhe 6, atëherë Banka e Shqipërisë vepron ndaj tyre në përputhje me ligjin nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kreu VII "Shkeljet dhe Dënimet".

Neni 9

- 9.1 Miratimi i investimit në pjesëmarrje, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 5.2., jepet nga administratorët e Bankës së Shqipërisë. Për përgatitjen e propozimeve për refuzimin ose për miratimin ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes. Për këtë qëllim :
- 9.2. Secila bankë është e detyruar të dërgojë kërkesën përkatëse në Departamentin e Mbikëqyrjes. Kërkesa të përmbajë :
 - a) emrin, datën e themelimit dhe aktivitetin e shoqërisë përkatëse ;
 - b) dokumentacionin justifikues :
 - bilanci, llogaria e rezultatit të shoqërisë tregtare, për dy vitet e fundit dhe i periudhës ushtrimore më të fundit, së bashku me opinionin e auditorëve të pavarur, që vërtetojnë se kushtet e pikës 5.2, shkronja a, janë të plotësuara,
 - bilanci, llogaria e rezultatit, kapitali rregullator, aktivet dhe zërat e tjerë jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun, të bankës, që vërtetojnë se kushtet e pikës 5, shkronja b, janë të plotësuara ,
 - çdo informacion shtesë që mund të kërkohej nga Departamenti i Mbikëqyrjes.
- 9.3 Me urdhër të drejtuesit të Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, ngrihet një grup pune i përbërë nga :
 - a) inspektori përkatës i bankës ;
 - b) përgjegjësi i grupit të inspektimit më të fundit, i pjesshëm apo i plotë ;
 - c) analisti i caktuar nga drejtuesi.Grupi i punës ka të drejtë të kërkojë çdo informacion shtesë jo më vonë se 3 ditë nga data e caktimit të tij.
- 9.4. Banka e Shqipërisë është e detyruar të japë përgjigje jo më vonë se 10 ditë nga plotësimi i dokumentacionit, por jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës.
- 9.5 Për shoqëritë e kuotuar në bursë përgjigja jepet brenda 5 ditëve.

Neni 10

Rregullorja "Për pjesëmarrje në investime në kapitalin e shoqërive tregtare nga bankat dhe degët e bankave të huaja" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 107, datë 03.11.99 shfuqizohet.

Neni 11

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
SHKËLQIM CANI

UDHËZIM

MBI ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT

Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 61, datë 05.07.2000.

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1.1 Ky udhëzim del në zbatim të nenit 3, pika 3 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të nenit 29, pika 1, gërma "d", të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 1.2 Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja, që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Në vazhdim të këtij udhëzimi këto subjekte do të quhen "bankë".
- 1.3 Qëllimi i këtij udhëzimi është dhënia e rekomandimeve lidhur me administrimin e rrezikut, që vjen si rezultat i pozicionit të bankës në letrat me vlerë, në instrumentet e portofolit të tregtueshëm dhe të lëvizjes së normës së interesit si edhe vlerësimi nga bankat i mjaftueshmërisë dhe i efektivitetit të administrimit të rrezikut të normës së interesit.

Neni 2

- 2.1 Rreziku, që vjen nga ndryshimi i normës së interesit përfshin në të njëjtën kohë të ardhurat e bankës si edhe vlerën ekonomike të mjeteve të saj, të burimeve dhe të zërave jashtë bilancit.
- 2.2 Administrimi efektiv i rrezikut të normës së interesit realizohet nëpërmjet zbatimit të katër elementeve bazë të mëposhtme, që kanë të bëjnë me administrimin e mjeteve, të burimeve dhe të zërave jashtë bilancit:
 - A- mbikëqyrje të përshtatshme nga këshilli drejtues dhe nga drejtuesit e lartë të bankës;
 - B- politika dhe procedura të mjaftueshme të administrimit të rrezikut;
 - C- matje, monitorim dhe kontroll i duhur i rrezikut;
 - D- kontroll tërësor i brendshëm dhe i pavarur.

Mënyrat e veçanta të zbatimit të elementeve të mësipërme nga bankat varen nga kompleksiteti dhe natyra e aktivitetit të bankës si edhe nga niveli i ekspozimit kundrejt rrezikut të normës së interesit.

KREU II ELEMENTET BAZË TË ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT

Neni 3

Mbikëqyrje e përshtatshme nga këshilli drejtues i bankës dhe nga drejtuesit e lartë.

- 3.1 Me qëllim të ushtrimit të përgjegjësive të tij, këshilli drejtues i bankës miraton strategjitë dhe politikat në lidhje me administrimin e rrezikut të normës së interesit dhe përcakton hapat e nevojshëm që drejtuesit e lartë të bankës duhet të marrin për të monitoruar dhe për të kontrolluar këtë rrezik. Me qëllim që të vlerësojë monitorimin dhe kontrollin e një rreziku të tillë, këshilli drejtues duhet të informohet rregullisht për ekspozimin e bankës ndaj rrezikut të normës së interesit.
- 3.2 Drejtuesit e lartë të bankës duhet të vlerësojnë nëse struktura e biznesit të bankës dhe niveli i rrezikut të normës së interesit, administrohen në mënyrë efektive dhe nëse janë hartuar politika dhe procedura përkatëse për të kontrolluar dhe për të kufizuar këtë rrezik, si edhe ka burime të mjaftueshme për vlerësimin dhe për kontrollin e këtij rreziku.

- 3.3 Banka përcakton personelin dhe njësinë përkatëse përgjegjëse për administrimin e rrezikut të normës së interesit, dhe duhet të sigurojë ndarjen e përshtatshme të detyrave në elementet më të rëndësishme të procesit të administrimit të rrezikut, me qëllim shmangien e konflikteve të mundshme të interesit.
- 3.4 Banka përcakton qartë detyrat, funksionet e matjes, të monitorimit dhe të kontrollit të rrezikut, të cilat janë të pavarura nga pozicionet funksionale në bankë. Raportimi në lidhje me ekspozimin e rrezikut bëhet tek drejtuesit e lartë dhe në këshillin drejtues.

Neni 4

Politika dhe procedura të mjaftueshme të administrimit të rrezikut.

- 4.1 Bankat përcaktojnë qartë politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut të normës së interesit, kufijtë e tyre si edhe përputhjen me natyrën dhe me aktivitetin e bankës. Administrimi i rrezikut të normës së interesit duhet të jetë i plotë dhe të përfshijë të gjitha njësitë e bankës, së bashku me degët e bankës jashtë vendit. Ai duhet të përfshijë edhe rreziqe të tjera të lidhura me të. Politikat dhe procedurat e rrezikut të normës së interesit rishikohen periodikisht, dhe ndryshohen sa herë të jetë e nevojshme.
- 4.2 Bankat të identifikojnë rreziqet që lindin nga produktet dhe nga shërbimet e reja dhe të sigurojnë se këto i nënshtrohen procedurave dhe kontrolleve të mjaftueshme përpara fillimit të ndërmarrjes së tyre.

Neni 5

Matja, monitorimi dhe kontrolli i rrezikut.

- 5.1 Bankat hartojnë sisteme të matjes së rrezikut të normës së interesit, që të përfshijnë të gjitha burimet nga të cilat rrjedh ky rrezik, si dhe bëjnë vlerësimin e efektit të ndryshimit të normës së interesit në përputhje me hapësirën e veprimtarisë së tyre.
- 5.2 Bankat përcaktojnë kufijtë e veprimit dhe praktika të tjera, të cilat mbajnë ekspozimin e rrezikut të normës së interesit brenda niveleve të përcaktuara në politikat e brendshme të bankës.
- 5.3 Bankat masin ndjeshmërinë ndaj humbjeve të rezultuara, duke parashikuar ndryshimet e pafavorshme në kushtet e tregut, përfshirë edhe dështimin e parashikimeve kryesore të bankës. Rezultatet e kësaj matjeje duhet të merren parasysh kur politika dhe kufijtë, në lidhje me rrezikun e normës së interesit, janë rishikuar ose përditësuar.
- 5.4 Bankat duhet të kenë sisteme të përshtatshme informacioni për matjen, për monitorimin, për kontrollin dhe për raportimin e ekspozimit të rrezikut të normës së interesit. Raportet duhet t'i paraqiten periodikisht këshillit drejtues të bankës dhe drejtuesve të lartë.

Neni 6

Kontrolli tërësor i brendshëm dhe i pavarur.

- 6.1 Bankat duhet të kenë një sistem të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm lidhur me procesin e administrimit të rrezikut të normës së interesit.
- 6.2 Komponenti themelor i sistemit të kontrollit të brendshëm përfshin rishikime të rregullta të pavarura dhe vlerësime të efektivitetit të sistemit dhe, ku është e nevojshme, siguron se është bërë rishikimi dhe përmirësimi i kontrollit të brendshëm të bankës.

KREU III TË TJERA

Neni 7

- 7.1 Në zbatim të këtij udhëzimi, bankat dhe degët e bankave të huaja brenda një periudhe gjashtëmujore nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, duhet të hartojnë një kuadër rregullativ të plotë për administrimin e rrezikut të normës së interesit.
- 7.2 Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI KËSHILLIT MBIKËQYRËS
SHKËLQIM CANI

RREGULLORE

“PËR ADMINISTRATORËT E BANKAVE DHE TË DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA”

Miratuar me Vendimin nr. 120, datë 30. 12. 2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1. Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim për thjeshtësi për bankat dhe degët e bankave të huaja është përdorur termi “bankë”.

1.2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizmin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e bankës si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.

1.3. Subjekte të kësaj rregulloreje janë këta administratorë:

1.3.1. anëtarët e këshillit drejtues,

1.3.2. anëtarët e komitetit të kontrollit,

1.3.3. drejtuesit ekzekutivë të bankës/ të degës së bankës së huaj:

a. drejtori i përgjithshëm i bankës/drejtori i degës së bankës së huaj,

b. zëvendësdrejtori i përgjithshëm i bankës/zëvendësdrejtori i degës së bankës së huaj,

c. drejtues departamenti/drejtorie.

1.4. Në kuptimin e kësaj rregulloreje, si administratorë të përcaktuar në nenin 1, pikat 1.3.1 dhe 1.3.2 për degët e bankave të huaja, do të konsiderohen anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe anëtarët e organeve kontrolluese të bankës-mëmë, të cilët nuk janë subjekt i kësaj rregulloreje.

Neni 2

KUALIFIKIMI, REPUTACIONI DHE PËRVOJA

2.1. Të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si administratorë duhet të kenë reputacion të mirë dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, për sa i përket figurës së tyre morale dhe aftësisë profesionale.

2.2. Të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si administratorë të kenë arsimin e lartë, si rregull në fushën e ekonomisë ose të jurisprudencës.

- 2.3 Nëse administratori nuk e ka arsimin e lartë në fushën e shkencave ekonomike ose të jurisprudencës, por në një fushë tjetër, atëherë ai/ajo duhet të ketë punuar në sektorin bankar, të paktën pesë vjet. Nëse ky administrator zoteron një titull/gradë shkencore në fushën e shkencave ekonomike ose juridike, atëherë, sipas rastit, ai i nënshtrohet kërkesave të paragrafit 2.5, 2.6 ose 2.7.
- 2.4 Administratorët zgjidhen me kriterin e profesionalizmit dhe të përvojës në:
- sektorin financiar;
 - biznese me madhësi të përafërt me bankën e propozuar (totali i aktiveve);
 - fushën akademike të ekonomisë ose të jurisprudencës;
 - administrimin e pasurive të patundshme;
 - fushën e auditimit;
 - titull/gradë shkencore në fushën e shkencave ekonomike apo juridike.
- 2.5 Administratorët e përcaktuar në nenin 1, pikat 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.3 gërmat "a" dhe "b", duhet të kenë përvojë për një periudhë jo më pak se tre vjet, në ushtrimin e aktiviteteve ose të funksioneve të parashikuara në pikën 2.4 të këtij neni.
- 2.6 Administratorët e përcaktuar në nenin 1, pika 1.3.3, gërma "c" duhet të kenë përvojë për një periudhë jo më pak se dy vjet në ushtrimin e aktiviteteve ose të funksioneve të parashikuara në pikën 2.4 të këtij neni.
- 2.7 Administratorët e përcaktuar në nenin 1, pika 1.3.2, përveç kërkesave të pikës 2.4 të këtij neni, duhet të kenë përvojë për një periudhë jo më pak se tre vjet, në kryerjen e veprimtarisë së kontabilitetit dhe/ose të auditimit.

Neni 3

KËRKESA DHE DOKUMENTACIONI

- 3.1. Kërkesa për miratimin nga Banka e Shqipërisë të kandidaturës së propozuar bëhet nga banka, në bazë të vendimit të:
- a) asamblesë së aksionerëve për anëtarët e këshillit drejtues dhe për anëtarët e komitetit të kontrollit të bankës,
 - b) këshillit drejtues të bankës për administratorët e përcaktuar në nenin 1, pika 1.3.3,
 - c) organit vendimmarrës të bankës-mëmë ose personit të autorizuar prej tij, për emërimin e administratorëve të degës të bankës së huaj, të përcaktuar në pikën 1.3.3.
- 3.2. Kërkesa, ku përcaktohet pozicioni i propozuar i administratorit, shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
- a- një kopje e notuar e diplomës së arsimit të lartë, si rregull, në ekonomi ose në jurisprudencë;
 - b- CV-ja e firmosur, sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
 - c- të dhëna të detajuara për veprimtarinë tregtare dhe për bizneset e tyre për shtatë vjetët e fundit si dhe ato në të cilat ata kanë pjesëmarrje influencuese;
 - d- të paktën një rekomandim lidhur me aftësinë profesionale (nga persona eprorë, akademikë dhe/ose nga punëdhënësit e mëparshëm);
 - e- deklaratë personale në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;
 - f- deklaratë personale e çdo administratori se gjatë aktivitetit të tij të punës nuk ka kryer veprimtari që bien në kundërshtim me rastet e parashikuara në nenin 21 pika 2, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
 - g- deklaratë personale për shkallën e interesave me përfitim material ose të marrëdhënieve me përfitim material me bankën që e propozon;
 - h- 1) për administratorët shtetas shqiptarë, dëshmi penaliteti e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe vërtetime nga gjykata dhe prokuroria që nuk janë në ndjekje penale ose në proces gjyqësor penal;

- 2) për administratorët shtetas të huaj, kërkohen vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të vendeve të tyre, ku të vërtetohet se nuk janë dënuar më parë, nuk janë në ndjekje penale ose në proces gjyqësor penal;
- i- për administratorët shtetas të huaj dokumentacioni i mësipërm të jetë i noteruar dhe i vërtetuar pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme ose pranë çdo institucioni tjetër sipas legjislacionit përkatës të vendit të tyre, dhe më tej të përkthehet në shqip dhe të noterohet;
 - j- për personat e huaj të propozuar për administratorë, të paraqitet në Bankën e Shqipërisë kopja e kërkesës së depozituar pranë organeve përkatëse për marrjen e lejes së qëndrimit dhe të lejes së punës.

Me paraqitjen e këtij dokumenti dhe me plotësimin e të gjitha kërkesave të tjera, Banka e Shqipërisë jep një miratim të përkohshëm (deri në gjashtë muaj) për administratorin, i cili me marrjen e këtij miratimi ka të drejtën e përfaqësimit të bankës. Vetëm pas paraqitjes së dokumentit zyrtar të lejes së qëndrimit dhe të lejes së punës nga organet përkatëse në Bankën e Shqipërisë, jepet miratimi për emërimin e administratorit;

Neni 4

KUFIZIMET

- 4.1. Nuk lejohet të caktohen si administratorë të bankës dhe lirohen nga kjo detyrë administratorët ekzistues, në rastet e parashikuara në nenin 21, pika 2, të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 4.2. Administrator i bankës, nuk mund të pranohet një person, i cili ka ndërprerë marrëdhëniet juridike me bankën apo me çdo subjekt tjetër që kryen veprimtari bankare, për shkak të shkeljeve të akteve ligjore e nënligjore, për shkak të shpërdorimit të detyrës si dhe për paaftësi në kryerjen e funksioneve drejtuese.
- 4.3. Kryetari i këshillit drejtues nuk mund të jetë njëkohësisht edhe administrator i përcaktuar sipas nenit 1, pika 1.3.3.
- 4.4. Administratorët e përcaktuar sipas nenit 1, pika 1.3.3, mund të jenë njëkohësisht antarë të këshillit drejtues, por ata duhet të përbëjnë jo më shumë se një të tretën e tij.
- 4.5. Administratorët e përcaktuar sipas nenit 1, pika 1.3.3, nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të komitetit të kontrollit.
- 4.6. Nuk lejohet qenia si administrator sipas pikës 1.3.3. njëkohësisht në më shumë se një bankë.
- 4.7. Nuk lejohet qenia si administrator, sipas pikës 1.3.2., i personave të punësuar tek eksperti kontabël i autorizuar i bankës.
- 4.8. Deri 2/3 e administratorëve të përcaktuar sipas nenit 1, pika 1.3.2., mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të këshillit drejtues të bankës.

Neni 5

MIRATIMI

- 5.1- Bankat i emërojnë përfundimisht administratorët vetëm pas marrjes paraprakisht të miratimit nga Banka e Shqipërisë.
- 5.2- Banka e Shqipërisë jep miratimin e saj brenda 30 ditëve pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë për marrjen e miratimit të administratorit të propozuar.
- 5.3- Banka, për çdo ndryshim pozicioni të administratorëve të miratuar, njofton me shkrim Bankën e Shqipërisë duke paraqitur:
 - dokumentin e emërimit sipas nenit 3, pika 3.2 të kësaj rregulloreje,
 - CV-në e plotësuar sipas formularit nr.1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, për të vlerësuar eksperiencën e administratorit.
- 5.4- Banka e Shqipërisë mund të kërkojë në mënyrë konfidenciale nëpërmjet Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes, arsyet e largimit nga puna në bankë të administratorit të saj.

- 5.5- Miratimi i administratorit bëhet nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë.
- 5.6- Për parregullsi të vërejtura pas miratimit të administratorit, Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të rishqyrtuar edhe një herë miratimin e administratorit në një kohë të mëvonshme, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe vetëm me miratim të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe për një periudhë jo më larg se një vit kalendarik nga dita e miratimit të parë.

Neni 6

REFUZIMI

- 6.1 Kur vërtetohet se administratori i propozuar nuk plotëson kushtet e kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e miratimit.
- 6.2 Vendimi i refuzimit të administratorit të bankës merret prej administratorit përgjegjës të Bankës të Shqipërisë. Një kopje e vendimit i dërgohet bankës/degës së bankës së huaj brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 7

REVOKIMI

- 7.1 Revokimi i miratimit të dhënë nga Banka e Shqipërisë bëhet kur:
- a) vërtetohet njëri nga rastet e parashikuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje;
 - b) personi ka paraqitur informacion të rremë për marrjen e miratimit nga Banka e Shqipërisë për emërimin si administrator i bankës;
 - c) në mbështetje të nenit 5, pika 5.6. të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë konstaton se emërimi i administratorit nuk është bërë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
- 7.2 Vendimi i revokimit të miratimit të dhënë nga Banka e Shqipërisë për administratorin e bankës, merret nga administratori përgjegjës i Bankës së Shqipërisë. Një kopje e vendimit i dërgohet bankës brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 8

SHKARKIMI

- 8.1 Banka e Shqipërisë ka të drejtë, që në përputhje me nenin 44, pika 2, gërma "e", e ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe me aktet rregullative të miratuara, të kërkojë shkarkimin dhe/ose largimin e një ose të gjithë administratorëve të bankës/degës së bankës së huaj, nëse vëren shkelje të parashikuara në ligj dhe/ose aktet rregullative të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

Kërkesa për shkarkim dhe/ose largim, drejtuar organeve vendimmarrëse të bankës, nënshkruhet nga administratori përgjegjës i Bankës së Shqipërisë.

Neni 9

REGJISTRI I ADMINISTRATORËVE

- 9.1- Çdo miratim, revokim, shkarkim apo largim i administratorit të bankës, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, regjistrohet në një regjistër të veçantë në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.
- 9.2- Çdo refuzim i miratimit të administratorit të bankës, regjistrohet në një listë të veçantë në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

Neni 10

DISPOZITA TË FUNDIT

- 10.1- Bankat përshtatin kodin e rregullave të etikës për administratorët jo më vonë se 60 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
- 10.2- Administratorët e miratuar nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullores "Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja" miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 13, datë 17.02.1999 nuk janë subjekt i kësaj rregulloreje. Për rizgjedhjen e tyre, të plotësohen detyrimet e kësaj rregulloreje.
- 10.3- Rregullorja "Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja" miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 13, datë 17.02.1999 dhe ndryshimet e saj të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 17, datë 01.03.2000, shfuqizohen.
- 10.4- Kjo rregullore u miratuar me vendimin nr. 120, date 30.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

FORMULARI 1 CURRICULUM VITAE

1. Të dhëna personale

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendlindja:

Shtetësia:

Adresa e vendbanimit aktual:

Gjendja civile: !___! I/e martuar!___! beqar/e !___! I/e divorcuar

2. Arsimi i kryer

Ju lutemi filloni nga arsimi i mesëm

1. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	
Diploma apo çertifikata e fituar	
2. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	
Diploma apo çertifikata e fituar	

3. Njohja e gjuhëve të huaja

Gjuha e huaj	Njohja në lexim	Njohja në

Shënoni vlerësimin me numrat nga 5 – 1 (5 = shumë mirë, 4 = mirë, 3 = mjaftueshëm etj.).

4. Pjesëmarrje në këshilla drejtuese/ në shoqata profesionistësh

5. Kurse kualifikimi të kryera

6. Eksperienca profesionale

Përshkrimi i detajuar i punësimit. Ju lutemi filloni nga punëdhënësi më i fundit

Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyrë e punësimit	a. i punësuar b. i vetëpunë c. i papunë d. ndjekje e s nga puna (ful
Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Natyrë e biznesit (publik ose privat)	
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a. Dorëheqje b. Shkurtim i c. Dalje në d. Përfundim e. Pushim ng f. Të tjera Specifiko
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyrë e punësimit	a. i punësuar b. i vetëpunë c. i papunë d. ndjekje e s nga puna (ful
Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Natyrë e biznesit (publik ose privat)	
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a. Dorëheqje b. Shkurtim i c. Dalje në d. Përfundim e. Pushim ng f. Të tjera Specifiko
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyrë e punësimit	a. i punësuar b. i vetëpunë c. i papunë d. ndjekje e s nga puna (ful
Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Natyrë e biznesit (publik ose privat)	
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a. Dorëheqje b. Shkurtim i c. Dalje në d. Përfundim e. Pushim ng

Emri dhe mbiemri i administratorit të propozuar.

(firma)

Data

RREGULLORE

PËR “MADHËSINË DHE PLOTËSIMIN E “KAPITALIT FILLESTAR MINIMAL” PËR VEPRIMTARITË E LEJUARA PËR BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA TË LICENCUARA”

Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 51, datë 22.04.1999.

1. Baza ligjore e kësaj rregulloreje janë neni 8, neni 26 i ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” si dhe rregullorja “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara sipas rregullores “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”.
3. Qëllimi i saj është plotësimi i “kapitalit fillestar minimal” nga bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara përpara publikimit nga Banka e Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal dhe përcaktimit të madhësisë të kapitalit për bankat dhe degët e bankave të huaja që kërkojnë të ushtrojnë veprimtaritë financiare, në përputhje me pikën 4 dhe me pikën 5 të nenit 26, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” .
4. Banka e Shqipërisë kërkon plotësimin e “kapitalit fillestar minimal” edhe për bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara para publikimit nga Banka e Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal, për këtë qëllim përcakton afatet kohore dhe shumat përkatëse me akte të veçanta nënligjore.
 - 4.1. Për plotësimin e “kapitalit fillestar minimal”, kur kapitali i bankës ose i degës së bankës së huaj është paguar në lekë, shuma për plotësim është e barabartë me diferencën e “kapitalit fillestar minimal” të caktuar në publikimin e fundit të Bankës të Shqipërisë të ndryshimit të “kapitalit fillestar minimal” dhe të tepricës së grupit 571 të “Manualit të Kontabilitetit Bankar”.
 - 4.2. Për plotësimin e “kapitalit fillestar minimal”, kur kapitali i bankës ose i degës së bankës së huaj është paguar në dollarë amerikanë:
 - 4.2.1 fillimisht, me miratimin e Bankës së Shqipërisë, subjektet kalojnë në kapitalin e paguar grupi 571, atë shumë që ndodhet në grupin 574 “diferencë rivlerësimi” të “Manualit të Kontabilitetit Bankar”, i cili shpreh ndryshimin e kursit të këmbimit të dollarit amerikan nga momenti i pagimit të kapitalit deri në momentin e dhënës;
 - 4.2.2. shuma e kapitalit që duhet plotësuar është e barabartë me diferencën e “kapitalit fillestar minimal” të caktuar në publikimin e fundit të Bankës të Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal dhe shumës së tepricës të grupit 571, të krijuar pas veprimit sipas 4.2.1.
5. Veprimtaritë e lejuara sipas madhësisë së kapitalit:
 - 5.1. Bankat e licencuara për të kryer veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 26, pika 3 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” :

- 5.1.1. vazhdojnë të kryejnë veprimtaritë financiare të caktuara në licencë kur kapitali bazë (sipas përcaktimit të bërë në rregulloren " Për kapitalin rregullator") është jo më i vogël se "kapitali fillestar minimal" i përcaktuar në publikimin e Bankës të Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal;
 - 5.1.2. autorizohen nga Banka e Shqipërisë të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 26, pika 4 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" kur kapitali bazë është jo më i vogël se dyfishi i "kapitalit fillestar minimal" i caktuar në publikimin e Bankës të Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal;
 - 5.1.3. autorizohen nga Banka e Shqipërisë të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 26, pika 5 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 kur kapitali bazë është jo më i vogël se trefishi i "kapitalit fillestar minimal" i caktuar në publikimin e Bankës të Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal.
 - 5.2. Bankat e licencuara për të kryer veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 26, pika 4 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë":
 - 5.2.1. vazhdojnë të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në licencë, kur kapitali bazë është jo më i vogël se dyfishi i "kapitalit fillestar minimal" i caktuar në publikimin e Bankës të Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal;
 - 5.2.2. autorizohen nga Banka e Shqipërisë të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 26, pika 5 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 kur kapitali bazë është jo më i vogël se trefishi i "kapitalit fillestar minimal" i caktuar në publikimin e Bankës të Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal.
 - 5.3. Bankat e licencuara për të kryer veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 26, pika 5 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", vazhdojnë të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 26, pika 5 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 kur kapitali bazë është jo më i vogël se trefishi i "kapitalit fillestar minimal" i caktuar në publikimin nga Banka e Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal.
 - 5.4. Për kryerjen e veprimtarive financiare të përcaktuara në nenin 26, pikat 4, 5 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" subjektet e kësaj rregulloreje duhet njëkohësisht të paraqesin në Bankën e Shqipërisë:
 - i) dokumentacionin që vërteton aftësitë profesionale të punonjësve të bankës që kryejnë këto veprimtari financiare;
 - ii) të dhënat që tregojnë kërkesat teknike të nevojshme për drejtimin e këtyre veprimtarive financiare;
 - iii) vlerësimin e efekteve të këtyre veprimtarive financiare në rezultatin e bankës nëpërmjet pasqyrave financiare për tre vitet e ardhshme.
 6. Shpenzimet paraoperuese, shpenzimet për blerje, të cilat në kontabilitet regjistrohen si aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, në asnjë rast nuk përfshihen në "kapitalin fillestar minimal" të paguar .
 7. Shuma totale e investimeve të bankës ose të degëve të bankave të huaja në ndërtesa dhe në mjete të tjera të qëndrueshme të trupëzuara nuk duhet të kalojë 25 për qind të kapitalit rregullator. Shuma që kalon këtë përqindje zbritet nga kapitali rregullator.
 8. Bankat ose degët e bankave të huaja krijojnë rezervat e tyre të përgjithshme në masën 1.25 për qind deri në 2 për qind të totalit të aktiveve të bilancit dhe të zërave jashtë bilancit me rrezik. Ato krijohen duke zbritur një të pestën e fitimit të saj pas pagimit të taksave dhe para pagimit të dividendëve.
- Kur fondi rezervë bie nën minimumin e kërkuar si më sipër, bankat ose degët e bankave të huaja janë të detyruara ta plotësojnë atë brenda 2 vjetësh.
9. Subjektet të cilat nuk plotësojnë kërkesat e kësaj rregulloreje me hyrjen në fuqi të saj, të hartojnë programe të pranueshme për sistemimin e tyre, ku afati maksimal për përmirësimin

e tyre të jetë 30.09.1999. Këto programe dërgohen në Bankën e Shqipërisë brenda një muaji pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

10. Për shkeljet e kësaj rregulloreje zbatohen dispozitat e nenit 44 dhe të nenit 45 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.98 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" .
11. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËS KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Fatos IBRAHIMI

RREGULLORE

PËR VEPRIMTARINË VALUTORE

Miratuar me vendimin nr.64, datë 30.07.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr.101, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore dhe qëllimi

- 1.1 Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 1.2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e rregullave lidhur me veprimet në llogarinë kapitale dhe në llogarinë korente, midis rezidentëve dhe jorezidentëve, nga brenda-jashtë dhe nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 Përcaktime

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a- Rezident:

- individin, në rast se është shtetas shqiptar dhe ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kuptimit të nenit 12 të Kodit Civil;
- diplomatit dhe punonjësit shqiptar të caktuar me punë nga Shteti Shqiptar, si dhe familjarët e tij, në ambasada, në konsullata apo në organizma ndërkombëtarë jashtë shtetit, jo të përfshira në aktivitet ekonomik apo tregtar;
- individin, që, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë për më tepër se 183 ditë brenda një viti kalendarik;
- personin fizik dhe juridik që ka selinë e vet të përhershme në Republikën e Shqipërisë;
- shtetasin e huaj, i cili disponon leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, lëshuar sipas ligjit nr. 8492, datë 27.05.1999 "Për të huajt";
- individin, që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor ose për arsye të tjera të ngjashme, pavarësisht nga kohëzgjatja, dhe që është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

b- Seli e përhershme:

Selinë e përcaktuar në aktin e themelimit ose të krijimit të personit juridik, në përputhje me ligjin përkatës. Konsiderohet seli e përhershme edhe selia e degës, e filialit apo e zyrës së përfaqësimit të personit juridik.

c- Jorezident:

Të gjithë personat (individë, person fizik apo juridik) që nuk përfshihen në përcaktimin e termit rezident të shprehur në këtë rregullore.

d- Mjet pagesë në valutë :

Çdo instrument monetar në formën e kartëmonedhës ose të monedhës metalike, të çekut, të kambialit, të premtimpagesës, të letërkreditit dhe të urdhrave ose të instrumenteve të tjera të pagesës në valutë dhe që paguhen në valutë.

e- Valutë:

Mjetet financiare në formën e kartëmonedhave, të monedhave metalike të huaja, të cilat kanë kurs ligjor dhe mjetet financiare në formën e llogarive dhe të depozitave në monedhë të huaj, në institucionet financiare të vendit dhe të huaja, të cilat mund të transferohen me anë të mjeteve të pagesës, për pagesat në valutë.

f- Monedhë e konvertueshme:

Monedhën lirisht të tregtueshme me një monedhë tjetër në tregun ndërkombëtar.

g- Kurs këmbimi:

Çmimin relativ të një monedhe të shprehur në njësi të një monedhe tjetër, referuar një date të caktuar. h- Veprim këmbimi valutor:

Këmbimin, blerjen ose shitjen e valutave në cash dhe nëpërmjet llogarisë personale ose të të tretëve. Shlyerja e kredisë financiare në monedhë të ndryshme nga ajo me të cilën është akorduar ose pranuar, vetëm nëse kjo nuk ka rezultuar nga marrëveshja me shkrim e palëve.

i- Tregu i këmbimeve valutore:

Tregun ku kryhen veprimet e këmbimit valutor.

j- Ar dhe metale të çmuara:

- Arin dhe metalet e çmuara të standardizuara.
- Arin dhe metalet e çmuara të pastandardizuara.

k- Standardizim i arit dhe i metaleve të çmuara:

Formën unike të arit ose të metaleve të çmuara, të pranuar për t'u këmbyer në tregun ndërkombëtar të arit.

l-Metale të çmuara:

Platini.

ll- Licencë për të kryer veprimtari të këmbimit valutor:

Aktin administrativ të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që jep të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së këmbimeve valutore.

m- Kontratë:

Veprimin juridik me anë të të cilit një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike. Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi.

n- Detyrim monetar:

Detyrimin për të paguar një shumë parash, që shlyhet me vleftën e vet nominale, përveç kur rezulton ndryshe nga ligji ose nga kontrata.

o- Subjektet e licencuara:

Të gjitha subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarive të përcaktuara në këtë rregullore.

p- Operatorët e tregut të këmbimeve valutore:

Bankën e Shqipërisë dhe subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë.

KREU II VEPRIMET VALUTORE

Neni 3

Llojet e veprimeve valutore

- 3.1. Veprimet valutore kryhen nëpërmjet transaksioneve që përfshihen në:
 - a. llogarinë kapitale; dhe në
 - b. llogarinë korente.
- 3.2. Rezidentët dhe jorezidentët mund të këmbëjnë valutën në monedhën kombëtare dhe anasjelltas, si dhe një lloj valute në një lloj tjetër valute nëpërmjet operatorëve të tregut të këmbimeve valutore.

Neni 4

Veprimet në llogarinë kapitale

- 4.1. Veprime në llogarinë kapitale janë të gjitha transaksionet që kryhen ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve dhe regjistrohen në llogarinë e kapitalit të bilancit të pagesave. Këto janë:

- a) investime direkte,
- b) transaksione në letra me vlerë,
- c) transaksione të kreditit,
- d) transaksione të depozitave,
- e) transaksione të sigurimit dhe të risigurimit, kur lejohet nga legjislacioni shqiptar.

4.1.1. Investime direkte.

Në investimet direkte përfshihen:

- a) krijimi ose zgjerimi i një shoqërie, që zotërohet plotësisht nga investuesi, krijimi i një filiali ose dege, ose blerja e një shoqërie ekzistuese, që kalon në pronësi të plotë të investuesit;
- b) pjesëmarrja në një shoqëri të re ose ekzistuese, nëse investuesi zotëron ose ka në pronësi mbi 10 për qind pjesëmarrje në kapitalin bazë të shoqërisë ose mbi 10 për qind të të drejtave të votës;
- c) kredia financiare me maturim 5 vjet ose më shumë, me qëllim vendosjen e lidhjeve ekonomike afatgjata, sipas gërmeve a dhe b të këtij paragrafi; d) përdorimi i fitimit nga një investim ekzistues në të njëjtin investim (riinvestimi i fitimit);
- e) investimi në aktive të qëndrueshme të trupëzuara për qëllime tregtare ose banimi.

4.1.2. Transaksione në letra me vlerë.

Për të plotësuar kërkesat e kësaj rregulloreje :

- 4.1.2.1. Letrat me vlerë janë të gjitha instrumentet financiare të pronësisë dhe instrumentet financiare të normave të interesit.

- 4.1.2.2. Transaksionet në letrat me vlerë janë të gjitha transaksionet e emetimit, e investimit, e listimit të letrave me vlerë, që tregojnë fillimin e tregimit të letrave me vlerë të subjekteve të huaja në Republikën e Shqipërisë ose të letrave me vlerë të subjekteve vendase jashtë vendit. Të tilla të konsiderohen :

- a) emetimi dhe listimi i letrave me vlerë të subjekteve vendase jashtë Republikës së Shqipërisë;
- b) investimi nga rezidentët në letra me vlerë jashtë Republikës së Shqipërisë;
- c) emetimi dhe listimi i letrave me vlerë të subjekteve të huaja në Republikën e Shqipërisë;
- d) investimi, nga jorezidentët, në letra me vlerë të subjekteve vendase në Republikën e Shqipërisë.

4.1.3. Transaksione të kreditit.

- 4.1.3. Transaksionet e kreditit konsistojnë në përfundimin e një kontrate kredie ose të një kontrate huaje, me objekt parane.

Kontratat e kredisë ose të huasë mund të jenë në formën e:

- a- kredive tregtare që përfaqësojnë kreditë që lidhen me tregtinë ndërkombëtare dhe me ofrimin e shërbimeve ndërkombëtare, ku njëra nga palët është rezidente;
- b- huave familjare që përfaqësojnë huatë ndërmjet personave, që kanë lidhje trashëgimie ligjore,

- c- ku njëra nga palët është jorezidente;
kredive financiare, që përfaqësojnë kreditë përveç atyre të përcaktuara tek paragrafi 4.1.1.c. Kreditë financiare përfshijnë edhe kreditë për blerjen e pasurive të patundshme dhe qiranë financiare.

4.1.4. Transaksione të depozitave.

Transaksionet e depozitave janë transaksionet e kryera në bazën e një kontrate, që përfshin hapjen e një llogarie rrjedhëse ose të një llogarie depozite nga një bankë rezidente në një bankë jorezidente, ose anasjelltas.

4.1.5. Transaksione të sigurimit.

Transaksionet e sigurimit janë transaksionet e kryera mbi bazën e një kontrate sigurimi ndërmjet një jorezidenti dhe një rezidenti dhe anasjelltas, që rezulton në:

- a- transferimin e kapitalit nga një jorezident (siguruesi) tek një rezident (përfituesi); dhe/ose
 - b- transferimin e kapitalit nga një rezident (siguruesi) tek një jorezident (përfituesi), sipas përcaktimit të bërë nga legjislacioni shqiptar.
- 4.2. Në kuptim të këtij neni, veprime në llogarinë kapitale janë, gjithashtu, transaksionet e tjetërsimit të një investimi mbi baza ligjore.

Neni 5

Veprimet në llogarinë korente

- 5.1. Veprime në llogari korente janë të gjitha transaksionet që kryhen ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve dhe regjistrohen në llogarinë korente të bilancit të pagesave.
- 5.2. Pagesat dhe transferimet për transaksionet në llogarinë korente përfshijnë :
- a) të gjitha pagesat, që rrjedhin nga tregtia ndërkombëtare, veçanërisht :
 - pagesat për blerje me qëllim rishitjeje dhe përgjithësisht çdo pagesë për veprim shkëmbimi të lidhur me një veprim tjetër shkëmbimi,
 - çdo pagesë për kryerjen e shërbimeve në fushën industriale, të ndërtimit, të shfrytëzimit të minierave, të transportit, të sigurimit, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të konsulencës, të botimit dhe të shtypshkrimit joartizanal,
 - pagesat për çdo operacion bankar dhe këmbimi,
 - pagesat për të gjitha operacionet e ndërmjetësimit;
 - b) pagesat e kryegjësë dhe të interesave të kredisë, që u ka ardhur afati i shlyerjes;
 - c) transferimet e njëanshme të kapitalit, të cilat përfshijnë:
 - c.1 Transfertat personale të aktiveve, të cilat janë transfertat e aktiveve nga/në Republikën e Shqipërisë nga titulli i një kredie familjare, dhurate, prike, trashëgimie, shlyerja e një borxhi nga një emigrant në vendin e tij të lindjes, transferimi i aktiveve të një emigranti në një vend të huaj për zbatimin e një vendimi gjykate, të ardhurat nga lojrat e fatit dhe kursimet e personave të punësuar në Republikën e Shqipërisë, të cilët nuk janë rezidentë.
 - c.2. Transfertat fizike të aktiveve, të cilat janë transportimi në cash i monedhës vendase ose të huaj, dhe i letrave me vlerë nga dhe në Republikën e Shqipërisë (sipas udhëzimit nr. 1 të kësaj rregulloreje). Subjektet e licencuara kryejnë transferime të njëanshme të kapitalit për llogari të rezidentëve dhe të jorezidentëve, pas plotësimit të dokumentacionit, që vërteton qëllimin e veprimit, të përcaktuar nga vetë subjekti;
 - d) transfertat e përcaktuara në udhëzimin 2, pjesë e kësaj rregulloreje.

KREU III TRANSFERIMI I KAPITALIT

Neni 6 Kriteret për transferimin e kapitalit

- 6.1. Transferimi i kapitalit nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët kryhet pa kufizim.
- 6.2. Transferimi i kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të vetë subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, bëhet me vendim të organeve përkatëse të tyre.
- 6.3. Subjektet e licencuara kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda-jashtë Republikës së Shqipërisë, për llogari të klientëve të tyre pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si më poshtë, si dhe dokumenteve të tjera shtesë që subjektet mund ta shikojnë të arsyeshme:
 - 6.3.1. për personat fizikë dhe juridikë:
 - a) kërkesa ku shpjegohen arsyet për të cilat kërkohet transferimi i kapitalit, burimi i krijimit të këtij kapitali, shuma e kapitalit, që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet,
 - b) dokumenti i subjektit të huaj, që shpjegon këtë transferim (në rast se ka të tilla),
 - c) vendimi i organit vendimmarrës të subjektit për kryerjen e transferimit të kapitalit,
 - d) vendimi i regjistrimit në gjykatë;
 - e) vërtetim nga zyra e tatim-taksave se ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj shtetit;
 - 6.3.2. për individët:
 - a) kërkesa ku shpjegohen arsyet, për të cilat kërkohet transferimi i kapitalit, shuma e kapitalit që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet,
 - b) deklaratë mbi burimin e krijimit të kapitalit që kërkohet të transferohet.
- 6.4. Për raste të veçanta të parashikuara në këtë paragraf, transferimi i kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga subjektet e licencuara kryhet pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar për secilin rast:
 - a) kur kapitali i hyrë në Shqipëri, i transferuar nëpërmjet një banke të huaj, për qëllime investimi, nuk është përdorur, transferimi kryhet me paraqitjen në bankë të vendimit të organit vendimmarrës të subjektit për ndërprerjen e investimit dhe me kusht që banka të vërtetojë mospërdorimin e shumës së kapitalit të derdhur për këtë qëllim;
 - b) transferimi i kapitalit brenda shumës së kapitalit të regjistruar në Shqipëri dhe të ardhurave të siguruara nga investimi i kësaj shume, të vërtetuara me dokumentacionin përkatës (ligji nr. 7764, datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja"). Si dokumentacion shoqërues shtesë në këtë rast, shërben vërtetimi i lëshuar nga organet tatimore, i cili tregon shumën e kapitalit të investuar, fitimin e realizuar (pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet tatimore) si dhe një vendim i organit vendimmarrës të subjektit, ku theksohet ndarja dhe përdorimi i fitimit;
 - c) transaksionet e depozitave ndërbankare, që kryhen në bazë të një kontrate, që përfshin veprimet në një llogari rrjedhëse ose në një llogari depozite ndërmjet një banke rezidente të licencuar dhe një banke jorezidente, ose anasjelltas, ndërmjet një banke rezidente dhe një institucioni financiar jorezident;
 - d) kreditë tregtare me afat maturimi deri në një vit, që lidhen direkt me tregtinë ndërkombëtare dhe me ofrimin e shërbimeve në këmbimet ndërkombëtare. Si dokumentacion shoqërues është vetë kontrata e kredisë;
 - e) transferimi i valutës, që buron nga depozitat e një jorezidenti, si dhe të ardhurat që rrjedhin prej tyre. Në raste të tilla, si dokumentacion shoqërues shërben dokumenti i bankës, që vërteton shumën që transferohet;
 - f) transferimi i valutës prej një emigranti shqiptar në momentin e largimit nga Republika

- e Shqipërisë. Në këtë rast, i interesuari paraqet në bankë një nga dokumentet e mëposhtme:
- dokumentin e nënshtetësisë së huaj apo lejen e qëndrimit të tij, të lëshuar nga organet përkatëse të shtetit të huaj ku ai qëndron,
 - një dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit të huaj, që vërteton rezidencën e tij në atë shtet,
 - dokumentin ose vizën, lëshuar nga autoritetet përfaqësuese të shtetit të huaj, i cili vërteton qëndrimin e përhershëm të tij në atë shtet;
- g) transferimi i të ardhurave të siguruara nga pasuria apo nga investimet e një emigranti shqiptar që jeton jashtë Shqipërisë. I interesuari paraqet në bankë një nga dokumentet e parashikuara në pikën f, si dhe një deklaratë personale për (ose kur është e mundur dokumentin që vërteton) burimin e të ardhurave që kërkohet të transferohen;
- h) transferim kapitali brenda shumës së kapitalit dhe të ardhurave që rezultojnë nga shitjet, nga likuidimi i pjesëshëm ose nga likuidimi i plotë i një investimi. Si dokumentacion shoqërues shtesë, në këtë rast, do të shërbejë akti i shitjes ose akti i likuidimit nga gjykata dhe vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve tatimore.

Neni 7

Transaksionet e pagesave me jashtë

- 7.1. Transaksionet e pagesave me jashtë kryhen prej subjekteve të licencuara.
- 7.2. Çdo individ, ka të drejtë të transferojë lirisht nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ekuivalenten në çdo monedhë tjetër të shumës deri në 3.5 milionë lekë, sipas kursit të ditës, dhe brenda afatit kohor të një viti kalendarik. Transferimi, deri në këtë kufi, mund të kryhet njëherazi ose pjesërisht. Për të kryer transferimin, klienti duhet të plotësojë:
- a) kërkesën për transferimin e shumës, duke specifikuar qëllimin e veprimit; dhe
 - b) deklaratën personale që ka respektuar kufirin e përcaktuar në paragrafin 7.2 të kësaj rregulloreje.
- 7.3. Për transfertat tregtare dhe jotregtare në valutë, dokumentacioni që duhet të plotësohet është përcaktuar në udhëzimet 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje.
- 7.4. Për transaksionet e pagesave me jashtë në Republikën e Shqipërisë, zbatohen rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të njohura, marrëveshjet ndërbankare dypalëshe e shumëpalëshe si dhe zakoni bankar.

KREU IV

INVESTIMET DHE LLOGARITË E JOREZIDENTËVE

Neni 8

Investimet në letrat me vlerë

Jorezidentët mund të blejnë ose të shesin letra me vlerë në Republikën e Shqipërisë dhe të ushtrojnë të drejtat, që rrjedhin prej kësaj vetëm nëpërmjet një banke ose institucioni financiar të autorizuar, ruajtës, sipas një kontrate të përfunduar në lidhje me shërbime ruajtjeje, që lidhet me letrat me vlerë.

Neni 9

Llogaritë e jorezidentëve

Jorezidentët mund të hapin pa kufizim llogari në monedhë të huaj ose në monedhën vendase, në një bankë ose degë të bankës së huaj, të licencuar nga Banka e Shqipërisë.

**KREU V
DETYRIMI PËR RAPORTIM**

Neni 10

Operatorët e tregut të këmbimeve valutore, në zbatim të nenit 65, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë sipas udhëzimit "Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore" miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

**KREU VI
LËVIZJET FIZIKE TË VALUTËS, TË ARIT DHE TË METALEVE TË ÇMUARA**

Neni 11

Lëvizjet fizike të valutës në pikat doganore

- 11.1. Rezidentët lejohet të nxjerrin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë shumën e valutës në cash dhe në çeqe udhëtarësh deri në kundërvlerën e 3.5 milionë lekëve. Për shumat mbi 1 milionë lekë çdo rezident është i detyruar të deklarojë lidhur me origjinën e parave që kërkon të transferojë.
- 11.2. Jorezidentët dhe qytetarët e huaj (rezidentët) që vizitojnë përkohësisht Republikën e Shqipërisë, mund të nxjerrin jashtë saj valutë në cash dhe në çeqe udhëtarësh deri në shumën e deklaruar kur kanë hyrë, e cila justifikohet me paraqitjen e deklaratës të plotësuar në hyrje dhe me dokumentet përkatëse në qoftë se ka shtesa.
- 11.3. Tregtarët, si persona fizikë ose juridikë shqiptarë, lejohet të nxjerrin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo kalim, në pikat doganore, shumat në cash ose në çeqe udhëtarësh, deri në kundërvlerën e 3.5 milionë lekëve në çdo monedhë të huaj. Krahas deklaramit të shumës, tregtari duhet t'i paraqesë autoriteteve doganore çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

Neni 12

Lëvizjet fizike të arit dhe të metaleve të çmuara në pikat doganore

- 12.1. Rezidentët dhe jorezidentët kanë të drejtë të transferojnë nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, arin dhe metalet e çmuara të standardizuara vetëm nëpërmjet subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimit të bërë në aneksin e licencës së akorduar nga Banka e Shqipërisë. Dokumentacioni që duhet të plotësohet përcaktohet nga vetë subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë, i cili kryen shërbimin.
- 12.2. Rezidentët dhe jorezidentët kanë të drejtë të transferojnë nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, arin dhe metalet e çmuara të pastandardizuara nga pikat doganore, vetëm pas plotësimit të deklaratës lidhur me:

Burimin(origjinën) e tij, qëllimin e transferimit, sasinë që kërkohet të transferohet, kthimin ose jo të metaleve të çmuara dhe për formën e kthimit.

Ky dokumentacion nuk paraqitet për bizhuteritë e përdorimit personal.

- 12.3. Bankat dhe degët e bankave të huaja, kanë të drejtë të kryejnë transaksione me arin dhe me metalet e çmuara vetëm pas licencimit të tyre nga Banka e Shqipërisë për këtë aktivitet. Transaksionet e hyrjes dhe të daljes së arit dhe të metaleve të çmuara trajtohen dhe realizohen njëjloj si dhe për valutat.

**KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 13

Paraqitja e dokumentacionit dhe detyrimet e subjekteve

- 13.1. Dokumentacioni, i kërkuar në këtë rregullore dhe në udhëzimet pjesë përbërëse të saj, paraqitet tek subjekti i licencuar në origjinal dhe vërtetimi i tij bëhet nga vetë subjekti i licencuar, i cili do

të bëjë fotokopjen nga origjinali, duke vënë një vulë të posaçme (datore) mbi secilën nga fletët e fotokopjuara, që i jep vlefshmërinë e duhur dokumentit. Përveç sa më sipër, për aktin e zhdoganimit vulozet edhe origjinali.

- 13.2 Rezidentët dhe jorezidentët, që kryejnë një operacion valutore në tregun e këmbimeve valutore, përgjigjen për vërtetësinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur.
- 13.3. Subjektet e licencuara janë të detyruara të plotësojnë dhe të ruajnë të gjithë dokumentacionin e parashikuar në këtë rregullore dhe në udhëzimet pjesë përbërëse të saj.
- 13.4 Banka e Shqipërisë vendos masa ndëshkimore e penalitete, sipas kreut VI të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kur subjektet e licencuara nuk veprojnë në përputhje me këtë rregullore dhe me udhëzimet pjesë përbërëse të saj.

Neni 14

- 14.1 Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë :
- Udhëzimi nr. 1 "Mbi transfertat për veprimet tregtare në valutë".
 - Udhëzimi nr. 2 "Mbi transfertat e veprimeve jotregtare në valutë".
- 14.2 Kjo rregullore u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 64, datë 30.07.2003 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
- 14.4 Rregullorja "Mbi veprimtarinë valutore" dhe udhëzimet e saj, të miratuara me vendimin nr.12, datë 21.02.2001, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohen.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

UDHËZIMI 1
MBI
TRANSFERTAT PËR VEPRIMET TREGTARE NË VALUTË

1. Transfertat për veprimet tregtare për mallrat.

Transfertat për veprimet tregtare për mallrat, nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga i njëjti subjekt gjatë një dite pune, nga personat fizikë, juridikë, të kryhen kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

1.1. Kur pagesa kryhet paradhënie ose para mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë:

- a) kërkesa për kryerjen e veprimit, ku jepet përshkrimi i natyrës dhe i qëllimit për të cilin kryhet, nënshkruar nga vetë kërkuesi. Po në këtë kërkesë, subjekti të deklarojë se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera;
- b) fatura pro-forma dhe/ose² kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës,
- c) akti i zhdoganimit të mallit :
- c.1.³ në rastet e pagesës së pjesshme të shumës totale, në përputhje me kushtet e kontratës, afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Me kalimin e këtij afati nuk do të kryhet pagesa e rradhës për këtë mall deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit të mallit të paguar. Përrjashtim bëjnë rastet kur afati i lëvrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por jo më shumë se 12 muaj;
- c.2. në rastet e transfertave të pjesshme, kur operohet me magazinë doganore, sipas Kodit Doganor, pagesa e rradhës do të kryhet vetëm pas paraqitjes të aktit të zhdoganimit të mallit, për atë pjesë të zhdoganuar të tij, që ka qenë nën regjimin e magazinimit doganor.

Afati maksimal i paraqitjes së këtij dokumenti është 12 muaj nga data e importimit. Pranohet një shtyrje, për 12 muaj të tjerë, në rast se një gjë e tillë është pranuar nga organet që e kanë në kompetencë sipas Kodit Doganor. Pas këtij afati, pagesa e rradhës nuk do të kryhet deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit; c.3. në rastin e likuidimit të menjëhershëm të shumës së kontratës afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Përrjashtim bëjnë rastet kur afati i lëvrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por jo më shumë se 12 muaj.

1.2. Kur pagesa kryhet pas mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë:

- a) kërkesa si në pikën 1.1., gërma a;
- b) akti i zhdoganimit të mallit.

1.3. Për transfertat në tregun e mallrave, që kalojnë tranzit në Republikën e Shqipërisë, zbatohen kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë".

1.4. Në rastin kur blerja dhe shitja e mallit realizohet nëpërmjet dy shteteve të ndryshme nga Shqipëria dhe malli nuk hyn në Shqipëri, por vetëm pagesa e mallit realizohet nëpërmjet Shqipërisë, transferata kryhet duke u bazuar në dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1.1 të këtij udhëzimi. Kërkesa e pikës 1.1 gërma c, plotësohet me aktin e zhdoganimit të mallit, të njërit prej këtyre shteteve.

1.5.⁴ Kur pagesa kryhet paradhënie ose para mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë për shumat deri në 3.5 milionë lekë ose ekuivalenten e saj në monedhë të huaj të llogaritur me kursin e ditës së kryerjes së pagesës :

² Ndryshuar me vendimin nr.101, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³ Ndryshuar me vendimin nr.101, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴ Ndryshuar me vendimin nr.101, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- a. Kërkesa për kryerjen e veprimit, ku jepet përshkrimi i natyrës dhe i qëllimit për të cilin kryhet, nënshkruar nga vetë kërkuesi. Po në këtë kërkesë, subjekti të deklarojë se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera.
 - b. Akti i zhdoganimit të mallit sipas rasteve të parashikuara në pikën 1.1., gërma c.
2. Transfertat për veprimet tregtare për shërbimet.
- 2.1. Për veprimet e transfertave tregtare, në çdo rast shërbimi, sipas specifikimeve të bëra në nenin 5.2 të rregullores "Për veprimtarinë valutore", subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm, sipas specifikave të secilit klient :
- a) kërkesa sipas pikës 1.1., gërma a;
 - b) fatura përkatëse e subjektit - ose një dokument, i cili vërteton qëllimin për të cilin kërkohet kryerja e transfertës; ⁵dhe/ose kontrata dhe/ose marrëveshja përkatëse.

UDHËZIMI 2 MBI TRANSFERTAT E VEPRIMEVE JOTREGTARE NË VALUTË

1. Në transfertat e veprimeve jotregtare përfshihen :
- a. studime dhe kontrolle të kryera nga shoqëri të huaja;
 - b. kurse, konferenca dhe konkurse jashtë vendit;
 - c. studime, specializime dhe trajnime jashtë vendit;
 - d. shërbime shëndetësore dhe mjeksore jashtë vendit;
 - e. ekspertiza teknike, komisione për planifikimin dhe kontrollin, që kanë lidhje me ndërtimet, me zbatimin e projekteve dhe me planifikime të tjera;
 - f. përpunimi elektronik i të dhënave;
 - g. planifikimi teknik dhe administrativ;
 - h. qira të filmave dhe të programeve televizive dhe pagesat për të drejtën e autorit;
 - i. shpenzime korente të degëve dhe të zyrave të përfaqësimit të shoqërive dhe të bankave, si qiratë, shpenzimet operative etj., misionet diplomatike shqiptare dhe të huaja, misionet tregtare, forcat paqeruajtëse, programet e këmbimit kulturor dhe të nxitjes së turizmit;
 - j. patentat dhe të drejtat e autorit, pagat dhe rrogat e zakonshme, shpenzimet e natyrës joperiodike të jorezidentëve;
 - k. qira financiare të pajisjeve operative dhe të makinerive;
 - l. qira financiare afatshkurtra (deri 1 vit);
 - m. shlyerja e huave;
 - n. pensione;
 - o. pagesa për anëtarësi;
 - p. asistencë e dërguar organizatave fetare;
 - q. transaksione me organizatat ndërkombëtare;
 - r. qira të ndryshme në favor të emigrantëve dhe të jorezidentëve;
 - s. shpenzime jetese familjare, në përputhje me nenin 5, pikat b dhe c.2. Në transfertat e veprimeve jotregtare përfshihen edhe të gjitha transfertat e tjera, të ngjashme me ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.
3. Me qëllim kryerjen e transfertave të përcaktuara në këtë udhëzim, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:
- a) kërkesën sipas pikës 1.1. gërma a, të udhëzimit nr. 1;
 - b) vërtetimin (në rast se është e mundur), nga një organ kompetent, që justifikon qëllimin e veprimit sipas këtij udhëzimi;
 - c) vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore për personat fizikë dhe juridikë.

⁵ Ndryshuar me vendimin nr.101, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

UDHËZIM

PËR LIKUIDITETIN E BANKAVE

Miratuar me vendimin nr.04, datë 19.01.2000, ndryshuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 1

1. Ky udhëzim del në zbatim të nenit 3, pika 3 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të nenit 27, pika 2 dhe nenit 31 pika 1, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 2- Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Në vazhdim të këtij udhëzimi këto subjekte do të quhen "bankë".
3. Për qëllime të këtij udhëzimi:
 - me shkallë detyrimi do të kuptojmë mundësinë ose pamundësinë për t'u tërhequr nga një kontratë;
 - me grup të lidhur depozituesish do të kuptojmë dy ose më shumë depozitues (individë, persona fizikë ose juridikë) ndaj të cilëve banka ka një detyrim që lind nga marrja e depozitave, depozituesit e të cilave janë bashkërisht të lidhur në mënyrat e mëposhtme:
 - a) një depozitues ushtron kontroll mbi depozituesit e tjerë, direkt ose nëpërmjet personave të tjerë, ose
 - b) marrëdhëniet e tyre janë të asaj natyre që vështirësitë financiare të një depozituesi mund të krijojnë vështirësi pagese për depozituesit e tjerë,
 - c) ata veprojnë në bashkëpunim.
4. Bankat duhet që në çdo kohë të jenë në gjendje të paguajnë detyrimet e tyre. Administrimi i likuiditetit të bankave mbështetet në planifikimin e hyrjes dhe të daljes së mjeteve financiare për të ardhmen.
5. Bankat mbajnë likuiditetin në një shumë, strukturë dhe raporte, që i lejojnë ato të përmbushin detyrimet e tyre dhe angazhimet e marra mbi një bazë kohore, me një kosto të arsyeshme dhe me një rrezik minimum si edhe për:
 - a) sigurimin e interesave të depozituesve, të kreditorëve të tjerë dhe të aksionerëve të tyre;
 - b) kryerjen pa pengesa të transaksioneve të zakonshme bankare;
 - c) shmangien e çdo nxitimi të panevojshëm të shitjes së aktiveve që sjellin të ardhura (si letra me vlerë etj.).
6. Planifikimi i likuiditetit mbështetet në dy kushte themelore:
 - a) në një sistem të përshtatshëm informacioni;
 - b) në regjistrimin e shpejtë të të gjitha transaksioneve në kontabilitet.

Neni 2

1. Brenda sistemit të saj të informacionit, banka klasifikon aktivet, pasivet dhe zërat jashtë bilancit në përputhje me:

- a) datën e maturimit të aktiveve, të pasiveve dhe të zërave jashtë bilancit me afate fikse;
- b) zhvillimin e parashikuar të pasiveve me afate fikse në lidhje me vëllimin e mundshëm të depozitave të rivendosura nga kreditorët në datën e maturimit;
- c) eksperiencën e sjelljes së depozituesit në lidhje me depozitat pa afat dhe depozitat me afat sipas kushteve specifike;
- d) shkallën e likuiditetit të aktiveve lidhur me:
 - i. disponueshmërinë e menjëhershme të tyre për të mbuluar daljen e fondeve,
 - ii. mundësinë e kthimit të tyre në cash nga Banka e Shqipërisë,
 - iii. tregtueshmërinë e tyre në tregun financiar, madhësia e të cilit do të lejohet shitjen e sasisë së kërkuar të aktiveve me një çmim, i cili korrespondon me vlerën tyre të tregut, ose me një çmim më të lartë ose të barabartë me vlerën e tyre kontabile,
 - iv. rënien e mundshme të vlerës së aktiveve në të njëjtën masë me rënien e pasiveve përkatëse;
- e) shumën e depozitës të një depozituesi ose të një grupi depozituesish të lidhur (si në pikën 2 më poshtë);
- f) tipin dhe shkallën e detyrimeve të zërave jashtë bilancit të dhëna dhe të marra nga banka;
- g) monedhat në të cilat aktivet, pasivet dhe zërat jashtë bilancit shprehen: Lekë, monedha të konvertueshme dhe monedha të pakonvertueshme.

Neni 3

Për të siguruar likuiditetin e nevojshëm banka duhet të përqëndrojë veprimtaritë e saj veçanërisht në:

- a) financimin fillimisht nga burime të qëndrueshme brenda kushteve të rëna dakord;
- b) shpërndarjen e burimeve të financimit sipas maturitetit, instrumentit dhe klientelës së bankës;
- c) zbatimin e masave organizuese që synojnë administrimin efektiv të likuiditetit (caktimin e një punonjësi të veçantë të cilit do t'i besohet administrimi i likuiditetit, zbatimin e një kontrolli efektiv dhe kontrolli të brendshëm të administrimit të pozicionit të likuiditetit të bankës, ndërthurjen e çështjeve specifike shoqëruar me ekzistencën e degëve të bankës jashtë vendit, filialet etj.);
- d) shkallën e integritetit të bankës në tregun monetar, bonot afatshkurtra të emetuara dhe të tregtuara në treg;
- e) hartimin e politikës tregtare së bashku me planifikimin financiar për të shmangur mungesën e burimeve për planet e saj të zhvillimit dhe për të zvogëluar ndonjë pamjaftueshmëri strukturore të aktiveve dhe të pasiveve të saj, që rezulton nga diferencat ndërmjet datave të maturimit të rëna dakord dhe atyre aktuale;
- f) mbajtjen e një vëllimi të mjaftueshëm të aktiveve me likuiditet të lartë në lidhje me efektin e tregtimit; për qëllime të kësaj rregulloreje aktive me likuiditet të lartë janë vlerat e *cash*-it, llogaritë rrjedhëse me bankat e tjera, depozitat afatshkurtra me bankat e tjera me një maturitet deri në 7 ditë, bonot e thesarit, bonot afatshkurtra të bankave qendrore dhe vlera të tjera të ngjashme, dhe rezervat e lira me Bankën e Shqipërisë;
- g) hartimin e një plani për ngjarje jo të zakonshme, të cilat kërcënojnë likuiditetin e bankës, i cili është i përbërë nga mënyra e hartimit dhe kushtet e përdorimit, përfshirë caktimin e një punonjësi përgjegjës, identifikimin dhe vlerën (vëllimin) e aktiveve, që janë të gatshme sipas planit, për të nxitur dhe për të siguruar likuiditetin e bankës; banka duhet ta përditësojë planin lidhur me ndryshimin e kushteve të brendshme (strukturën e aktivitetit dhe pasivitetit të bankës) dhe të jashtme (situata mbi tregun ndërbankar).

Neni 4

1. Banka njofton Bankën e Shqipërisë për:

- a) emrin e punonjësit përgjegjës për:
- i. propozime për rekomandime dhe zbatimin e politikës së likuiditetit të bankës;
 - ii. monitorimin e përditshëm të likuiditetit dhe përgatitjen e propozimeve për drejtuesit e bankës;
 - iii. rishikimin e administrimit të likuiditetit të përqëndruar mbi identifikimin e rezervave të larta të pajustificuara të *cash*-it dhe aktiveve të tjera me likuiditet të lartë, të cilat sjellin rritje kostoje për bankën;
- b) organin përgjegjës të bankës për miratimin e propozimeve të politikës së likuiditetit,
- c) organin përgjegjës të bankës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të politikës së miratuar të likuiditetit.
2. Nëse banka ka një ose më shumë degë jashtë vendit ose kontrollon disa banka të tjera, ajo bën përshtatjen e politikës së likuiditetit në mënyrë të konsoliduar në përputhje me situatën e krijuar.
 3. Sistemi i administrimit të likuiditetit i nënshtrohet kontrollit të rregullt nëpërmjet kontrollit të brendshëm të bankës dhe Bankës së Shqipërisë.

Neni 5¹

1. Banka përcakton shumën totale minimale të burimeve likuide ose të kategorive të veçanta të tyre në përputhje me nenin 31, pika 1 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Banka llogarit disa raporte për likuiditetin, të cilat janë : aktivet me likuiditet të lartë në raport me totalin e aktiveve, aktivet me likuiditet të lartë në raport me pasivet afatshkurtra, pozicioni neto kumulativ (GAP) për një periudhë deri në tre muaj në raport me totalin e aktiveve, si dhe raporte të tjera të vendosura nga vetë ajo. Madhësia dhe metodologjia e llogaritjes së tyre përcaktohen nga banka.

2. Aktivet likuide janë minimalisht tërësia e elementeve të mëposhtme:

mjetet monetare, llogari të tjera në bankën qendrore, bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim nga banka qendrore, marrëdhëniet me bankat e tjera, veprimet me letrat me vlerë (neto).

Pasivet afatshkurtra janë minimalisht tërësia e elementeve të mëposhtme : veprimet ndërbankare (klasa 1), depozitat pa afat (klasa 2), 10 për qind e llogarive rrjedhëse me tepricë kreditore (klasa 2).

Neni 6

1. Banka raporton çdo muaj në Bankën e Shqipërisë lidhur me likuiditetin. Në rast se banka është në gjendje jo të favorshme likuiditeti, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë raportime më të shpeshta.
2. Raportet hartohen sipas raportit tip bashkëngjitur.

Neni 7

1. Raporti nënshkruhet nga dy persona të autorizuar për të vepruar në emër të bankës dhe përgjegjës për administrimin e bankës në tërësi.
2. Banka siguron kontrollin e plotësisht dhe saktësinë e të dhënave të paraqitura në raport.
3. Kontrolli i brendshëm i bankës kërkon që, në përputhje me situatën e veçanta, të rishikojë:
 - a) nëse sistemi për hartimin e raportit është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të pasqyrojë gjendjen ekzistuese të likuiditetit të bankës;
 - b) nëse raportimet e likuiditetit më 31.12 janë të sakta dhe të vërtetë të raportit.

¹ Ndryshuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 8

1. Banka paraqet në Bankën e Shqipërisë informacionin në përputhje me nenin 4, paragrafi 1 brenda 30 ditëve nga data që ky udhëzim hyn në fuqi.
2. Banka harton rregullore të brendshme ku parashikon në përputhje me këtë udhëzim, parimet e hartimit të planit për ngjarje jo të zakonshme që kërcënojnë likuiditetin e bankës.
3. Banka paraqet rregulloren e brendshme në Bankën e Shqipërisë, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, brenda dy muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Banka paraqet në Bankën e Shqipërisë ndryshimet e rregullores së saj të brendshme, menjëherë me miratimin e tyre.

Neni 9

Rregullorja "Për raportin e likuiditetit", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.71, datë 02.06.1999, shfuqizohet.

Neni 10

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës
Shkëlqim Cani

BANKA _____

DATA E RAPORTIMIT _____

PASQYRA E MATURITETIT TË MBETUR TË MJETEVE DHE TË DETYRIMEVE

EMËRTIMI	PERIUDHA E MBETUR DERI NË M/				
	Deri në 10 ditë	10 ditë-1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - mu
- Aktivi					
- Pasivi					
- Ndryshimi (+ ose -)					
- (1/2) * 100					
- (3/1) * 100					

Përgatitur nga _____

Drejtuesi i bankës _____

UDHËZIM

PËR KONTROLLIN E BRENDSHËM NË BANKA DHE NË DEGËT E BANKAVE TË HUAJA

Miraturar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 107, datë 03.11.1999.

KAPITULLI I

TË PËRGJITHSHME

- 1- Ky udhëzim nxirret në zbatim të nenit 12 pika "a" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të neneve 17,18,19 e 20 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
2. Qëllimi i këtij udhëzimi është krijimi i një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm si një faktor kryesor në drejtimin dhe në administrimin e bankave.
3. Subjektet e këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Në vazhdim të këtij udhëzimi këto subjekte do të quhen "bankë".
4. Përkufizim:
"Sistemi i kontrollit të brendshëm përbëhet nga një tërësi procedurash, rregullash dhe strukturash të cilat ekzistojnë brenda bankës. Ato janë hartuar për të vënë në zbatim strategjinë dhe programet e bankës, për të siguruar efektivitetin e veprimtarisë bankare, për të parandaluar humbjet (si ato administrative dhe operacionale), për të pasur një shkallë të lartë saktësie në informacionin financiar dhe drejtues, si dhe për të siguruar përputhshmërinë me ligjet dhe me aktet nënligjore".

KAPITULLI II

REALIZIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

5. Parimi bazë për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në bankë është ushtrimi i tij në mënyrë të pavarur nga strukturat e administrimit dhe të drejtimit të bankës.

Për të siguruar këtë duhet patur parasysh që:

- 5.1. Këshilli drejtues, miraton strategjinë dhe politikën e bankës në lidhje me administrimin e rrezikut në të cilin ajo përfshihet dhe siguron që drejtuesit e lartë të ndërmarrin hapat e nevojshëm për monitorimin dhe për kontrollin e ekspozimit të bankës ndaj këtyre rreziqeve.
- 5.2. Administratorët e bankës kanë përgjegjësi për zbatimin e strategjive dhe të politikave të miratuara nga këshilli drejtues, duke zhvilluar procesin e identifikimit, të matjes, të monitorimit dhe të kontrollit të rreziqeve që ndërmerr banka.
- 5.3. Këshilli drejtues dhe drejtuesit e lartë janë përgjegjës për vendosjen e një standardi të lartë të etikës në veprimet bankare. Të gjithë punonjësit e bankës duhet të njohin rolin e tyre në procesin e kontrollit të brendshëm.
- 5.4. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm kërkon që të vlerësohen të gjithë faktorët e brendshëm e të jashtëm, të cilët pengojnë arritjen e synimeve dhe të objektivave të bankës. Kjo përfshin të gjitha fushat që lidhen me rrezikun bankar. Veprimtaria e kontrollit të brendshëm modifikohet në varësi të ndryshimit të rreziqeve dhe të kërcënimeve si edhe shfaqjes së rreziqeve dhe kërcënimeve të reja.

- 5.5 Veprimtaria e kontrollit të brendshëm, është pjesë përbërëse e operacioneve ditore të bankës, si e tillë ajo duhet të jetë transparente. Ajo përfshin: kontrollin brenda çdo divizioni apo çdo departamenti; kontrole fizike mbi aktivet dhe mbi informacionin, vlerësimet e përputhshmërisë, kontrollin e sistemit të verifikimit dhe të rakordimit të informacionit financiar si edhe rishikimin periodik të efektivitetit të kontroleve të mëparshme.
- 5.6. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm kërkon një ndarje të përshtatshme të detyrave për punonjësit e bankës me qëllim që të mos ketë përplasje interesash dhe përgjegjësisish.
- 5.7. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm kërkon që të ketë në bankë informacione të mjaftueshme dhe tërësore mbi operacionet e brendshme financiare të bankës dhe informacione për gjendjen e problemet e tregut që lidhen me marrjen e vendimeve. Informacioni duhet të jetë i besueshëm, në kohën e duhur, i pranueshëm dhe i vazhdueshëm.
- 5.8. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm kërkon rrugë efektive të komunikimit për të siguruar që i gjithë personeli i bankës është plotësisht në dijeni të politikave dhe të procedurave, të cilat ndikojnë në detyrat dhe në përgjegjësitë e tyre.
- 5.9. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm kërkon ekzistencën e një sistemi të duhur informacioni, të automatizuar ose jo, me qëllim administrimin e veprimtarive të bankës. Saktësia e këtij informacioni duhet kontrolluar vazhdimisht.
- 5.10. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm monitorohet vazhdimisht në përputhje me shkallën e ekspozimit të bankës ndaj rreziqeve.
- 5.11. Bankat duhet të kenë një kontroll të brendshëm efektiv, i cili kryhet nga një personel i kualifikuar dhe kompetent. Kontrolli i brendshëm raporton në këshillin drejtues, në komitetin e kontrollit ose tek drejtuesit e lartë të bankës.
- 5.12. Mangësitë e konstatuara nga kontrolli i brendshëm t'u raportohen në afate të caktuara kohore drejtuesve të bankës. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në lidhje me veprimet korrigjuese për mangësitë e rezultuara nga kontrolli.

KAPITULLI III

LLOJET E KONTROLLEVE TË BRENDSHME

6. Në varësi nga mjetet apo nga mënyrat se si realizohen kontrollet ndahen në:
- kontroll administrativ;
 - kontroll i drejtimit të rrezikut;
 - kontroll i brendshëm;
 - kontroll i komitetit të kontrollit.
- 6.1. Kontrollet administrative janë kontrollet e drejtimit të proceseve të përditshme të aktivitetit që kryen banka, mbështetur në aktet e brendshme të bankës, ku përcaktohen detyrat, funksionet, kufijtë e kompetencave etj.. Ushtrohen nga të gjithë administratorët e bankës.
- 6.2. Kontrollet e drejtimit të rrezikut që merr përsipër banka, përfshijnë hartimin e politikave efektive dhe përcaktimin e kufijve për të kufizuar rrezikun e humbjes në aktivitetin bankar. Ushtrohen nga administratorët e bankës dhe nga organet e saj drejtuese dhe kontrolluese.

Qëllimi i këtyre kontroleve është të identifikojnë ekspozimin e bankës ndaj llojeve të rreziqeve, matjen, administrimin dhe monitorimin e nivelit të tyre. Në procesin e mbikëqyrjes bankare shqyrtohen 9 rreziqe: rreziku i kreditit, i likuiditetit, i normës interesit, i çmimit, i kursit të këmbimit, operacional, i mosrespektimit të rregullave, strategjik dhe i reputacionit. Shtatë rreziqet e para quhen rreziqe të

drejtpërdrejta. Këto janë rreziqe që shoqërojnë pjesën më të madhe të transaksioneve bankare. Dy të fundit quhen rreziqe të tërthorta. Këto rreziqe janë të pranishme pothuaj në çdo vendim të marrë nga drejtuesit e bankës.

Rreziku i kreditit, përfaqëson mundësinë e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore të debitorëve ndaj bankës. Rreziku i kreditit shoqëron portofolin e huave, të investimeve, kontratat derivative dhe marrëdhëniet e bankës me palët e treta.

Rreziku i likuiditetit, përfaqëson mundësinë e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore të bankës në momentin e pagimit, pa pësuar humbje ose shpenzime të papranueshme. Rreziku i likuiditetit bëhet i pranishëm kur drejtuesit e bankës nuk janë në gjendje të identifikojnë ndryshimet në kushtet e tregut, të cilat ndikojnë në aftësinë e bankës për të likuiduar aktivet në kohë sa më të shkurtër. Ky rrezik bëhet i pranishëm kur ka paaftësi në administrimin e rënieve të paplanifikuara në burimet e financimit ose edhe e ndryshimeve në burimet e financimit.

Rreziku i normave të interesit, shkaktohet nga ndryshimet në normat e interesit. Ndryshimet në normat e interesit duhet të shqyrtohen nga dy këndvështrime. I pari, ai i kontabilitetit, që përfaqëson efektin që ka ndryshimi në normat e interesit në të ardhurat e përlllogaritura të bankës. I dyti, ai i ndikimit të ndryshimit të normave të interesit në vlerën e kapitalit të vet bankës, që përfaqëson ndjeshmërinë e vlerës së tregut të bankës, ose pozicioni i kapitalit të vet, ndaj ndryshimeve në normat e interesit.

Rreziku i tregut (çmimit), ka të bëjë me ndryshimet në vlerat e portofoleve të instrumenteve financiare.

Rreziku i kursit të këmbimit, nënkupton rrezikun që krijohet për bankën nga ndryshimi i kurseve të këmbimit. Ky rrezik ndikon në aktivitetin në valutë të bankës dhe sidomos në elementet e përlllogaritura, siç janë huatë, depozitat etj..

Rreziku operacional, përfaqëson mundësinë që të ndodhin probleme gjatë kryerjes së veprimtarisë së bankës. Ky rrezik ekziston në ofrimin e pothuaj të gjitha produkteve dhe shërbimeve të saj. Ai varet nga niveli i kontrollit të brendshëm në bankë, nga sistemet e informacionit të bankës, nga procesi i punës dhe nga personaliteti i punonjësve.

Rreziku i mosrespektimit të rregullave, krijohet nga mosrespektimi i ligjeve, i rregullave apo i standardeve etike dhe i praktikave. Ky rrezik favorizohet nga paqartësia e ligjeve apo e rregullave. Ai pasqyrohet në formën e gjobave, të zhdëmtimeve apo, të masave të tjera ndëshkimore.

Rreziku strategjik, krijohet nga marrja e vendimeve jo të duhura apo nga zbatimi jo i saktë i vendimeve të drejta. Ky rrezik është funksion i përputhshmërisë midis objektivave të bankës, metodave dhe burimeve që përdor ajo për përmbushjen e këtyre objektivave dhe aftësisë së drejtuesve të bankës për t'i vënë në zbatim këto.

Rreziku i reputacionit, ka të bëjë me efektin që ka për bankën opinioni negativ i publikut. Ky rrezik ndikon në mundësitë e bankës për të krijuar marrëdhënie të reja me klientët si edhe për të vazhduar marrëdhëniet ekzistuese.

6.3. Njësia e kontrollit të brendshëm, si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm ka për qëllim të sigurojë një kontroll efektiv të zbatimin e politikave, të rregulloreve dhe të procedurave të miratuara nga këshilli drejtues, të sigurojë saktësinë e informacionit dhe efektivitetin e masave parandaluese ndaj rreziqeve me të cilat përballet banka.

Ky kontroll ka për qëllim :

6.3.1. Të verifikojë që respektohen në vazhdimësi kufijtë e vendosur nga kërkesat ligjore, nga kërkesat rregullative dhe nga politikat e brendshme të bankës në drejtimin e

- rreziqeve me të cilat banka përballet gjatë veprimtarisë të saj.
- 6.3.2. Të verifikojë ekzistencën fizike të aktiveve dhe procedurat për të minimizuar mundësinë e çdo humbjeje, mashtrimi apo keqpërdorimi.
 - 6.3.3. Të sigurojë respektimin e detyrimeve ligjore dhe të vendimeve të këshillit drejtues në rastet e pakësimit të kapitalit dhe të shpërndarjes të dividendëve.
 - 6.3.4. Të sigurojë respektimin e standardeve për raportet e mjaftueshmërisë të kapitalit, për likuiditetin, për rreziqet e mëdha, për pozicionet në valutë.
 - 6.3.5. Të kontrollojë efektivitetin e zbatimit të politikave të bankës për mbrojtjen dhe për monitorimin e saktë të rreziqeve të tregut nga njësitë e ngarkuara me këtë detyrë.
 - 6.3.6. Të verifikojë pozicionin financiar të bankës lidhur me llogarinë e rezultatit.
 - 6.3.7. Të sigurojë zbatimin e Manualit të Kontabilitetit Bankar, përputhshmërinë e kontabilitetit me standardet ndërkombëtare, saktësinë e regjistrimeve kontabile, kompletimin e tij, mundësinë e marrjes së informacionit të duhur dhe besueshmërinë e tij.
 - 6.3.8. Të kontrollojë zbatimin e politikave të miratuara nga këshilli drejtues dhe nga drejtuesit e tjerë të bankës.
 - 6.3.9. Të verifikojë që si realizimi i operacioneve bankare ashtu dhe organizimi dhe procedurat e brendshme janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullatore në fuqi, si dhe me vendimet, urdhërat dhe udhëzimet e organeve drejtuese.
 - 6.3.10. Të sigurojë korrigjimin e menjëhershëm të çdo shkeljeje të ligjit, duke informuar me shkrim këshillin drejtues dhe Bankën e Shqipërisë, për shkeljen si dhe për korrigjimin në përputhje me ligjin.
 - 6.3.11. Të kontrollojë nëse transaksionet e kryera nga banka kanë efekt negativ mbi kufijtë rregullatorë të vendosur nga Banka e Shqipërisë si mjaftueshmëria e kapitalit, likuiditeti, rreziqet e mëdha, klasifikimi i kredive dhe llogaritja e fondeve rezervë etj. si dhe nëse janë në kundërshtim me ligjet fiskale të shtetit.
- 6.4. Komiteti i kontrollit organizon kontrole në bazë të kompetencave që i jep ligji nr.8365, datë 2.7.1998 " Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

KAPITULLI IV

TË TJERA

7. Bankat dhe degët e bankave të huaja, në zbatim të këtij udhëzimi të hartojnë një kuadër rregullativ të plotë për kontrollin e brendshëm, brenda 6-muajve pas hyrjes në fuqi të tij.
8. Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
SHKËLQIM CANI

RREGULLORE

“PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË BANKAVE”.

Miratuar me vendimin nr.06, datë 29.01.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

Në këtë rregullore përcaktohen :

- kriteret dhe procedurat për miratimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të emëruar nga bankat;
 - fusha e veprimtarisë, forma dhe përmbajtja e kontrollit dhe e raporteve të kontrollit të bankës nga ekspertët kontabël të autorizuar.
- 1.2 Bazën ligjore të kësaj rregulloreje e përbëjnë: ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për bankën e Shqipërisë”, neni 43, gërma c, ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI “Llogaritë, kontrolli, inspektimi dhe mënyra e raportimit” dhe ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.
- 1.3 Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të kryer aktivitet bankar në Republikën e Shqipërisë, që në vijim do të quhen “bankë”.
- 1.4 Për efekt të kësaj rregulloreje “kontrolli i ushtruar nga eksperti kontabël i autorizuar “ përfshin :
- a - kontrollin e raporteve bazë financiare, që në vijim quhen “raporte financiare” që përgatiten nga banka në përputhje me “Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (IASs)” përveç kur është parashikuar ndryshe në ligjin “Për kontabilitetin” dhe në “Manualin e kontabilitetit bankar”. Raportet bazë financiare përgatiten për botim dhe shërbejnë për përdorim të përgjithshëm;
 - b- vlerësimin e pasqyrave financiare me karakter specifik të përgatitura nga banka në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;
 - c- vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë të akteve nënligjore dhe të procedurave të bankës, dhe zbatimin e tyre.
- 1.5¹ Komiteti i kontrollit të bankës, në bazë të procedurave me shkrim të përgatitura nga banka, bën përzgjedhjen dhe i propozon asamblesë së aksionerëve ekspertin kontabël të autorizuar.

Komiteti i kontrollit bën vlerësimin e raporteve të ekspertit kontabël të autorizuar, të përgatitura sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Dokumentacioni i kërkuar

- 2.1 Jo më vonë se muaji korrik i çdo viti, banka njofton Bankën e Shqipërisë për ekspertin kontabël të zgjedhur nga vetë banka, për kryerjen e kontrollit të raporteve financiare vjetore të vitit financiar në vazhdim, dhe paraqet kërkesën për miratim në Bankën e Shqipërisë.
- 2.2 Banka e Shqipërisë miraton ekspertin kontabël të autorizuar kur kandidati për ekspert kontabël i paraqitur për miratim është “Shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar” e regjistruar në listën e IEKA-s, dhe kur plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

¹ Shtuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- 2.3 Për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë, dokumentacionin si më poshtë:
- vendimin e asamblesë së aksionerëve të bankës ose të organeve të deleguara prej saj, për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar;
 - programin e kontrollit;
 - letrën e angazhimit të paraqitur nga shoqëria e ekspertëve kontabël;
 - dokumentin që vërteton se shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar është e regjistruar në listën e IEKA-s;
 - ²Vërtetimin nga autoriteti licencues që vërteton se shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë në fushën e ekspertizës kontabël ose shoqëria ndërkombëtare e auditimit, me të cilën shoqëria e auditimit e krijuar në Shqipëri, e zotëruar (filiale) dhe e kontraktuar prej saj, ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë në fushën e ekspertizës kontabël.
- 2.4 Dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në fotokopje të noteruar. Kur dokumentacioni është në gjuhë të huaj, origjinal ose fotokopje i noteruar, do të jetë i shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe dhe i noteruar.

Neni 3

Miratimi ose refuzimi i ekspertit kontabël

- 3.1 Banka e Shqipërisë, brenda një muaji nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë të kërkuar sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje bën miratimin ose refuzimin e emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar të bankës. Në rast refuzimi, jepen me shkrim arsyet përkatëse.
- 3.2 Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, Banka e Shqipërisë, njofton bankën brenda 10 ditëve. Mangësitë duhet të plotësohen nga banka brenda 15 ditëve pune.
- 3.3³ Miratimi i emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar bëhet nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes. Refuzimi i emërimit të ekspertit kontabël bëhet nga Administratori përgjegjës për Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.
- 3.4 Refuzimi i ekspertit kontabël të autorizuar ndodh edhe në rastin kur Banka e Shqipërisë gjykon se eksperti kontabël i autorizuar, në auditimin e mëparshëm, nuk ka vepruar në përputhje me ose nuk ka plotësuar në mënyrë të mjaftueshme kërkesat e nenit 4, të nenit 5 pika 5.1, të nenit 6 pikat 6.1 deri në 6.4, dhe të nenit 7 të kësaj rregulloreje.
- 3.5 Eksperti kontabël i autorizuar dhe/ose banka, në rast refuzimi, kanë të drejtën e ankimimit në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë është përfundimtar.

Neni 4

Kontrolli i raporteve financiare

- 4.1 Eksperti kontabël i autorizuar nga Banka e Shqipërisë kontrollon nëse raportet financiare të bankës janë përgatitur në përputhje me "Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit", përveç kur është parashikuar ndryshe në ligjin "Për kontabilitetin" dhe në "Manualin e kontabilitetit bankar".

Këto raporte përfshijnë:

- Llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve).
- Bilancin kontabël.
- Raportin për ndryshimet në kapital.
- Pasqyrën e cash flow-t.
- Shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

- 4.2⁴ Kontrolli i raporteve financiare, sipas pikës 4.1 të këtij neni, kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit).

² Shtuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³ Paragrafët 3.3; 3.4 dhe 3.5 janë ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴ Ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- 4.3 Mbi bazën e ekzaminimit të bërë, sipas pikës 4.2 të këtij neni, eksperti kontabël i autorizuar jep një opinion, duke vënë në dukje nëse raportet financiare përfaqësojnë një pamje të vërtetë dhe të saktë të aktiveve, të detyrimeve, të kapitalit, të cash flow-t etj..
- 4.4 Gjatë planifikimit dhe kryerjes së kontrollit të raporteve financiare, eksperti kontabël i autorizuar vendos, në mënyrë të pavarur, mbi mënyrën e shqyrtimit të çdo dokumenti dhe të transaksioneve të biznesit, në mënyrë që të japë një opinion të saktë mbi vërtetësinë dhe rregullshmërinë e raporteve financiare të kontrolluara prej tij.

Neni 5

Opinionit i ekspertit kontabël të autorizuar

- 5.1⁵ Në bazë të kontrollit që i ka bërë raporteve financiare për vitin ushtrimor, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin përkatës mbi këtë kontroll, të ushtruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit) dhe ia dorëzon këtë raport drejtuesve të bankës dhe komitetit të kontrollit.
- 5.2 Drejtuesit e bankës i paraqesin asamblesë së zakonshme të aksionerëve raportet financiare të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar së bashku me opinionin e tij. Drejtuesit e bankës nënshkruajnë raportet financiare të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar.
- 5.3 Pas marrjes së vendimit përkatës nga asambleja e aksionerëve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 5.2 të këtij neni, banka boton në buletin zyrtar të saj bilancin kontabël, raportin vjetor financiar dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
- 5.4 Një kopje e buletinit zyrtar të bankës, të botuar sipas pikës 5.3 të këtij neni, dërgohet edhe në Bankën e Shqipërisë jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i periudhës raportuese.

Neni 6

Vlerësimi i pasqyrave financiare me karakter specifik

- 6.1 Eksperti kontabël i autorizuar shqyrton dhe vlerëson pasqyrat financiare të bankës, të cilat tregojnë gjendjen në fund të vitit financiar dhe/ose të periudhave të tjera të ndërmjetme gjatë vitit në vazhdim. Këto pasqyra financiare përgatiten nga banka në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë dhe përfshijnë të gjitha pasqyrat e sistemit raportues të bankave.
- 6.2 Vlerësimi i pasqyrave financiare, sipas pikës 6.1 të këtij neni përfshin:
- a - verifikimin e saktësisë së pasqyrave të përgatitura në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, që rregullojnë mënyrën e përgatitjes së tyre;
 - b - verifikimin e përputhjes së pozicioneve kyçe korresponduese në pasqyrat financiare me ato në raportet financiare, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.
- 6.3 Në rastet kur eksperti kontabël i autorizuar nuk mund të japë një vlerësim mbi bazën e rezultateve të arritura nga ekzaminimi i pasqyrave financiare, ai bën komente mbi çdo pasqyrë për të cilën nuk mund të jepet vlerësim pozitiv, dhe paraqet parregullsitë e vërejtura në pasqyrën në fjalë.
- 6.4⁶ Eksperti kontabël i autorizuar dorëzon vlerësimin e tij me shkrim tek drejtuesit e bankës dhe te komiteti i kontrollit për pasqyrat financiare të përcaktuara në këtë nen.
- 6.5 Pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, së bashku me raportin/vlerësimin e ekspertit kontabël të autorizuar sipas pikës 6.4 të këtij neni, paraqiten nga drejtuesit e bankës në Bankën e Shqipërisë jo më vonë se 6 muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.
- 6.6 Çdo pasqyrë financiare e bankës do të jetë e nënshkruar paraprakisht nga drejtuesit e bankës

Neni 7

Procedura të tjera kontrolli

- 7.1 Eksperti kontabël i autorizuar bën edhe vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë të akteve nënligjore dhe të procedurave të bankës dhe zbatimin e tyre. Kjo përfshin vlerësimin, nga ana e ekspertit kontabël të autorizuar, për:
- a) organizimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të bankës;
 - b) cilësinë dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme të bankës për administrimin e

⁵ Ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶ Ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- aktiveve dhe pasiveve;
- c) organizimin e sistemit të teknologjisë së informacionit dhe koordinimin e tij me objektivat e biznesit dhe me ruajtjen e integritetit të të dhënave.

- 7.2⁷ Eksperti kontabël i autorizuar kërkon paraprakisht dhe vlerëson shqetësimet e Bankës së Shqipërisë për aspekte të veçanta të veprimtarisë së bankës.
- 7.3 Eksperti kontabël i autorizuar përgatit një raport, në të cilin shpreh opinionin dhe vlerësimin e tij, mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të bankës; mbi cilësinë e rregulloreve të bankës dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzon tek drejtuesit e bankës, te komiteti i kontrollit dhe një kopje të tij edhe në Bankën e Shqipërisë, jo më vonë se 6 muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

- 8.1 Eksperti kontabël i autorizuar i bankës, i miratuar nga Banka e Shqipërisë, kryen kontrollin në bankë për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të tij, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
- 8.2⁸ Sipas kërkesës së bërë nga Banka e Shqipërisë, drejtuesit e bankës paraqesin për dijeni në Bankën e Shqipërisë, "letrën për administratorët" që eksperti kontabël përgatit për drejtuesit e lartë të bankës. Lëshimi i "letrës për administratorët" është pjesë e letrës së angazhimit.
- 8.3 Një kopje e raporteve të ekspertit kontabël të autorizuar, të përgatitura sipas kërkesave të nenëve 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, së bashku me vlerësimet e komitetit të kontrollit, i dërgohen Bankës së Shqipërisë nga drejtuesit e bankës, jo më vonë se gjashtë muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.
- 8.4 Përfaqësues të Bankës së Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes), eksperti kontabël i autorizuar dhe përfaqësues të bankës zhvillojnë takime të rregullta periodike:
- para ose pas përfundimit të ekzaminimit të plotë të kryer nga mbikëqyrësit e bankës;
 - në rrethanat kur merren vendime të rëndësishme për bankën.
- 8.5 Udhëzimi "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave dhe të degëve të bankave të huaja", miratuar me vendimin nr. 39, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.
- 8.6 Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.06, datë 29.01.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

⁷ Ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁸ Ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

UDHËZIM

PËR ÇERTIFIKATAT E DEPOZITAVE

Miraturar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.79, datë 03.10.2001.

Kapitulli i Parë

TË PËRGJITHSHME

1. PËRCAKTIM

Çertifikatat e Depozitave (ÇD) përfaqësojnë një formë të caktuar të grumbullimit të depozitave me afat. Ato mund të emetohen si ÇD emërore (nominale) ose të mbajtësit (prurësit).

2. EMETUESIT

ÇD emetohen nga bankat dhe nga degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të kryer aktivitetet bankar, që në vijim të këtij udhëzimi do të quhen "banka".

3. MADHËSIA MINIMALE

ÇD emetohen në Lekë, Usd, Euro.

Për ÇD në Lekë, shuma minimale është 50,000 lekë.

Për ÇD në Usd, shuma minimale është 1,000 usd.

Për ÇD në Euro, shuma minimale është 1,000 euro.

Bankat emetojnë ÇD me prerje mbi shumën minimale, por me kusht që shtesa të jetë shumëfish i plotë, përkatësisht për ÇD në Lekë i 10,000, për ÇD në Usd dhe Euro i 500.

4. AFATI I MATURIMIT

Afati i maturimit i ÇD është nga 1 muaj deri në 60 muaj.

Të gjitha ÇD me afat maturimi nga 1 muaj deri në 12 muaj quhen afatshkurtra.

Të gjitha ÇD me afat maturimi nga 12 muaj deri në 36 muaj quhen afatmesme.

Të gjitha ÇD me afat maturimi nga 36 muaj deri në 60 muaj quhen afatgjata.

5. NORMA E INTERESIT

Norma e interesit mund të jetë :

- fikse (e pandryshueshme) gjatë gjithë afatit të maturimit ;
- e indeksueshme (ndryshueshme) mbi bazën e disa parametrevë të njohur në tregun ndërbankar ndërkombëtar ;
- mikse, që është një kombinim i normës të indeksueshme (ndryshueshme) me atë fikse (pandryshueshme).

6. INTERESI

Interesi mund të jetë i llogaritur në maturim (ILM) dhe të paguhet në fund të afatit të maturimit ose i llogaritur në avancë (ILA) dhe të paguhet kur ÇD emetohet.

7. REZERVA E DETYRUESHME

Me vendim të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë caktohet edhe rezerva e detyrueshme për ÇD.

8. REGJIMI I QARKULLIMIT

8.1. Për ÇD të mbajtësit (prurësit):

- Të gjitha të drejtat, për interesat dhe shlyerjen e kryegjësë në fund të periudhës së maturimit i takojnë mbajtësit (prurësit) të ÇD.
- Bankat emetuese ndërtojnë procedurat e brendshme për të përcaktuar format, karakteristikat e ÇD, emetimin, llojin, madhësinë, madhësinë e shumëfishave, shlyerjen e ÇD dhe, në mënyrë të veçantë, procedura të brendshme për regjimin e qarkullimit dhe për njohjen e klientit për ÇD e mbajtësit (prurësit).

9. KUFIZIMET

Në asnjë rast banka emetuese nuk shlyen para afatit ÇD të emetuar prej saj.

Banka emetuese asiston klientin e saj, pronarin e ÇD, për shlyerjen para afatit nëpërmjet :

- gjetjes të një klienti të ri të gatshëm për ta blerë ÇD e dhënë ;
- gjetjes së një banke tjetër me të cilën ka lidhur një marrëveshje reciproke për shlyerjen para afatit të ÇD respektivisht të emetuar prej tyre.

Në çdo rast ÇD qëndrojnë të regjistruara në librat e bankës emetuese, e cila detyrohet të shlyejë në afat kryeqjës dhe interesin.

Kapitulli I Dytë

KONTABILITETI I ÇERTIFIKATAVE TË DEPOZITAVE

1. PLANI I LLOGARIVE

Në planin e llogarive ÇD kontabilizohen në klasën 2 "Veprimet me klientelën", rubrika 27 "Detyrime ndaj klientelës për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat", grupi 274 "Çertifikatat e Depozitave".

Struktura e grupit 274 është si më poshtë :

274. Çertifikatat e Depozitave

2741. Çertifikatat e depozitave emërore (nominale).

27411. Individët.

27412. Njësitë tregtare dhe industriale private.

27413. Njësitë tregtare dhe industriale publike.

27414. Punonjësit e bankës.

27415. Klientët e tjerë.

27419. Interesi i përlllogaritur.

2742. Çertifikatat e depozitave të mbajtësit (prurësit).

27421. Kryeqjësja.

27429. Interesi i përlllogaritur.

2. VLERËSIMI I REGJISTRIMEVE KONTABILE

Të gjitha ÇD emërore (nominale) regjistrohen në llogarinë 2741, ndërsa ÇD e mbajtësit (prurësit) regjistrohen në llogarinë 2742.

ÇD me ILM vlerësohen me vlerën nominale të kryeqjësë dhe regjistrohen në nënlllogaritë përkatëse (27411, 27412, 27413, 27414, 27415, 27421).

Interesi i llogaritur vlerësohet "*pro rata temporis*" dhe regjistrohet në nënlllogaritë përkatëse (27419, 27429).

ÇD me ILA vlerësohen me çmim (diferenca e vlerës nominale me interesin e parapaguar) dhe regjistrohen në llogaritë përkatëse (27411, 27412, 27413, 27414, 27415, 27421).

Interesi i llogaritur vlerësohet "*pro rata temporis*" dhe regjistrohet në nënlllogaritë përkatëse (27419, 27429).

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M
NR. 26. DATË 29.03.2000**

**PËR
PËRJASHTIMIN E DISA SUBJEKTEVE NGA ZBATIMI I
DISPOZITAVE TË LIGJIT NR.8365, DATË 2.07.1998 "PËR
BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" NË BAZË TË
NENIT 1 PIKA 2 E KËTJ LIGJ.**

Këshilli Mbiqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozim të Departamentit të Mbiqyrjes, në bazë të nenit 1, pika 2 e ligjit nr.8365, datë 2.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

- 1 Të përjashtojë nga zbatimi i dispozitave të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" subjektet që kryejnë aktivitet kredidhënës, origjina e burimeve financiare të të cilave rrjedh nga organizata ndërkombëtare apo nga qeveri të vendeve të tjera në formë ndihme falas për efekt të zhvillimit të biznesit të vogël dhe të mesëm në Shqipëri, dhe që nuk zhvillojnë aktivitetin e grumbullimit të depozitave.
- 2 Këto subjekte janë të detyruara vetëm të raportojnë në Bankën e Shqipërisë, sipas një sistemi raportues të miratuar.
- 3 Ngarkohet Departamenti i Mbiqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
- 4 Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve dhe Publikimeve për publikimin e këtij vendimi.
- 5 Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë

SEKRETARI
Ylli Memisha

KRYETARI
Shkëlqim Cani

UDHËZIM

PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 102, datë 29.12.2001.

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky udhëzim nxirret në mbështetje e për zbatim të ligjit nr. 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", të nenit 43 pika c, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të nenit 24, të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Subjekte të këtij udhëzimi janë të gjitha subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë. Për lehtësi në vijim do të përdoret vetëm termi "bankë".

Neni 3

Ky udhëzim shërben për hartimin e politikave dhe të procedurave të bankave dhe për krijimin e kushteve për zbatimin e tyre, lidhur me parandalimin e pastrimit të parave.

PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT DHE TË RAPORTIMIT

Neni 4

Banka kryen procedurat e identifikimit sipas nenit 4, të ligjit nr.8610, datë 17.05.2000 " Për parandalimin e pastrimit të parave". Në rast se banka e gjykon të arsyeshme mund të kërkojë informacion shtesë për identifikimin e klientit.

Banka regjistron të dhëna dhe detaje për çdo klient që kryen veprime financiare në cash, në emër të tij ose për llogari të të tretëve, mbi shumën prej 2 milionë lekësh ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja.

Regjistrimi i të dhënave bëhet sipas formularëve të përgatitur nga Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, pranë Ministrisë së Financave (Autoriteti Përgjegjës).

Banka ka të drejtë që për çdo transaksion të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime, për të dalë qartë burimi i krijimit të parave që përdoren për transaksionin dhe përfituesin e këtij transaksioni, si dhe të evidentojë këto burime.

Neni 5

Banka ruan regjistrimet e të dhënave dhe të detajeve për çdo klient që kryen veprime financiare në cash, në emër të tij ose për llogari të të tretëve, mbi shumën prej 2 milionë lekësh ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, së bashku me të gjithë dokumentacionin justifikues, sipas afateve që përcakton ligji nr.8610, datë 17.05.2000 " Për parandalimin e pastrimit të parave".

Pas regjistrimit, në rast se ka elemente të dyshimit sipas pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr.8610, datë 17.05.2000 " Për parandalimin e pastrimit të parave", brenda 48 orëve, banka raporton tek Autoriteti Përgjegjës, sipas "formularit të sinjalizimit", të përcaktuar prej tij.

Banka raporton tek Autoriteti Përgjegjës për të gjitha rastet e një ose disa veprimeve financiare në cash dhe/ose të transfertave të fondeve për shumat mbi 70 milionë lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, sipas "formularit të raportimit", të përgatitur nga Autoriteti Përgjegjës.

Banka identifikon klientin dhe informon Autoritetin Përgjegjës edhe për rastet kur ka të dhëna për pastrimin e parave, pavarësisht se shuma mund të jetë nën kufirin e parashikuar nga ligji.

Kriteret për identifikimin e operacioneve të dyshimta, të transaksioneve apo të klientëve janë dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

STRUKTURAT PËRKATËSE BANKARE DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 6

Banka krijon strukturën dhe infrastrukturën e nevojshme për parandalimin e përdorimit të saj si rrugë për pastrimin e parave, të rrjedhura nga aktivitete të paligjshme, sipas nenit 7, të ligjit nr.8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave".

Banka cakton një procedurë të brendshme për evidentimin dhe për sinjalizimin e operacioneve të dyshimta, të formalizuara në rregulloret e brendshme të saj.

Degët e bankave që veprojnë në Republikën e Shqipërisë regjistrojnë të gjitha veprimet financiare në cash të çdo klienti për shumat mbi 2 milionë lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja. Ndërsa drejtoria e përgjithshme mban të dhënat e përmbledhura për të gjithë rrjetin e saj në Shqipëri.

Neni 7

Jo më vonë se një muaj pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bankat duhet të emërojnë personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave" dhe të këtij udhëzimi si dhe për hartimin e politikave e të procedurave përkatëse për këtë qëllim.

Neni 8

Punonjësi i bankës, për çdo transaksion, që për nga karakteristikat, natyra ose për çdo rrethanë tjetër të njohur për shkak të ushtrimit të detyrës së tij, dyshon se paratë ose çdo pasuri tjetër, objekt i këtij transaksioni, burojnë nga një aktivitet i paligjshëm, duhet të vërë në dijeni personat përgjegjës të caktuar në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave".

Personat përgjegjës në qendër, në degë dhe në agjenci shqyrtojnë sinjalizimin e ardhur dhe në rast se e gjejnë të bazuar, njoftojnë Autoritetin Përgjegjës pranë Ministrisë së Financave brenda 48 orëve, sipas procedurave përkatëse të caktuara prej tyre.

Banka, gjithashtu, dërgon informacione shtesë tek Autoriteti Përgjegjës, kur kërkohen prej tij dhe bashkëpunon për dokumentimin e pastrimit të parave, në rast konstatimi. Autoriteti Përgjegjës i jepen të dhënat vetëm nga administratorët ose nga zyrtarët e autorizuar nga banka.

Neni 9

Banka thëllon punën e saj për njohjen e klientelës, të karakteristikave të saj ekonomike dhe të kërkesave të saj financiare. Banka harton një rregullore të brendshme " Si të njohim klientin".

Banka krijon një bazë të dhënash për klientelën, të përbërë nga karakteristikat ekonomike dhe financiare të tyre, që t'i shërbejë punonjësit të saj për të vlerësuar dhe për të identifikuar transaksionet potencialisht të lidhura me veprimtari të paligjshme.

Neni 10

Banka bën vlerësimin e transaksioneve mbështetur në elementet në dispozicion.

Detyra e saj për vlerësimin e ekzistencës ose jo të detyrimit për sinjalizim, qëndron në perceptimin e operacionit jonormal (të dyshimtë).

Banka përcakton, që në kushtet e punës të hapjes së llogarive të klientëve, modalitete dhe kërkesa lidhur me informacionin e nevojshëm që i duhet për të bërë vlerësimin e operacioneve.

Banka duhet të sigurohet për vërtetësinë e identitetit të personit që kërkon të kryejë transaksionin financiar dhe të personit që përfiton nga ky transaksion. Nëpërmjet këtij veprimi banka duhet të eliminojë kryerjen e veprimeve nga personat kërkues anonimë dhe nga personat përfitues fiktivë.

Për këtë qëllim, banka në rast se personi nuk ka marrëdhënie të vazhdueshme me të, duhet të ballafaqojë informacionin e saj me burimet e lëshimit të dokumenteve sipas mundësive, ndërsa në rast se personi ka marrëdhënie të vazhdueshme me bankën, duhet të rifreskojë periodikisht vlefshmërinë e të dhënave.

Neni 11

Banka i kushton vëmendje rasteve kur degë të veçanta kërkojnë furnizim në cash ose rasteve, që përfaqësojnë transaksione në cash për vlefte që i kalojnë shumë kërkesat e zakonshme në bazë të karakteristikave të zonës dhe të klientelës që i shërbehet.

Neni 12

Banka, në zbatim të këtij udhëzimi, përcakton procedurat operative të kontrollit të brendshëm për një vlerësim më të kujdesshëm të marrëdhënieve me klientelën dhe të operacioneve të kryera, si dhe përcakton qartë detyrimin për të sinjalizuar.

Banka merr masa për informimin në mënyrë periodike të punonjësve për procedurat ligjore të veprës penale të pastrimit të parave si dhe për hartimin e programeve të trajnimit dhe të kualifikimit të personelit të caktuar për këtë qëllim.

Neni 13

Banka e Shqipërisë, në ushtrimin e rolit mbikëqyrës të saj kontrollon zbatimin nga ana e bankës të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave" dhe të këtij udhëzimi. Banka e Shqipërisë nuk do të kufizohet vetëm në verifikimin nëse transaksionet janë dokumentuar, regjistruar dhe raportuar, por dhe në raportimin e transaksioneve që vërehen si të dyshimta gjatë inspektimit.

Neni 14

Punonjësit e bankës detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe ndalohen të njoftojnë klientin për procedurat e verifikimit të dyshimit të pastrimit të parave.

Neni 15

Për të gjitha shkeljet e evidentuara nga Banka e Shqipërisë, në rast se nuk janë objekt dënimi dhe masash ndëshkimore nga Drejtoria e Bashkëndimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, Banka e Shqipërisë vendos dënime ose masa ndëshkimore në përputhje me nenin 44, të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 16

Banka, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", ka të drejtë të mos kryejë transaksionin financiar kur nuk sigurohet për identitetin e plotë të klientit, kur provon anonimatit e tij ose kur ka prova se transaksioni është i lidhur me pastrimin e parave.

Neni 17

Rregullorja "Për parandalimin e pastrimit të parave" me nr.3/3/97, datë 16.01.97 së bashku me të gjitha ndryshimet, shfuqizohet.

Neni 18

Ky udhëzim së bashku me aneksin bashkëlidhur, hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

ANEKS 1

Transaksione të dyshimta

Bankat, nga shqyrtimi i plotë i të gjitha elementeve në dispozicion të tyre, vlerësojnë operacionet me qëllim sinjalizimi. Vlerësimi bëhet nga peshimi i të dhënave, që krijojnë tek një subjekt i kujdesshëm profesionalisht, dyshimin për një prejardhje të paligjshme të parasë, të pasurive ose të të mirave materiale, objekt i operacionit.

Operacione që shfaqen me anomali objektive mund të rezultojnë të justifikuara dhe të padyshimta, nëse shihen nën dritën e të dhënave të njohura nga banka.

Lista e mëposhtme përmbledh një numër operacionesh që konsiderohen të dyshimta, por ajo nuk është përfundimtare, vetëm do të shërbejë si orientuese.

1. Tregues të anomalisë në operacionet që u drejtohen të gjitha bankave.
 - 1.1 Operacione që, në lidhje me subjektin që i vë në jetë, shfaqen me një vlerë jo të zakonit ose ekonomikisht të pajustificueshme.
 - 1.2 Operacione të së njëjtës natyrë, të përsëritura pranë të njëjtës degë ose agjenci me modalitete të tilla, që të bëjnë të dyshosh për synime të paligjshme.
 - 1.3 Operacione të kryera vazhdimisht në emër të të tretëve, që nuk shfaqen asnjëherë personalisht, kur kjo nuk rrjedh nga kërkesa operative ose organizative evidente të klientit, veçanërisht kur jepen justifikime e pretekste që nuk mund të ballafaqohen (për shembull, sëmundje, punë etj.).
 - 1.4 Operacione për të cilat të dhënat janë në mënyrë të dukshme të pasakta ose të paplota, ose të tilla që të bëjnë të dyshosh se synojnë të fshehin me dashje informacione thelbësore, në veçanti që u përkasin subjekteve të interesuara për operacionin.
2. Tregues të anomalisë në operacionet në cash.
 - 2.1 Kërkesa të shpeshta dhe për shuma të mëdha të çeqeve kundrejt derdhjeve në cash.
 - 2.2 Tërheqje ose derdhje të mëdha në cash, të pamotivuara nga aktiviteti i klientit (veçanërisht, kur shumat e derdhura transferohen më pas, brenda një intervali të shkurtër kohe ose me modalitete apo destinacione, që nuk lidhen me aktivitetin normal të klientit).
 - 2.3 Përdorimi i shpeshtë i cash-it në shuma të mëdha për kryerjen e urdhërhirimeve (në dobi të të tretëve), pa arsye të pranueshme që lidhen me aktivitetin normal të klientit, veçanërisht nëse operacioni kryhet jashtë vendit.
 - 2.4 Derdhje të shpeshta në cash, të kryera në mënyrë të tillë që vlefata e operacioneve të veçanta të kalojë pa u vënë re, ndërsa ajo e përgjithshme rezulton e konsiderueshme (për shembull, derdhje të pjesshme në disa llogari).
 - 2.5 Kryerja e operacioneve, si derdhje ashtu edhe tërheqje, të bëra në cash, të ndryshme nga instrumentet e mjetet e pagesës zakonisht të përdorura në aktivitetin ekonomik të ushtruar nga klienti.
 - 2.6 Operacione të shpeshta këmbimi në cash, në valuta të tjera për shuma të konsiderueshme, veçanërisht nëse kryhen pa kaluar në llogarinë rrjedhëse.
 - 2.7 Këmbime të një sasi të madhe kartëmonedhash ose monedhash me kartëmonedha ose monedha të një prerjeje të ndryshme.
 - 2.8 Blerje të shpeshta të shumave të mëdha të monedhave metalike dhe të kartëmonedhave me vlera commemorative për qëllime numizmatike.
3. Tregues të anomalisë në operacionet me tituj.

- 3.1 Blerja dhe/ose depozitimi i titujve për shuma të mëdha, kur kjo nuk përputhet me kushtet financiare të klientit.
 - 3.2 Arkëtimi në cash ose depozitimi, edhe me garanci të besueshme, i titujve të një vlefte të konsiderueshme, vendi ose të huaja, veçanërisht nëse janë me shpërndarje të kufizuar, kur operacioni duket jonormal në krahasim me karakteristikat e klientit dhe nuk jepet një justifikim i pranueshëm për prejardhjen.
 - 3.3 Negocimi i titujve për arkëtime në cash ose për blerjen e titujve të tjerë (aksione, obligacione, tituj publikë etj.) pa kaluar operacioni në llogarinë rrjedhëse që përdoret nga klienti.
4. Tregues të anomalisë në operacionet me jashtë.
- 4.1 Transferimet, edhe elektronike, të shumave të mëdha në vlerë jashtë shtetit ose nga jashtë me urdhërpagesë në cash, veçanërisht kur nuk kalojnë nëpërmjet një llogarie, ose kur karakteristikat e operacionit, përfshirë këtu vendi i huaj i origjinës ose i destinacionit të shumave, nuk janë të justifikuar nga aktiviteti ekonomik i zhvilluar nga klienti ose nga rrethana të tjera.
 - 4.2 Operacione me filiale ose me degë të institucioneve financiare, të rrethuara nga zona gjeografike të njohura si zona të trafikut të drogës ose si "qendra offshore", që nuk janë të justifikuar nga aktiviteti ekonomik që kryhet nga klienti.
 - 4.3 Përdorimi i sistemeve të tjera financimi tregtar për të transferuar shuma mes shteteve, pa qenë transaksioni përkatës i justifikuar nga veprimtaria e zakonshme ekonomike e kryer nga klienti.
 - 4.4 Derdhje e shpeshtë e çeqeve të udhëtarëve, e titujve ose e instrumenteve të tjera financiare në valutë të huaj, pa justifikime të arsyeshme.
5. Tregues të anomalisë në operacione e shërbime të tjera.
- 5.1 Përdorim i përsëritur i kasetave të sigurimit ose i shërbimeve të ruajtjes ose depozitime të shpeshta dhe tërheqje të plikove të vulosura, të pajustificuara nga aktiviteti dhe zakoni i klientit.
 - 5.2 Delegimi për të operuar me kasetat e sigurimit tek të tretët, që nuk bëjnë pjesë në bërthamën familjare të mbajtësve ose që nuk janë të lidhur me raporte bashkëpunimi ose të një tipi tjetër, që do të justifikonte këtë delegim.
 - 5.3 Dhënia e garancive nga ana e të tretëve, joklientë të bankës, as dhe të njohur ndryshe, tek të cilat nuk jepen të dhëna të mjaftueshme për marrëdhëniet me klientin përfitues të besimit apo arsye që justifikojnë dhënien e një garancie të tillë.
 - 5.4 Blerja ose shitja e sasive të mëdha të monedhave, të metaleve të çmuara ose të vlerave të tjera, pa një justifikim të dukshëm dhe/ose në përputhje me kushtet ekonomike të klientit.
 - 5.5 Kërkesa që i bëhet bankës, nga ana e një klienti, për të dhënë një financim për një subjekt tjetër për të cilin vetë klienti ofron një garanci reale (për shembull, pasuri të paluajtshme ose tituj) në rast se marrëdhëniet midis klientit të dhënë dhe subjektit tjetër nuk janë të justifikuar.
6. Tregues të anomalisë në ecurinë e llogarive.
- 6.1 Llogari të përdorura jo për operacione normale personale ose aktivitete ekonomike të lidhura me to, por për të marrë ose për të derdhur shuma të mëdha që, në bazë të elementeve në dispozicion, nuk gjejnë justifikim ose lidhje me mbajtësin e llogarisë dhe/ose me aktivitetin e tij.
 - 6.2 Llogari, që për një kohë të gjatë janë joaktive ose pak të aktivizuara dhe pa justifikime të arsyeshme, papritmas fillojnë operacione me shuma të mëdha ose që pak kohë më parë kanë përfituar kreditime të mëdha e të papritura, sidomos nëse ato vijnë nga jashtë.

- 6.3 Llogari, që paraqesin një tepricë aktive të madhe, që nuk përputhet me ecurinë e zakonshme financiare të klientit, veçanërisht nëse ajo është transferuar në llogari jashtë shtetit.
 - 6.4 Llogari, që përfitojnë një numër të madh derdhjesh për shumta të marra pa justifikime të arsyeshme.
 - 6.5 Llogari, që tregojnë një lëvizje të pajustificuar nga aktiviteti i zhvilluar prej klientit (për shembull, derdhje të shpeshta të çeqeve, veçanërisht kur në ta figurojnë elemente përsëritëse, nga ana e një subjekti, që nuk ushtron aktivitetin e dhënies së financimeve).
 - 6.6 Konfigurimi, ekonomikisht jonormal, i raporteve që mbahen nga klienti me bankën, për shembull, llogari të shumta të hapura pa justifikim pranë së njëjtës bankë, transferime të shpeshta shumash mes llogarive të ndryshme ose barazimi në një kohë të shkurtër mes derdhjeve e tërheqjeve në cash mbi të njëjtën llogari ose depozitë, pranimi i vetëdijshëm i kushteve e taksave të pafavorshme dhe që nuk përputhen me ato të tregut.
7. Tregues anomalie në sjelljen e klientelës.
- 7.1 Klientë që kërkojnë të ristrukturojnë operacionin kur konfiguracioni i paraqitur që në fillim implikon forma identifikimi e regjistrimi ose plotësime hetimesh apo verifikimesh nga ana e personelit të ndërmjetësuesit, ose adoptimi i klauzolave kufizuese të lirisë së qarkullimit të titujve (për shembull, reduktimi i vleftës së operacionit nën 2 milionë lekë ose ekuivalentet në monedha të tjera, për të shmangur identifikimin).
 - 7.2 Klientë që refuzojnë ose që pa justifikim ngurrojnë të japin informacionet e duhura për kryerjen e operacioneve, të deklarojnë aktivitetet e veta, të paraqesin dokumentacionin kontabël ose të një lloji tjetër, të sinjalizojnë marrëdhëniet e mbajtura me bankat e tjera, të japin informacione që, në rrethana normale do ta bënin vetë klientin të përshtatshëm për të marrë kredinë ose shërbime të tjera bankare.
 - 7.3 Klientë në vështirësi ekonomike, që papritur kërkojnë të shlyejnë plotësisht ose pjesërisht detyrimet e veta me anë të derdhjeve të papritura me një vleftë të madhe, pa një justifikim të dukshëm dhe pa saktësuar origjinën e fondeve.
 - 7.4 Klientë që evitojnë kontakte direkte me personelin e bankës, duke lëshuar prokura në emër të të tretëve, në mënyrë të shpeshtë e të pajustificuar.
 - 7.5 Klientë, që pa justifikim, kanë llogari të shumta dhe kryejnë transaksione të shumave të mëdha në cash mbi secilën prej tyre ose që rezultojnë të kenë, pa shkaqe të arsyeshme, llogari të hapura me shumë institucione financiare në të njëjtën zonë.
 - 7.6 Klientë që, pa dhënë justifikime të arsyeshme, drejtohen tek një sportel bankar, që ndodhet larg nga zona në të cilën banojnë ose ushtrojnë aktivitetin e tyre.
 - 7.7 Klientë që insistojnë të mbajnë llogari që duken se administrohen për llogari të të tretëve (llogari në mirëbesim), (për shembull, llogari që paraqesin lëvizje që nuk lidhen me aktivitetin e zhvilluar nga mbajtësi i llogarisë ose të një vlefte që nuk i korrespondon vëllimit të tij të punës, ose llogari të emërtuara në favor të administratorëve, të vartësve ose të klientëve, të përdorura nga sipërmarrje ose ente për të kryer derdhje ose tërheqje në cash ose nëpërmjet instrumenteve të tjera financiare).
 - 7.8. Klientë ose përfaqësues të tyre që paraqesin dokumente identifikimi me origjinë të dyshimtë.
 - 7.9 Klientë që publikisht njihen që kanë të dhëna kriminale.
 - 7.10. Klientë që japin si adresë të tyre një adresë të një personi të tretë.
8. Anomalitë lidhur me veprimet me letrat me vlerë të qeverisë nga persona fizikë.
- 8.1 Blerje të shpeshta të vëllimeve të mëdha të letrave me vlerë të qeverisë.
 - 8.2 Transferta në vlera më të mëdha se zakonisht, më të shpeshta ose jo tipike të letrave me vlerë të qeverisë, të përfituara nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, të kryera nga një ose disa persona fizikë.

- 8.3 Blerja dhe menjëherë pas kësaj ofrimi për shitje i letrave me vlerë të qeverisë para maturitetit, të përfituara nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, në madhësi të mëdha dhe në rrethana që duken jo të zakonshme për mënyrat normale të kryerjes së këtij aktiviteti.
 - 8.4. Madhësi në vëllime të mëdha dhe të përsëritura të tregtimeve jonormale të letrave me vlerë të qeverisë për llogari dhe me shpenzime të një pale të tretë, kundrejt paraqitjes së një prokure ose në emër të personave nën 18 vjeç.
9. Pastrimi i parave nëpërmjet përfshirjes së punonjësve të bankës.
- 9.1. Një ndryshim i madh në kushtet e jetesës së një punonjësi të bankës i pamotivuar: menjëherë një mënyrë luksi jetese.
 - 9.2. Një ndryshim në kryerjen e detyrave, si rritje e menjëhershme e madhësisë së transaksioneve në cash.

UDHËZIM

MBI

KUJDESTARINË DHE LIKUIDIMIN E BANKAVE

Miraturar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 12.06. 2002.

Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim nxirret në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" neni 12, gërma a; të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 " Për bankat në Republikën e Shqipërisë" neni 1 dhe kreu VIII.
2. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat, procedurat dhe detyrimet e palëve kur një bankë merret në administrim të përkohshëm nga Banka e Shqipërisë, vendoset në kujdestari dhe kur një bankë likuidohet.
3. Në këtë udhëzim, përderisa nga përmbajtja të mos ketë tjetër kuptim :
 - me termin "kujdestari" kuptohet : "marrja në administrim dhe në kontroll e bankës, për shkak të evidentimit të rrethanave të parashikuara në nenin 48 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", nga kujdestari i zgjedhur dhe i emëruar nga Banka e Shqipërisë;
 - me termin "kujdestar" kuptohet: "individ i zgjedhur dhe i emëruar nga Banka e Shqipërisë për të marrë në administrim dhe në kontroll bankën, kur janë konstatuar rrethanat e parashikuara në nenin 48 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
 - me termin "likuidim" kuptohet : "likuidimi i detyruar administrativ i vendosur nga Banka e Shqipërisë në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" ;
 - me termin "likuidator" kuptohet "individ i zgjedhur dhe i emëruar nga Banka e Shqipërisë për marrjen në posedim dhe në kontroll të bankës si dhe për të kryer procesin e likuidimit të detyruar administrativ, vendosur nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
 - "bankë" – personi juridik që kryen veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë.

Kujdestaria

4. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë merr vendimin për vendosjen e bankës në kujdestari kur:
 - raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik, dhe zërave jashtë bilancit është më pak se gjysma e raportit minimal të kërkuar dhe kjo nuk është korrigjuar edhe pas kalimit të afatit të dhënë nga Banka e Shqipërisë.
5. Qëllimi i kujdestarisë është rikthimi i bankës në një gjendje të tillë financiare që raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik, dhe zërave jashtë bilancit të jetë jo më pak se raporti minimal i kërkuar, i përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
6. Kujdestari i zgjedhur dhe i emëruar nga Guvernatori gëzon të gjitha pushtetet e administratorëve, të drejtorëve ekzekutivë dhe të nëpunësve të bankës, në përputhje me autoritetin e dhënë nga Banka e Shqipërisë në aktin e emërimit.
7. Kujdestari është subjekt i rregullave, i rregulloreve dhe i urdhrave të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.
8. Kujdestari, brenda 30 ditëve nga data e emërimit, merr në dorëzim të gjithë inventarin e aktiveve dhe të pasurive të bankës, si dhe të gjithë dokumentacionin e arkivës së bankës. Dorëzimi i tyre bëhet me procesverbal të nënshkruar nga personat përgjegjës, nga

administratorët dhe nga nëpunësit e pezulluar të bankës, dhe kujdestari.

9. Menjëherë sapo bëhet emërimi i tij, kujdestari merr të gjitha masat për ruajtjen e aktiveve të bankës duke ndërmarrë të paktën veprimet e mëposhtme:
- ndryshon rregullin e hyrjes në ndërtesat e bankës dhe në ambientet ku ruhen pasuritë e bankës, dokumentacioni, informacioni, pajisjet etj., aksesi në të cilat do të dëmtojnë interesat pasurorë të bankës, nëpërmjet zëvendësimit të pajisjeve të kyçit (locking devices) dhe të kufizimit të rrethit të personave që kanë të drejtë të hyjnë në këto ambiente;
 - ndryshon ose krijon password-e të reja për hyrjet në kompjuterat e bankës, duke lejuar hyrjen vetëm të një numri të kufizuar të punonjësve të besuar;
 - lëshon tipe të reja të kartave të kalimit për hyrjet në ambientet e bankës për punonjësit e autorizuar dhe kontrollon hyrjet e punonjësve të tjerë në këto ambiente;
 - pezullon kompetencat e personave, të cilët mund të kryejnë aktivitete në emër dhe për llogari të bankës dhe autorizon një numër të caktuar punonjësish; për këto ndryshime njofton palët e treta;
 - informon bankat korrespondente, regjistrat dhe agjentët e letrave me vlerë dhe personat që administrojnë aktivet në emër të bankës në kujdestari, se të gjitha autorizimet e dhëna nga banka deri në emërimin e tyre janë pezulluar, dhe autorizimet do t'i jepen një numri të kufizuar personash, për emrat e të cilëve ata do të informohen;
 - ndalon pagesën e dividendëve ose të një forme tjetër të shpërndarjes së kapitalit për aksionerët, si dhe pagesën e administratorëve, përveç shpërblimit për shërbimet që ata kanë bërë në bankë.

10. Kujdestari ka për detyrë:

- a. të organizojë punën për kthimin në gjendje normale të bankës. Për këtë qëllim ai:
 - bën riklasifikimin e cilësisë së aktiveve,
 - e përqendron aktivitetin e bankës në veprimtari pa rrezik (blerje bonosh thesari ose letra të tjera me vlerë me rrezik zero), vendosje në banka të vlerësuara shkëlqyeshëm ose shumë mirë nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut dhe të tjera veprimtari të ngjashme me këto,
 - evidenton pjesën e aktiveve të këqija (nonperforming asstets) dhe brenda tyre të kredive me probleme dhe merr masa për rimbursimin ligjor të tyre;
- b. të hartojë një plan për rikapitalizimin e bankës pas veçimit të aktiveve të këqija dhe t'ia paraqesë autoritetit mbikëqyrës;
- c. të negociojë bashkë me aksionerët për mundësinë e shkrirjes së bankës me një bankë tjetër ose shitjen e bankës së rikapitalizuar;
- d. në pamundësi për realizimin e pikave a, c, t'i propozojë Bankës së Shqipërisë fillimin e procedurave të likuidimit.

11. Gjatë periudhës në të cilën banka është vendosur në kujdestari, të gjitha transaksionet e kryera nga banka pa autorizimin përkatës të kujdestarit të emëruar, nuk do të kenë vlefshmëri ligjore.

12. Kujdestaria përfundon me mbarimin e afatit prej 12 muajsh nga data e përcaktuar në aktin e vendosjes së kujdestarisë, si dhe:

- kur Guvernatori i Bankës së Shqipërisë vendos për përfundimin e kujdestarisë sepse, sipas rekomandimeve të grupit mbikëqyrës, banka mund të ushtrojë veprimtarinë e saj normalisht ose ;
- kur Këshilli Mbikëqyrës vendos për likuidimin e bankës, nëpërmjet revokimit të licencës.

Likuidimi

13. Këshilli Mbikëqyrës vendos për vënien në likuidim si dhe për revokimin e licencës së bankës kur konstatohen një apo më shumë nga rrethanat e mëposhtme:

- gjykata ka marrë vendimin për likuidimin e shoqërisë kur është ngritur padi nga kreditorë të bankës, në rastin e përcaktuar në nenin 51 (c) të ligjit për bankat (likuidimi i detyruar);

- vendos Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në rastet e përcaktuara në nenet 44/2/g dhe 51/1 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (likuidim i detyruar).
14. Likuidatori i emëruar ndjek këta hapa :
- a) realizon vlerësimin e bankës nga një ekspert kontabël i autorizuar, i miratuar edhe nga Banka e Shqipërisë;
 - b) harton programin për zbatimin e procesit të likuidimit të bankës.
15. Likuidatori, brenda 30 ditëve nga data e emërimit, merr në dorëzim të gjithë inventarin e aktiveve dhe të pasurive të bankës si dhe të gjithë dokumentacionin e arkivës së bankës dhe ia përcjell një kopje Bankës së Shqipërisë. Dorëzimi i tyre do të bëhet me procesverbal të nënshkruar nga personat përgjegjës, nga administratorët dhe nga nëpunësit e pezulluar të bankës, dhe likuidatori.
16. Menjëherë sapo bëhet emërimi i tij, likuidatori merr të gjitha masat për ruajtjen e aktiveve të bankës duke ndërmarrë të paktën veprimet e mëposhtme:
- ndryshon rregullin e hyrjes në ndërtesat e bankës dhe në ambientet ku ruhen pasuritë e bankës, dokumentacioni, informacioni, pajisjet etj., aksesi në të cilat do të dëmtojë interesat pasurorë të bankës, nëpërmjet zëvendësimit të pajisjeve të kyçit (locking devices) dhe kufizimit të rrethit të personave që kanë të drejtë të hyjnë në këto ambiente;
 - ndryshon ose krijon password-e të reja për hyrjet në kompjuterat e bankës, duke lejuar hyrjen vetëm të një numri të kufizuar të punonjësve të besuar;
 - lëshon tipe të reja të kartave të kalimit për hyrjet në ambientet e bankës për punonjësit e autorizuar dhe kontrollon hyrjet e punonjësve të tjerë në këto ambiente;
 - pezullon nga kompetencat personat, të cilët mund të kryejnë aktivitete në emër dhe për llogari të bankës dhe autorizon një numër të caktuar punonjësish; për këto ndryshime njofton palët e treta;
 - informon bankat korrespondente, regjistrat dhe agjentët e letrave me vlerë dhe personat që administrojnë aktivet në emër të bankës në likuidim, se të gjitha autorizimet e dhëna nga banka deri në emërimin e tyre janë pezulluar, dhe autorizimet do t'i jepen një numri të kufizuar personash, për emrat e të cilëve ata do të informohen;
 - ndalon pagesën e dividendëve ose të një forme tjetër të shpërndarjes së kapitalit për aksionerët, si dhe pagesën e administratorëve, përveç shpërblyerjes për shërbimet që ata kanë bërë në bankë;
 - vendos në ambientet e bankës shënimin "në likuidim".
17. Likuidatori në procesin e likuidimit të bankës ka për detyrë:
- të sigurojë shitjen e aktiveve të bankës me çmimin më të lartë të mundshëm nëpërmjet procedurave të ankandit dhe të tenderimit;
 - të sigurojë një trajtim të barabartë të kreditorëve me të njëjtat kushte, rezidentë dhe jorezidentë;
 - të mos lejojë pagimin e parakohshëm të kreditorëve të veçantë;
 - të sigurojë procedura transparente për grumbullimin dhe për shpërndarjen e informacionit;
 - të njohë të drejtat e kreditorëve ekzistues dhe të respektojë rradhën sipas përparësisë;
 - të hartojë procedura për paaftësinë paguese jashtë kufijve dhe të njohë procedurat e vendit të huaj;
 - të sigurojë likuidimin eficient dhe të shpejtë të bankës, duke siguruar mbulimin maksimal të detyrimeve të kreditorëve.
18. Likuidatori ka autoritet të plotë për administrimin, për drejtimin dhe për kontrollin e bankës.
19. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, në zbatim të kërkesave të nenit 55, pika 1 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", jep miratimin ose refuzon kërkesën e likuidatorit për:

- 19.1. shitjen e çdo aktivi të bankës mbi 1 për qind të totalit të aktiveve;
 - 19.2. vendosjen e masës së sigurisë, si mjet për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit për çdo aktiv të bankës në favor të kreditorit, i cili ka dhënë një kredi të re për subjektin në vlerën që kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
 - 19.3. ristrukturimin e çdo detyrimi të pretenduar në rast se vlera e tij kalon shumën 50 milionë lekë;
 - 19.4. faljen e çdo detyrimi të pretenduar në rast se vlera e tij kalon shumën 5 milionë lekë, sipas kriterëve të përcaktuara nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;
 - 19.5. pagesën e çdo detyrimi të pretenduar në të cilin depozituesit dhe kreditorët në pozita të barabarta duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë.
20. Likuidatori, pas 1 muaji nga data e shpalljes së likuidimit, paraqet një program veprimesh për procesin e likuidimit dhe të paktën çdo muaj raporton në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, për realizimin e tij ose parashtron propozimet për ndryshimet përkatëse, të argumentuara.
21. Likuidatori raporton çdo muaj në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, pasqyrën e aktiveve dhe të pasiveve dhe pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, brenda 10 ditëve nga mbyllja e muajit. Këto raporte përmbajnë informacionin mbi veprimet që kryen likuidatori, totalin e shumës së detyrimeve të pretenduar ndaj bankës, totalin e shumës së aktiveve të bankës që janë shitur dhe parashikimin e të ardhurave nga shitja e aktiveve.

Administrimi i përkohshëm

22. Në zbatim të nenit 44, pika 2/f, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Guvernatori i Bankës së Shqipërisë mund të vendosë, që një nga drejtuesit e Bankës së Shqipërisë të marrë në administrim e kontroll të përkohshëm bankën, sipas modaliteteve të parashikuara në këtë udhëzim, për kujdestarinë. Administrimi i përkohshëm sipas këtij neni nuk mund të ketë një kohëzgjatje më shumë se 12 muaj. Në përfundim të administrimit të përkohshëm, administratorët e rinj të bankës marrin në dorëzim bankën.

Grupi mbikëqyrës

23. Në rastet kur vërtetohen një ose më shumë rrethana, të përcaktuara në nenin 48 dhe/ose në nenin 51, paragrafi 1, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", krijohet grupi mbikëqyrës me një urdhër të posaçëm të Guvernatorit, grup i cili do të veprojë në përputhje me aneksin 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.
24. Grupi mbikëqyrës krijohet për mbikëqyrjen gjatë procesit të kujdestarisë të bankës dhe/ose për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave të likuidimit të bankës. Grupi mbikëqyrës përbëhet nga jo më pak se 5 punonjës të Bankës së Shqipërisë, mbikëqyrës, juristë dhe punonjës nga departamentet e tjera të Bankës së Shqipërisë. Ky grup krijohet rast pas rasti, nuk është i përhershëm dhe kryesohet nga Zëvendësdrejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes.
25. Grupi mbikëqyrës, në bashkëpunim me Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun të Bankës së Shqipërisë, përgatit një njoftim për shtyp, ku njofton vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës dhe për fillimin e procedurave të likuidimit të bankës përkatëse. Nëpërmjet tij ka për qëllim :
- të sigurojë depozituesit që paratë e tyre në bankë do të administrohen me paanshmëri;
 - të ruajë që të mos dëmtohet besueshmëria ndaj sistemit bankar në tërësi;
 - të sigurojë publikun se procesi i likuidimit do të mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme nga Banka e Shqipërisë.
26. Grupi mbikëqyrës funksionon deri në përfundimin e procesit (kujdestarisë ose likuidimit të bankës).
27. Grupi mbikëqyrës, mbështetur në informacionin e siguruar, përgatit një material lidhur me situatën e bankës, të cilin e paraqet në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me rekomandimet përkatëse. Grupi mbikëqyrës informon çdo muaj, brenda periudhës për të

cilën është krijuar, administratorët e Bankës së Shqipërisë për ecurinë e bankës në administrim ose për ecurinë e procesit të likuidimit të saj. Për raste të veçanta, kur gjykohet e domosdoshme, grupi mbikëqyrës raporton, më shpesh se çdo muaj, tek administratorët e Bankës së Shqipërisë.

Të përbashkëta

28. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë zgjedh dhe emëron kujdestarin dhe likuidatorin. Kandidati për kujdestar ose për likuidator duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
- a) të ketë reputacion të mirë;
 - b) të ketë eksperiencë në një nga këta sektorë: bankar, kreditues, financiar, të pasurive të paluajtshme dhe të institucioneve financiare të sigurimeve, me një përgjegjësi të tillë, që ndihmon në drejtimin e bankës, për një periudhë jo më pak se pesë vjet;
 - c) të ketë diplomën e arsimit të lartë, si rregull, në ekonomi apo në jurisprudencë;
 - d) të deklarojë se nuk ka asnjë nga ndalesat e përcaktuara në nenin 62, pika 2 e ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
 - e) të deklarojë se nuk ka konflikte të interesave me bankën sipas pikave 4 dhe 5 të nenit 62.
29. Dokumentacioni i kërkuar për miratimin e kujdestarit apo të likuidatorit:
- a) një kopje e notuar e diplomës së arsimit të lartë;
 - b) cv-ja e firmosur ku të përfshihen: të dhëna të përgjithshme; vendqëndrimi dhe vendbanimi (adresat respektive); arsimiti i kryer; kualifikimet e kryera; eksperiencia profesionale dhe përshkrimi i detajuar i pozicioneve që ka mbajtur administratori i propozuar; gjuhët e huaja të njohura dhe shkalla e njohjes;
 - c) dokumenti i lejes së qëndrimit të përhershëm për persona të huaj;
 - d) dy rekomandime nga drejtues të bankave ose të subjekteve të tjera në të cilat, personi kandidat ka qenë në marrëdhënie pune, ku të përfshihen vlerësime për aftësinë profesionale, për korrektësinë dhe për vendosmërinë në zbatimin e ligjeve;
 - e) dëshmi penaliteti e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe vërtetime nga gjykata dhe prokuroria për mosndjekje penale, ose ndërkohë të jetë hapur një proces gjyqësor ose procedim penal sipas ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 për "Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë" dhe sipas ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 për "Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë"; për personat e huaj dëshmia e penalitetit duhet të jetë lëshuar nga vendi i origjinës;
 - f) deklarata në lidhje me pagimin e tatim-taksave personale dhe të tatim-taksave nga biznesi në të cilin ai ka një pjesëmarrje influencuese për një periudhë trevjeçare (në qoftë se ka);
 - g) deklaratë personale që të vërtetojë se gjatë aktivitetit të punës së tij nuk ka kryer veprimtari, që bien në kundërshtim me rastet e parashikuara në nenin 21, pika 2 dhe të ndalimeve të përmendura në pikën 1, geramat "a", "b" dhe "c" të nenit 6, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
30. Banka e Shqipërisë, me urdhër të Guvernatorit mund të revokojë ose të zëvendësojë kujdestarin ose likuidatorin.
31. Banka e Shqipërisë, me urdhër të Guvernatorit deri në zgjedhjen dhe emërimin e kujdestarit, mund të emërojë kujdestar të përkohshëm një funksionar të vetin, i cili merr kompetencat dhe detyrat që i atribuohen kujdestarit në bazë të ligjit dhe të udhëzimit.
32. Shpërblimi për administratorin e përkohshëm, për kujdestarin dhe për likuidatorin do të jetë në ngarkim të bankës që i nënshtrohet administrimit të përkohshëm, kujdestarisë ose likuidimit. Shpërblimi i administratorit të përkohshëm, i kujdestarit ose i likuidatorit është i barabartë me pagën e drejtorit të përgjithshëm, sipas strukturës së pagave të bankës që kalon në administrim të përkohshëm, në kujdestari ose në likuidim.

Kontabiliteti i likuidimit

33. Me qëllim që të sigurohet mbrojtja e interesave të të tretëve, depozituesve e kreditorëve, dhe interesat e aksionerëve, likuidatori është i detyruar të organizojë dokumentimin dhe regjistrimin e operacioneve të likuidimit si dhe të përgatisë bilancin, llogarinë e rezultatit, pasqyrat financiare

etj.. Këto dokumente i nënshtrohen kontrollit të ekspertit kontabël të autorizuar.

34. Detyrimet kontabël të dalluara sipas fazave të ndryshme të likuidimit janë:

1. Hapja e likuidimit.

Inventarizimi. Me emërimin e tij likuidatori harton detyrimisht një inventar të vlerave aktive dhe pasive të bankës. Me këtë rast, ai merr në dorëzim librat dhe dokumentet e bankës. Inventari kryhet në formën e zakonshme duke u nisur nga bilanci i llogarive të bankës. Pas kryerjes së inventarit dhe të regjistrimeve që rezultojnë prej tij, hartohet bilanci i likuidimit, i cili do të shërbejë si pikënisje për operacionet e likuidimit.

Raportimi. Likuidatori është i detyruar që, brenda 6 muajve nga emërimi i tij, të thërrasë asamblenë e aksionerëve. Ai i paraqet asamblesë një raport mbi gjendjen e vlerave aktive dhe pasive të bankës, mbi ecurinë e operacioneve të likuidimit dhe një plan të hollësishëm mbi procesin e likuidimit. Bilanci i likuidimit nuk i nënshtrohet miratimit të asamblesë së aksionerëve.

2. Operacionet e likuidimit dhe llogaritë vjetore.

Brenda tre muajve nga përfundimi i periudhës ushtrimore, likuidatori duhet të përgatisë llogaritë vjetore në bazë të inventarit që ai kryen për elemente të ndryshme të aktivitetit dhe pasivitetit. Ai përgatit, gjithashtu, një raport të shkruar me të cilin jep llogari për operacionet e likuidimit gjatë ushtrimit të mbyllur.

Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e zakonshme të parashikuara nga ligji nr. 7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin".

Llogaritë vjetore kontrollohen dhe vërtetohen nga eksperti kontabël i autorizuar.

3. Mbyllja e likuidimit.

Kur operacionet e likuidimit kanë përfunduar, likuidatori përgatit llogarinë përfundimtare si dhe një raport me shkrim. Kjo llogari përfundimtare kontrollohet nga eksperti kontabël i autorizuar.

35. Regjistrimet kontabël të likuidimit lidhen kryesisht me operacionet që vijojnë:

- arkëtimi i debitorëve të bankës;
- realizimi i elementeve të aktivitetit;
- pagimi i kreditorëve të bankës;
- shpenzimet për likuidimin;
- përcaktimi i rezultatit të likuidimit;
- përgatitja e llogarisë përfundimtare të likuidimit.

Të gjitha operacionet e likuidimit dokumentohen sipas rregullave të përgjithshëm. Regjistrimi i tyre bëhet në llogaritë e mbajtura nga banka në përputhje me "Manualin e kontabilitetit bankar". Veçoria në këtë proces qëndron në çeljen e disa llogarive të posaçme, të cilat do të shërbejnë për të përcaktuar rezultatit të likuidimit, sipas aneksit 2.

Dispozita të fundit

36. Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

ANEKSI 1.

VEPRIMET QË KRYHEN PËR KUJDESTARINË DHE LIKUIDIMIN

1. Organizohet një takim i Zëvendësguvernatorit që mbulon Departamentin e Mbikëqyrjes me Drejtorin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Përgjegjës të Sektorit të Inspektimit, inspektorin dhe analistin, që janë përgjegjës për bankën, përgjegjës të grupit të inspektimit të fundit dhe me përfaqësues të Sektorit Juridik, për të diskutuar rreth situatës së bankës.
2. Mbi bazën e konkluzioneve të nxjerra nga takimi, përgatitet një memorandum ku përmbledhet situata e bankës dhe arsyet pse kërkohet kujdestaria apo likuidimi.
3. Juristët duhet të japin opinionin e tyre nëse situata e bankës është një nga rastet e përcaktuara në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
4. Grupi mbikëqyrës, përgatit materialin përmbledhës për gjendjen financiare të bankës së nivelit të dytë dhe e paraqet këtë material në Këshillin Mbikëqyrës për marrjen e vendimit të kujdestarisë apo të likuidimit.
5. Grupi mbikëqyrës i propozon Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë jo më pak se 3 kandidatura për emërimin e kujdestarit ose të likuidatorit dhe masën e shpërblimit të tij.
6. Në rast të procesit të likuidimit të bankës, pas marrjes së vendimit përkatës nga Këshilli Mbikëqyrës për revokimin e licencës, Banka e Shqipërisë (Sektori Juridik) përgatit kërkesën për gjykatën për çregjistrimin e bankës nga Regjistri i Shoqërive Tregtare
7. Me marrjen e vendimit të revokimit të licencës nga Këshilli Mbikëqyrës, Përgjegjësi i Inspektimeve, pasi vë në dijeni edhe aksionerët e bankës, shkon në bankë dhe merr dokumentin e licencës.

ANEKSI 2

Llogaritë e rezultatit të likuidimit analizohen si më poshtë:

664	Shpenzime dhe humbje nga likuidimi.
6641	Humbje nga aktivet e pashitshme.
6642	Vlera kontabël e aktiveve të qëndrueshme të shitura (klasa 5).
6643	Vlera kontabël e aktiveve të tjera të shitura (klasat 1,2,3).
6644	Humbje nga diferencat në llogaritë me të tretët (klasa 4).
6645	Nxjerrje jashtë përdorimit.
6646	Shpenzime dhe humbje të tjera nga likuidimi.
764	Të ardhura dhe fitime nga likuidimi.
7640	Të ardhura nga shitja e aktiveve.
7641	Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme (klasa 5).
7642	Të ardhura nga shitja e aktiveve të tjera (klasat 1,2,3).
7643	Fitime nga diferencat e llogarive me të tretët (klasa 4).
7644	Të ardhura e fitime të tjera nga likuidimi.
7645	Rimarrje e shumave të parashikuara.

Kryerja e regjistrimeve.

6641 "Humbje nga aktivet e pashitshme". Këto janë aktive që kanë natyrë shpenzimi siç janë ato të nisjes e të zgjerimit, të kërkimeve të aplikuara e të zhvillimeve, shpenzimet e parapaguara, shpenzimet për t'u shpërndarë në disa ushtrime. Në rastin e likuidimit shumat e paamortizuara të këtyre elementeve duhet të kalojnë menjëherë në rezultat, me regjistrimin:

6641 Humbje nga aktivet e pashitshme
te
5313 Shpenzime të nisjes e të zgjerimit.
5311 Shpenzime të kërkimeve e zhvillimeve.
4193 Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime.

Aktivet e bankës mund të shiten element për element, në grupe ose bashkërisht. Vlerat sipas çmimeve do të regjistrohen:

111 Arka.

13 (Llogaritë rrjedhëse në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare rezidente e jorezidente.)

te

7641 Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme.

7642 Të ardhura nga shitja e aktiveve të tjera.

Në rast të pamundësisë ose të vështirësive për ndarjen e të ardhurave veças për aktivet e qëndrueshme dhe veças për aktivet e tjera, ato mund të regjistrohen bashkërisht në llogarinë 7640 "Të ardhura nga shitja e aktiveve".

Shkarkimi i vlerave kontabël të elementeve të aktiveve të shitura do të kryhet me regjistrimin:

6642 Vlera kontabël e aktiveve të qëndrueshme të shitura.

te

Llogaritë përkatëse të klasës 5.

Në regjistrimin për shkarkimin nga llogaritë të vlerave kontabël do të merren parasysh shumat e amortizimeve të aktiveve të qëndrueshme që figurojnë në llogaritë 537.

Shpenzimet e likuidimit, që lidhen me çdo shpenzim që kryhet për likuidimin e bankës, do të regjistrohen në debi të llogarisë 6646 "Shpenzime dhe humbje të tjera nga likuidimi" dhe në kredi të llogarive përkatëse në varësi nga natyra e shpenzimit.

Nxjerrjet jashtë përdorimit lidhen me ato elemente të aktivitetit që nuk kanë vlera përdorimi apo, që megjithë përpjekjet e bëra janë kthyer në të pashitshme. Vlera kontabël e këtyre elementeve do të regjistrohet në debi të llogarisë 6645 "Nxjerrje jashtë përdorimit" dhe në kredi të llogarive përkatëse të klasës 5. Për shkarkimin nga llogaria të vlerës kontabël të këtyre elementeve do të vlejnjë shpjegimet e dhëna më lart për aktivet e shitura.

Rimarrja e shumave të parashikuara për zhvlerësime dhe për rreziqe e shpenzime ka të bëjë me rikthimin e tyre në rezultat. Këto shuma, regjistrohen në debi të llogarive përkatëse të klasës 5 dhe në kredi të llogarisë 7645 "Rimarrje e shumave të parashikuara".

Arkëtimi i debitorëve dhe shlyerja e kreditorëve kryhet sipas rregullit të zakonshëm. Çdo diferencë nga llogaria me të tretët do të kalojë sipas rastit në debi të llogarisë 6644 "Humbje nga diferencat në llogaritë me të tretët" dhe në kredi të llogarisë 7643 "Fitime nga diferencat e llogarive me të tretët".

Llogaria përfundimtare e likuidimit paraqitet në formën e një bilanci. Në aktiv të bilancit paraqiten shumat e likuiditeteve në llogaritë në bankë dhe në arkë, kurse në pasiv paraqiten kapitali e rezervat e bankës dhe rezultati i likuidimit.

Rezultati i likuidimit përcaktohet si diferencë midis totalit të shumave të regjistruara në kredi të llogarive 7641-7645 dhe totalit të shumave të regjistruara në debi të llogarive 6641-6646.

Në qoftë se banka nuk ka mundur që me të ardhurat nga shitja e aktiveve të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve, atëherë paraqitet një situatë likuidimi negative. Në këtë situatë, në aktiv të bilancit të likuidimit nuk paraqitet asnjë vlerë. Normalisht, rezultati i likuidimit (humbja) është i barabartë me shumën e kapitalit plus rezervat dhe kështu tërësia e kapitaleve të veta rezulton zero.

Të gjitha vlerësimet kontabël lidhur me nxjerrjen e rezultatit të likuidimit do të bëhen në përputhje me udhëzimin nr. 9, kapitulli IV, datë 06.05.1994 të Ministrisë së Financave "Për likuidimin e ndërmarrjes".

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

NR. 58, DATË 24. 07. 2002

**PËR
MIRATIMIN E NJË VEPRIMTARIE SHITESË NË
VEPRIMTARINË BANKARE**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 43, shkronja " e " të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe në bazë të nenit 26, pika 3, shkronja "gj" e ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I :

1. Bankave të licencuara nga Banka e Shqipërisë u lejohet të kryejnë edhe veprimtari bankare, që lidhet me metalet e çmuara.
1. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e bankave të nivelit të dytë.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve dhe Politikave Monetare me publikimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI
Ylli Memisha

KRYETARI
Shkëlqim Cani

UDHËZIMI

PËR

RAPORTIMIN E VEPRIMEVE TË KËMBIMEVE VALUTORE

Në zbatim të nenit 10 të rregullores "Për veprimtarinë valutore", miratuar me vendimin nr.64, datë 30.07.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bankat, degët e bankave të huaja dhe zyrat e këmbimeve valutore, raportojnë mbi veprimtarinë e tyre valutore pranë Bankës së Shqipërisë, **Departamenti i Operacioneve Monetare** si më poshtë:

Raportimi ditor.

Raportimi ditor bëhet çdo ditë brenda orës 15.00.

Në të përfshihen të gjitha veprimet, që kryhen brenda 24 orëve të fundit.

Bankat përfshijnë, në këtë raportim të gjitha veprimet e kryera në drejtoritë qendrore dhe në degët e tyre në Tiranë.

Raportimet pasqyrohen sipas formularëve bashkëlidhur.

Raportimet do të bëhen në adresën :

Banka e Shqipërisë
Departamenti i Operacioneve Monetare
Sheshi "Skënderbej" Nr.1
Tiranë.

2. Ky udhëzim u miratua me vendimin nr.69, datë 30.07.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Buletimin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

RAPORTIMI DITOR I VEPRIMEVE TË KËMBIMEVE VALUTORE

FORMULARI Nr. 1

BANKA / ZYRA E KËMBIMIT VALUTOR

DATA

KËMBIMI I VALUTAVE KUNDREJT LEKUT

NR. (1)	MONEDHA (2)	BLERJET E VALUTAVE (3)	KURSI MESATAR (4)	SHITJET E VALUTAVE (5)
1. 2. 3.	Euro Usd Metale të çmuara etj.			
Totali i pozicionit valutor në lekë – (teprica në kolonën 7 për çdo përkatës të këmbimit).				

Sqarime të detyrueshme: Veprime me : Blerje valute (në lekë) Shitje valute (në lekë)

Bankat
Zyrat e këmbimit valutor
Të tjera
Totali
Sqarime të detyrueshme :

Nënshkrimi _____

RAPORTIMI DITOR I VEPRIMEVE TË KËMBIMEVE VALUTORE

FORMULARI Nr. 2

BANKA / ZYRA E KËMBIMIT VALUTOR

DATA

KËMBIMI I VALUTAVE KUNDREJT VALUTAVE

Nr. (1)	MONEDHA (2)	BLERJET E VALUTAVE (3)	SHITJET E VALUTAVE (4)
1.	Euro		
2.	Usd		
3.	Metale të çmuara		
	etj.		
Totali : Usd ose Euro (zgjidh)			

Sqarime të detyrueshme: Veprime me : Blerje valute (usd ose euro) Shitje valute (usd ose euro)

Bankat
Zyrat e këmbimit valutor
Të tjera
Totali
Sqarime të detyrueshme :

Nënshkrimi _____

RREGULLORE

PËR LICENCIMIN E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE

Miratuar me vendim nr. 11, datë 27.02.2002, ndryshuar me vendimin nr. 09, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1.1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre.
- 1.2¹. Në këtë rregullore përcaktohen afatet, procedurat, kushtet për miratimin ose për refuzimin e dhënies së licencës, për pezullimin ose për revokimin e saj për kryerjen e veprimtarive të përcaktuara, në ligjin nr. 8782, datë 03.05.2001 "Për shoqëritë e kursim-kreditit", kreu i dytë "Veprimtaritë", nenet 9, 10, 11 dhe 20 për transformimin nga njëra formë në tjetrën në përputhje me kreun e pestë "Organet e shoqërive të kursim-kreditit".
- 1.3². Baza ligjore e saj janë ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"; ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" neni 12; ligji nr. 8782, datë 03.05.2001 "Për shoqëritë e kursim-kreditit" nenet 20, 45, 46, 47.
- 1.4. Në zbatim të kësaj rregulloreje, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, për thjeshtësi, do të quhen "shoqëri". Termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 8782, datë 03.05.2001 "Për shoqëritë e kursim-kreditit", neni 3 dhe në ligjin nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 2.

LICENCIMI

Neni 2

Kërkesa për marrjen e licencës

Kërkesa për marrjen e licencës nga një shoqëri, bëhet në Bankën e Shqipërisë. Kryetari i bordit drejtues plotëson kërkesën, sipas formularit nr. 1, tabela 1/1, e cila shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- 2.1. Deklarata e angazhimit për të respektuar, gjatë veprimtarisë, legjislacionin shqiptar dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, e firmosur nga kryetari i bordit drejtues, sipas formularit nr. 1, tabela 1/2.
- 2.2. Vendimi i regjistrimit në Gjykatën e Shkallës Parë, Tiranë.
- 2.3. Dokumentacioni i plotë i paraqitur për regjistrim në gjykatë.
- 2.4. Të dhëna për anëtarët e bordit drejtues dhe të komitetit të mbikëqyrjes, sipas formularit nr. 1, tabela 1/6.
- 2.5. Dëshmia e penalitetit për kryetarin e bordit drejtues dhe për kryetarin e komitetit të mbikëqyrjes, që vërteton se janë të padënuar nga gjykata.
- 2.6. Emrat e personave juridikë si anëtarë.
- 2.6. Parashikimi për ecurinë e numrit të anëtarëve, të kontributeve, të depozitave, të kredive në dy vitet e ardhme, bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas formularit nr. 1, tabelat 1/3, 1/4, 1/5.
- 2.7. Dokumentacioni të jetë në gjuhën shqipe, në dy kopje, në origjinal ose fotokopje e notuar.

Neni 3

Miratimi ose refuzimi i kërkesës për licencë

- 3.1. Departamenti i Mbikëqyrjes verifikon plotësimin e dokumenteve dhe paraqitjen e tyre në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

² Ndryshuar me vendimin nr.09, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

³ Ndryshuar me vendimin nr.09, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

- 3.2. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe nuk plotëson kërkesat që përmbahen në këtë rregullore, Departamenti i Mbikëqyrjes njofton me shkrim shoqërinë në lidhje me mangësitë, papajtueshmërinë me ligjin apo për informacione shtesë.
- 3.3. Mangësitë e gjetura dhe vërejtjet e bëra në lidhje me dokumentacionin e paraqitur, sipas kërkesave të rregullores, mënjahen brenda një muaji nga dita e marrjes së njoftimit në lidhje me të. Në rast të kundërt, dokumentacioni i paraqitur i kthehet përsëri kërkuarit.
- 3.4. Data për pranimin e kërkesës për licencë konsiderohet data kur kërkuari ka plotësuar kërkesat e rregullores. Kërkuari njoftohet me shkrim për këtë datë nga Departamenti i Mbikëqyrjes.
- 3.5. Banka e Shqipërisë miraton ose refuzon kërkesën për licencë brenda 30 ditëve nga dita që kërkuari njoftohet me shkrim nga Departamenti i Mbikëqyrjes. Vendimi merret nga administratorët e Bankës së Shqipërisë. Departamenti i Mbikëqyrjes për vendimin e marrë, njofton me shkrim kërkuarin, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit përkatës. Në rast refuzimi njoftimi i dhënë shoqërohet me arsyet përkatëse.
- 3.6. Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë mund të kryejë një verifikim në vend për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur.
- 3.7. Banka e Shqipërisë gëzon të drejtën të përcaktojë edhe ndonjë kërkesë shtesë.
- 3.8. Shoqëria, pasi ka marrë licencën, respekton në çdo kohë të gjitha aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrjen dhe për raportimin e veprimtarisë së saj.

Neni 4

Publikimi dhe regjistrimi

- 4.1. Dhënia e licencës për subjektet e kësaj rregulloreje publikohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në njërën nga gazetatat me tirazh më të madh.
- 4.2. Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë mban një regjistër të disponueshëm për përdorim publik, ku regjistrohen të gjitha licencat e dhëna. Faqet e këtij regjistri janë me numër dhe me vullë.
- 4.3. Ky regjistër përmban emrin e shoqërisë, adresën e zyrës qendrore, emrat dhe adresat e anëtarëve të bordit drejtues dhe të komitetit të mbikëqyrjes.
- 4.4. Një kopje e këtij regjistri të mbahet për përdorim publik në përfaqësitë rajonale të Bankës së Shqipërisë.

Neni 5

Pezullimi, revokimi i licencës

Administratorët e Bankës së Shqipërisë vendosin për pezullimin ose për revokimin e licencës kur vërejnë se :

- 5.1. Licenca është siguruar në bazë të të dhënave joreale, pavarësisht nëse është dhënë nga kërkuari apo për kërkuarin, që lidhen me plotësimin e kërkesave të mësipërme të nenit 2 dhe të nenit 3, pika 3.7.
- 5.2. Shoqëria nuk e ka filluar veprimtarinë e saj ose e ka ndërprerë atë për më shumë se gjashtë muaj.
- 5.3. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë vendos shpërndarjen dhe likuidimin e shoqërisë.
- 5.4. Shoqëria kryen veprimtarinë në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.
- 5.5. Shoqëria nuk respekton në vazhdimësi rregulloret e Bankës së Shqipërisë.
- 5.6. Treguesit e gjendjes financiare të shoqërisë janë në përkeqësim.

Vendimi për pezullimin ose për revokimin e licencës i komunikohet menjëherë shoqërisë bashkë me arsyet për marrjen e tij.

Vendimi për pezullimin ose për revokimin e licencës publikohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në një nga gazetatat me tirazh më të madh. Vendimi hyn në fuqi ditën kur caktohet nga Banka e Shqipërisë dhe për një kohëzgjatje (në rastin e pezullimit) të përcaktuar prej saj.

Shoqëria ndalohet të kryejë veprimtaritë e parashikuara në nenet 9, 10, 11 të ligjit nr. 8782, datë 03.05.01 "Për shoqëritë e kursim-kreditit" gjatë periudhës së pezullimit ose të revokimit të licencës së saj, menjëherë pas njoftimit zyrtar të vendimit të Bankës së Shqipërisë për ta revokuar licencën.

Neni 6

Dispozita përfundimtare

- 6.1. Shoqëritë e kursim-kreditit, të krijuara dhe të anëtarësuara në një union të licencuar, përfaqësohen nga unioni në procesin e plotësimit dhe të paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e licencës nga Banka e Shqipërisë. Në këtë rast, dokumentacioni përmban :
- Listën e shoqërive të kursim-kreditit, anëtare të unionit.
 - Kërkesën për licencë, të firmosur nga kryetari i bordit drejtues të shoqërisë së kursim-kreditit dhe kryetari i bordit drejtues të unionit, sipas formularit nr.2, tabela 2/1.
 - Deklaratën e angazhimit, të firmosur nga kryetari i bordit drejtues të shoqërisë së kursim-kreditit, sipas formularit nr.2, tabela 2/2.
 - Të dhënat e regjistrimit të shoqërisë së kursim-kreditit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë (data e vendimit, numri i protokollit të vendimit).
 - Formularin nr. 2, tabela 2/3, të plotësuar për çdo anëtar të unionit, të firmosur nga kryetari i bordit drejtues të shoqërisë së kursim-kreditit dhe kryetari i bordit drejtues të unionit.
 - Të dhëna për anëtarët e bordit drejtues dhe të komitetit të mbikëqyrjes, sipas formularit nr. 2, tabela 2/4.
- 6.2. Unioni është i detyruar të njoftojë Bankën e Shqipërisë në rast se një ose disa anëtarë largohen prej tij.

Neni 7

Dispozita kalimtare

- 7.1. Të gjitha shoqëritë që janë krijuar dhe kryejnë veprimtari përpara miratimit të rregullores së licencimit janë të detyruara të bëjnë kërkesë dhe të plotësojnë dokumentacionin përkatës, jo më vonë se 90 ditë, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
- 7.2. Deri në marrjen e vendimit nga Banka e Shqipërisë për miratimin ose për refuzimin e kërkesës për licencë shoqëria vazhdon veprimtarinë e saj. Në rast se edhe pas 6 muajsh të kërkesës për licencë, vendimi për miratimin ose për refuzimin e kërkesës për licencë nuk është marrë, atëherë Departamenti i Mbikëqyrjes përgatit një informacion për administratorët e Bankës së Shqipërisë, ku shpjegon arsyet e vonësës. Në bazë të këtij informacioni, administratorët marrin një vendim për vazhdimin ose jo të veprimtarisë së shoqërisë duke vënë dhe afate kohore për zbatimin e këtij vendimi.
- 7.3. Shoqëria likuidohet në rast të refuzimit të kërkesës për marrjen e licencës, në rast të mbarimit të afatit të vendosur në pikën 7.1. dhe në rast se shoqërisë i hiqet e drejta e vazhdimit të veprimtarisë sipas pikës 7.2.
- 7.4. Në dokumentacionin e paraqitur, sipas nenit 2 të rregullores, formulari 1, tabelat 1/2, 1/3, 1/4, 1/5, 1/6 plotësohen me të dhënat më të fundit.
- 7.5. Të gjitha unionet që janë krijuar dhe kryejnë veprimtari përpara miratimit të rregullores së licencimit, pas plotësimit të kërkesave të pikave të mësipërme :
- përfaqësojnë shoqëritë e kursim-kreditit, anëtare të unionit në procesin e plotësimit të kërkesës për marrjen e licencës në Bankën e Shqipërisë, sipas pikës 6.1. Unioni merr përsipër të njoftojë Bankën e Shqipërisë në rast se një ose disa anëtarë largohen nga unioni;
 - shoqëritë e kursim-kreditit , anëtare në unione të licencuara, ia besojnë unionit të drejtën e dhënies së të gjitha të dhënave për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kërkesave për marrjen e licencës.

TRANSFORMIMI³

Neni 8

Bashkimi i shoqërive të kursim-kreditit të licencuara

- 8.1. Në rast se bashkimi i shoqërive të kursim-kreditit të licencuara bëhet duke krijuar një shoqëri të re kursim-krediti, atëhere shoqëria e re përsërit kërkesën për marrjen e licencës duke plotësuar dokumentacionin :
- 8.1.1. Në rast se shoqëria e re e krijuar nga bashkimi nuk është anëtare në union, dokumentacioni plotësohet në përputhje me nenin 2 të rregullores duke shtuar :
- vendimet e asambleve përkatëse,
 - tabelat (3/1), (3/2) të formularit nr. 3.
- 8.1.2. Në rast se shoqëria e re e krijuar nga bashkimi, anëtarësohet në union, dokumentacioni plotësohet në përputhje me nenin 6 të rregullores duke shtuar :
- vendimet e asambleve individuale të shoqërive për bashkimin e tyre,
 - vendimin e bordit drejtues të unionit për anëtarësimin e shoqërisë së re,
 - tabelat (3/1), (3/2) të formularit nr. 3 të firmosura edhe nga kryetari i bordit drejtues të unionit.
- 8.1.3. Në rast se kërkesa për marrjen e licencës miratohet, atëhere në licencë shënohet edhe data e fillimit të aktivitetit të shoqërisë së re të kursim-kreditit. Kjo datë është dhe data e revokimit të licencave individuale të shoqërive të kursim-kreditit të bashkuara.
- 8.2. Në rast se bashkimi i shoqërive të kursim-kreditit të licencuara nuk bëhet duke krijuar një shoqëri kursim-krediti të re, por mbi bazën e një shoqërie kursim-krediti ekzistuese të licencuar, dokumentacioni i licencimit të shoqërisë mbi bazën e të cilës është bërë bashkimi plotësohet me :
- vendimet e asambleve individuale të shoqërive për bashkimin e tyre,
 - tabelat e formularit nr. 3,
 - dëshmitë e penalitetit për kryetarin e bordit drejtues dhe për kryetarin e komitetit mbikëqyrës.

Pas plotësimit të dokumentacionit, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim shoqërinë e kursim-kreditit mbi bazën e të cilës bëhet bashkimi duke përcaktuar edhe datën e fillimit të aktivitetit si shoqëri e bashkuar. Kjo datë është dhe data e revokimit të licencave individuale të shoqërive të kursim-kreditit të bashkuara, me përjashtim të shoqërisë mbi bazën e të cilës është bërë bashkimi.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

¹ Ndryshuar me vendimin nr.09, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

F O R M U L A R I N R. 1

TABELA NR. 1/1	
KËRKESA PËR LICENCË	
1.	Emri i plotë i shoqërisë
2.	Emri i shkurtuar i shoqërisë
3.	Adresa dhe numri i telefonit të zyrës qendrore
4.	Data e krijimit
5.	Kohëzgjatja e veprimtarive, përcaktuar në aktet nën ligjore
6.	Data e vendimit të regjistrimit nga Gjykata e Shkallës Parë Tiranë
7.	Numri i regjistrimit në gjykatë
8.	a) Bordi drejtues : kryetar anëtarë b) Komiteti mbikëqyrës : kryetar anëtarë
9.	Numri i anëtarëve
10.	Vlera e kapitalit të paguar në themelim
11.	Data e kërkesës për licencë
<p><u>Kërkuesi :</u></p> <p style="text-align: center;">Kryetari i Bordit Drejtues të Shoqërisë</p> <p style="text-align: center;">-----</p> <p style="text-align: center;">(Emri, mbiemri)</p> <p style="text-align: center;">-----</p> <p style="text-align: center;">(firmë)</p>	
1.1.	Data e protokollimit të kërkesës për licencë

TABELA NR. 1/2

DEKLARATA E ANGAZHIMIT
PËR
BANKËN E SHQIPËRISË
LIDHUR ME AUTORITETIN PËR TË DHË
PËR SHOQËRITË

Emri i shoqërisë :

(Adresa)

(Qyteti)

(Rrethi)

Me anë të kësaj deklarate angazhimi i drejtohem Bankës së Shqipërisë dhe dispozion dokumentacionin përkatës dhe çdo informacion të kësaj licencë për të kryer veprimtari si shoqëri kursim-krediti (union) në përputhje me ligjin nr. 8782, datë 03.05.2001 "Për shoqëritë e kursimit të parave në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë angazhohemi për zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Deklaruesi :

Kryetari i Bordit Drejtues

(Emri, mbiemri)

(firmë)

Ps.Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme :

Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr. 1
Tiranë, Shqipëri.

Tabela nr.1/3	
BILANCI I PARASHIKUAR	
AKTIVI	
1.	Arka
2.	Llogari rrjedhëse në bankë apo në union
3.	Depozita me afat në bankë apo në union:
4.	Investime në letra me vlerë
5.	Kredi
5.1.	Kredi me afat deri në 12 muaj
5.2.	Kredi me afat deri në 24 muaj
5.3.	Kredi me afat më të madh se 24 muaj
6.	Aktive të tjera
Aktive gjithsej	
DETYRIME DHE KAPITAL	
1.	Huamarrje nga bankat, nga unioni apo nga institucionet e tjera financiare
2.	Depozita me afat pa interes nga anëtarët
3.	Depozita me afat me interes nga anëtarët
4.	Depozita të bllokuara si garanci për kreditë
5.	Pasive të tjera
Detyrime gjithsej	
1.	Kapitali i paguar
2.	Fondet e donatorëve
3.	Rezerva e krijuar nga tepricat
4.	Fitim/humbje e grumbulluar
5.	Teprica ose deficitit gjatë vitit në vazhdim
Kapitali gjithsej	
DETYRIME DHE KAPITAL GJITHSEJ	

Tabela nr.1/4	
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEV	
	TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET
	TË ARDHURAT
1.	Të ardhura nga interesi i kredive
2.	Të ardhura nga interesi i depozitave
3.	Të ardhura nga interesi i letrave me vlerë
4.	Të ardhura të tjera
A.	Të ardhurat gjithsej
	SHPENZIMET
1.	Shpenzime nga interesat e huamarrjeve
2.	Shpenzime nga interesat e depozitave të anëtarëve
3.	Shpenzime për provigjonet nga kreditë (neto)
4.	Shpenzime administrative
5.	Shpenzime të tjera
B.	Shpenzime gjithsej
	Teprica ose deficitin gjithsej (A –B)
	Donacionet (dhuratat) e marra
	Teprica ose deficitin pas donacioneve

Tabela nr 1/ 5	
PARASHIKIMI PËR :	
1.	Numri total i anëtarëve
2.	Numri total i depozituesve
3.	Numri total i kredimarrësve
4.	Shuma bruto e kredive të dhëna
5.	Shuma mesatare e kredive (4/3)

Tabela nr 1/6					
Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Datëlindja	Vendlindja	Kombësia	(
	Bordi drejtues :				
1.				
2.				
3.				
....				
.....				
	Komiteti mbikëqyrës :				
1.				
2.				
3.				

F O R M U L A R I N R. 2

TABELA NR. 2/1	
KËRKESA PËR LICENCË	
1.	Emri i plotë i shoqërisë së kursim-kreditit
2.	Emri i shkurtuar i shoqërisë së kursim-kreditit
3.	Adresa dhe numri i telefonit të zyrës qendrore
4.	Data e krijimit
5.	Kohëzgjatja e veprimtarive, përcaktuar në aktet nën ligjore
6.	Data e vendimit të regjistrimit nga Gjykata e Shkallës Parë Tiranë
7.	Numri i regjistrimit në gjykatë
8.	a) Bordi drejtues : kryetar anëtarë b) Komiteti mbikëqyrës : kryetar anëtarë
9.	Numri i anëtarëve
10.	Vlera e kapitalit të paguar në themelim
11.	Data e kërkesës për licencë
<u>Kërkuesi :</u>	
Kryetari i Bordit Drejtues të ShKK	Kryetari i B
-----	-----
(Emri, mbiemri)	(Emri
-----	-----
(firmë)	
<hr/>	
1.1.	Data e protokollimit të kërkesës për licencë

TABELA NR. 2/2	
DEKLARATA E ANGAZHIMIT PËR BANKËN E SHQIPËRISË LIDHUR ME AUTORITETIN PËR TË DHË PËR SHOQËRINË E KURSIM-KREDITIT	
Emri i shoqërisë :	

(Adresa)	

(Qyteti)	(Rrethi)
<p>Me anë të kësaj deklarate angazhimi i drejtoheми Bankës së Shqipërisë në dispozicion dokumentacionin përkatës dhe çdo informacion të kësaj llicencë, për të kryer veprimtari si shoqëri kursim-krediti në Republikën e Shqipërisë me ligjin nr. 8782, datë 03.05.2001 "Për shoqëritë e kursim-kreditit në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë angazhohemi për zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.</p>	
<u>Deklaruesi :</u>	
Kryetari i Bordit Drejtues të Shqipërisë	

(Emri, mbiemri)	

(firmë)	

Ps.Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme :

Departamenti i Mbikëqyrjes
 Banka e Shqipërisë
 Sheshi "Skënderbej" Nr. 1
Tiranë, Shqipëri.

Tabela nr. 2/3	
PARASHIKIMI PËR :	
1.	Numri total i anëtarëve
2.	Numri total i depozituesve
3.	Numri total i kredimarrësve
4.	Shuma bruto e kredive të dhëna
5.	Shuma mesatare e kredive (4/3)
Kryetari i Bordit Drejtues të ShKK	
Kryetari i B	
.....
(Emri, mbiemri)	(E
.....
(firmë)	

Tabela nr 2/4					
Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Datëlindja	Vendlindja	Kombësia	
	Bordi drejtues :				
1.				
2.				
3.				
....				
.....				
	Komiteti mbikëqyrës :				
1.				
2.				
3.				

FORMULARI NR. 3⁴

TABELË nr. 3/1			
DATA : dita/muaji/viti			
	BILANCI I PËRMBLEDHUR	Shkk X	Shi
1.	Arka+llog.rrjedhëse+depozitat		
2.	Letra me vlerë		
3.	Teprica e kredive (bruto)		
4.	Totali i provigjoneve (-)		
5.	Aktive të qëndrueshme (neto)		
6.	Të tjera aktive		
	TOTALI I AKTIVEVE		
1.	Depozitat e lira të anëtarëve		
2.	Depozitat e bllokuara të anëtarëve		
3.	Huamarrjet e shoqërisë		
4.	Të tjera detyrime		
	TOTALI I DETYRIMEVE		
1.	Kapitali i paguar		
2.	Fondet e donatorëve		
3.	Rezervat nga tepricat		
4.	Fitim/humbjet e grumbulluara		
5.	Teprica/deficiti i vitit në vazhdim		
	KAPITALI		
	TOTALI I DETYRIMEVE + KAPITALI		
Kryetari i Bordit Drejtues të Sht			

(Emri, mbiemri)			

(firmë)			

⁴ Ndryshuar me vendimin nr.09, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës.

RREGULLORE

PËR MBIKËQYRJEN E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE

Miratuar me vendimin nr. 67, datë 28.08.2002, ndryshuar me vendimin nr. 83, datë 13.11.2002 të Këshillit Mbikëqyrës.

Të përgjithshme

Neni 1

- 1.1. Baza ligjore e rregullores janë ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 12, ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 8762, datë 03.05.2001 "Për shoqëritë e kursim-kreditit", nenet 46, 47, 48, 50.
- 1.2. Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës i shoqërive të kursim-kreditit dhe i unioneve të tyre.
- 1.3. Subjekte të rregullores janë shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Për thjeshtësi, në vijim të rregullores këto subjekte do të quhen "shoqëri".
- 1.4. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përdorur në ligjin nr. 8762, datë 03.05.2001 "Për shoqëritë e kursim-kreditit", neni 3.

Kontabiliteti

Neni 2

- 2.1. Kontabiliteti organizohet në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe me standardet ndërkombëtare kontabile si dhe duke bërë përshtatjen me "Manualin e kontabilitetit bankar".
- 2.2. Shoqëritë përcaktojnë, me rregulla të brendshme, politikat dhe procedurat kontabile të shkruara dhe të miratuara nga bordi drejtues.
- 2.3. Shoqëritë, si përjashtim nga pika 2.1., interesat e kredive mund t'i kontabilizojnë kur ato faktikisht arkëtohen.

Kreditë dhe normat e interesit për kreditë

Neni 3

- 3.1. Kreditë jepen dhe shlyhen vetëm në monedhë kombëtare.
- 3.2. Normat e interesit për kreditë të përcaktohen në mënyrë të tillë që me të ardhurat nga to, të paktën, të mbulohen të gjitha shpenzimet e shoqërisë.

Klasifikimi i kredive

Neni 4

- 4.1. Politikat e kredisë dhe të garantimit të saj të jenë të përcaktuara me rregulla të brendshme dhe të shkruara në formën e një manuali, të miratuar nga bordi drejtues.
- 4.2. Klasifikimi i kredisë bëhet në bazë të ditëvonesave të shlyerjes së saj :
 - 4.2.1. kur kredia nuk shlyhet plotësisht ose pjesërisht (kryegjë ose interes), nga 1 deri në 60 ditë, e gjithë kredia klasifikohet si nënstandarde;
 - 4.2.2. kur kredia nuk shlyhet plotësisht ose pjesërisht (kryegjë ose interes), nga 61 deri në 365 ditë, e gjithë kredia klasifikohet si e dyshimtë;
 - 4.2.3. kur kredia nuk shlyhet plotësisht ose pjesërisht (kryegjë ose interes), për më shumë se 365 ditë, e gjithë kredia klasifikohet si e humbur.
- 4.3. Me kredi me probleme kuptojmë shumën e kredive, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura.
- 4.4. Me kredi standarde kuptojmë të gjitha kreditë, me përjashtim të kredive me probleme.
- 4.5. Kreditë fshihen nga bilanci (write-off) kur ato qëndrojnë më shumë se 365 ditë si kredi të humbura dhe ndërpritet llogaritja e mëtejshme e interesave.

Llogaritja e provigjoneve

Neni 5

- 5.1. Provigjonet llogariten të paktën një herë në 3 muaj.
- 5.2. Provigjonet për kryegjënë llogariten si më poshtë:
 - 5.2.1. nga 2 për qind deri në 5 për qind të kredive standarde;
 - 5.2.2. jo më pak se 30 për qind të kredive nënstandarde;
 - 5.2.3. jo më pak se 75 për qind të kredive të dyshimta;
 - 5.2.4. 100 për qind të kredive të humbura;
 - 5.2.5. interesat e llogaritur për kreditë me probleme provigjonohen 100 për qind.

Norma e provigjonimit për kreditë nënstandarde të jetë jo më e lartë se norma provigjonimit për kreditë e dyshimta; dhe norma e provigjonimit për kreditë e dyshimta të jetë jo më e lartë se norma e provigjonimit për kreditë e humbura.

Cilësia e portofolit të kredive

Neni 6

- 6.1. Raporti i kredive standarde me totalin e portofolit të kredive të jetë, jo më i vogël se 90 për qind.
- 6.2. Raporti i kredive me probleme, me ditëvonesë më shumë se 30 ditë, me totalin e portofolit të kredive të jetë jo më i madh se 8 për qind.

Mjaftueshmëria e kapitalit

Neni 7

- 7.1. Raporti i kapitalit me tepricën bruto të portofolit të kredive të jetë, në çdo kohë, jo më i vogël se 5 për qind gjatë vitit të parë pas marrjes së licencës dhe jo më i vogël se 8 për qind pas vitit të parë.
- 7.2. Raporti i kapitalit me aktivet e qëndrueshme (neto) të jetë, në çdo kohë, jo më i vogël se 100 për qind.
- 7.3. Raporti i kapitalit me shumën totale të tepricës së pagarrantuar me bllokim depozite, të kredive me probleme, të jetë në çdo kohë, jo më i vogël se 100 për qind.

Likuiditeti

Neni 8

- 8.1. Shoqëria ka gjendje në arkë, në llogari rrjedhëse, në depozitë me afat maturimi deri në një muaj në çdo kohë, një shumë jo më të vogël se 10 për qind të totalit të depozitave të lira, me afat maturimi jo më të madh se gjashtë muaj.
- 8.2. Shoqëria jep kredi me afat maturimi më të madh se dy vjet, jo më shumë se 20 për qind të totalit të depozitave.
- 8.3. Shoqëritë e kursim-kreditit janë të detyruara të depozitojnë në unionin e krijuar prej tyre një shumë jo më të vogël se 2 për qind të vlerës totale të depozitave të lira të anëtarëve të shoqërive të kursim-kreditit.

Shpërndarja e rrezikut

Neni 9

- 9.1. Për çdo kredi të dhënë një anëtar të vetëm gjatë dy viteve të para të aktivitetit të kredisë, pjesa e pagarrantuar me bllokim depozite, e kredisë, të jetë jo më e madhe se 100 për qind e kapitalit të shoqërisë.
- 9.2. Për çdo kredi të dhënë një anëtar të vetëm gjatë vitit të tretë të aktivitetit të kredisë, pjesa e pagarrantuar me bllokim depozite, e kredisë, të jetë jo më e madhe se 50 për qind e kapitalit të shoqërisë.
- 9.3. Për çdo kredi të dhënë një anëtar të vetëm pas vitit të tretë të aktivitetit të kredisë, pjesa e pagarrantuar me bllokim depozite, e kredisë, të jetë jo më e madhe se 20 për qind e kapitalit të shoqërisë.
- 9.4. Shuma e çdo kredie të dhënë një anëtar të vetëm, të jetë jo më e madhe se 15 për qind e totalit të aktiveve.

Raportimi
Neni 10

- 10.1. Shoqëritë raportojnë në Bankën e Shqipërisë zbatimin e normave të mbikëqyrjes çdo tre muaj. Të dhënat raportohen jo më vonë se 40 ditë pas mbylljes së çdo tremujori (31.03, 30.06, 30.09, 31.12). Raportimi i parë bëhet me të dhënat e 31.12.02.
- 10.2. Formularët e raportimit të normave të mbikëqyrjes i bashkëngjiten sistemit raportues të miratuar me vendimin nr.75, datë 05.09.01 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- 10.3. Unionet e shoqërive të kursim-kreditit raportojnë gjendjet financiare dhe normat e mbikëqyrjes mbi baza individuale dhe në mënyrë të përmbledhur për të gjithë rrjetin e shoqërive të kursim-kreditit anëtare në union.
- 10.4. Unionet janë të detyruara të raportojnë në Bankën e Shqipërisë çdo tremujor, listën e shoqërive të kursim-kreditit, të cilat nuk plotësojnë qoftë edhe një nga normat e mbikëqyrjes të vendosura së bashku me normat përkatëse.

Kontrolli
Neni 11

- 11.1. Banka e Shqipërisë kontrollon dhe analizon veprimtarinë e shoqërive si nëpërmjet analizës së të dhënave të raportuara nga shoqëritë ashtu dhe nëpërmjet inspektimeve në vend.
- 11.2. Shoqëritë janë të detyruara të respektojnë, në çdo kohë, të gjitha kërkesat e rregullores dhe kërkesat shtesë të vendosura nga Banka e Shqipërisë.
- 11.3. Në rast mosplotësimi të kërkesave të pikës 11.2., shoqëritë janë të detyruara të bëjnë rregullimet e duhura brenda 3 muajsh. Në rast të kundërt, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë masa në respektim të nenit 51, të ligjit nr. 8782, datë 03.05.01 "Për shoqëritë e kursim-kreditit".

Përfundimtare
Neni 12

- 12.1. Shoqëritë përcaktojnë me rregulla të brendshme, në formën e një manuali, politikat e shkruara për kredidhënien, të cilat miratohen nga bordi drejtues.
- 12.2. Shoqëritë përcaktojnë me rregulloret e brendshme, politikat e pranimit të depozitave, afatet, mënyrën e shpërblimit, të bllokimit si garanci për kreditë e dhëna, drejtimin e tyre.
- 12.3. Unionet e shoqërive të kursim-kreditit vendosin rregulla të brendshme të shkruara për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit, anëtare në union, në formën e një manuali të miratuar nga bordi drejtues i unionit.
- 12.4. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
SHKËLQIM CANI

FORMULARI NR. 1

Klasifikimi i kredive dhe llogaritja e pro			
Nr.	Klasifikimi i kredive	Shumat	
1.	Kreditë standarde		Ng
2.	Kreditë nënstandarde		Jo
3.	Kreditë e dyshimta		Jo
4.	Kreditë e humbura		
	TOTALI		
5.	Kreditë me probleme (2 + 3 + 4)		

FORMULARI NR. 2

Cilësia e portofolit të kredive			
Nr.	Klasifikimi i kredive	Shumat	Rap mbik
1.	Kreditë standarde		(1/3)
2.	Kreditë me probleme mbi 30 ditë		(2/3)
3.	Totali i portofolit të kredive		//

FORMULARI NR. 3

Likuiditeti			
Nr.		Shumat	Raportet e mb
1.	Gjendja e arkës		
2.	Llogaritë rrjedhëse		
3.	Depozitat me afat maturimi deri në 1 muaj		
4.	Totali (1+2+3)		
5.	Totali i depozitave të lira me afat maturimi jo më të madh se 6 muaj		
			(4/5) në i
1.	Kredi me afat më të madh se 2 vjet		
2.	Totali i depozitave		
			(1/2) në i

FORMULARI NR. 4

Mjaftueshmëria e kapital			
Nr.		Shumat	F r
1.	Kapitali		
2.	Teprica bruto e portofolit të kredive		(1
			(1
3.	Aktive të qëndrueshme (neto)		(
4.	Totali i kredive me probleme të pagarantuara		(

FORMULARI NR. 5/1 (PËR SHKK-TË)¹

BILANCI I PERIUdhËS	
AKTIVI	
1.	Arka
2.	Llogari rrjedhëse në bankë apo union
2.1	Llogari rrjedhëse në bankë
2.2	Interes i përlogaritur
2.3	Llogari rrjedhëse në union
2.4	Interes i përlogaritur
3.	Depozita me afat në bankë apo në union
3.1	Depozita me afat në bankë
3.2	Interes i përlogaritur
3.3	Depozita me afat në union
3.4	Interes i përlogaritur
3.5	Çertifikata depozitash
3.6	Interes i përlogaritur
4.	Llogari e bllokuar pranë unionit (2%)
5.	Investime
5.1	Investime
5.2	Interes i përlogaritur
6.	Kredi (neto):
6.1.	Kredi me afat deri në 12 muaj
6.2.	Kredi me afat deri në 24 muaj
6.3.	Kredi me afat më të madh se 24 muaj
6.4.	(minus) : Provigjone për kreditë
7.	Aktive të qëndrueshme (neto)
8.	Aktive të tjera
	Aktive gjithsej
	DETYRIME DHE KAPITAL
1.	Huamarrje nga bankat, nga unioni apo nga institucionet financiare
1.1	Huamarrje nga bankat
1.2	Interes i përlogaritur
1.3	Huamarrje nga unioni apo nga institucionet e tjera financiare
1.4	Interes i përlogaritur
2.	Huamarrje nga qeveria
2.1	Huamarrje nga qeveria
2.2	Interes i përlogaritur
3.	Depozita me afat pa interes nga anëtarët
4.	Depozita me afat me interes nga anëtarët
4.1	Depozita me afat me interes nga anëtarët
4.2	Interes i përlogaritur
5.	Depozita të bllokuara si garanci për kreditë
6.	Fonde publike dhe grante
7.	Pasive të tjera
	Detyrime gjithsej
8.	Kapitali i paguar
9.	Fondet e donatorëve
10.	Rezerva e krijuar nga tepricat
11.	Fitim/humbje e grumbulluar
12.	Tasues nga deficit i vitit të kaluar dhe

¹ Ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 13.11. 2002 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre.""

FORMULARI NR. 5/2 (PËR UNIONET E SHKK-VE)²

BILANCI I PERIUdhËS	
	AKTIVI
1.	Arka
2.	Llogari rrjedhëse në bankë apo union
2.1	Llogari rrjedhëse në bankë
2.2	Interes i përlogaritur
3.	Depozita me afat në bankë apo në union
3.1	Depozita me afat në bankë
3.2	Interes i përlogaritur
3.3	Çertifikata depozitash
3.4	Interes i përlogaritur
4.	Investime
4.1	Investime
4.2	Interes i përlogaritur
5.	Kredi (neto):
5.1.	Kredi me afat deri në 12 muaj
5.2.	Kredi me afat deri në 24 muaj
5.3.	Kredi me afat më të madh se 24 muaj
5.4.	(minus) : Provigjone për kreditë
6.	Aktive të qëndrueshme (neto)
7.	Aktive të tjera
	Aktive gjithsej
	DETYRIME DHE KAPITAL
1.	Huamarrje nga bankat apo nga institucionet e tjera financiare
1.1	Huamarrje nga bankat
1.2	Interes i përlogaritur
1.3	Huamarrje nga institucionet e tjera financiare
1.4	Interes i përlogaritur
2.	Huamarrje nga qeveria
2.1	Huamarrje nga qeveria
2.2	Interes i përlogaritur
3.	Depozita me afat pa interes nga anëtarët
4.	Depozita me afat me interes nga anëtarët
4.1	Depozita me afat me interes nga anëtarët
4.2	Interes i përlogaritur
5.	Depozita të bllokuara si garanci për kreditë
6.	Fonde publike dhe grante
7.	Pasive të tjera
	Detyrime gjithsej
8.	Kapitali i paguar
9.	Fondet e donatorëve
10.	Rezerva e krijuar nga tepricat
11.	Fitim/humbje e grumbulluar
12.	Teprica ose deficioni gjatë vitit në vazhdim
	Kapitali gjithsej
	DETYRIME DHE KAPITAL GJITHSEJ

² Ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 13.11. 2002 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre".

FORMULARI NR. 6

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET	
	TË ARDHURAT
1.	Të ardhura nga interesi i kredive
2.	Të ardhura nga interesi i depozitave
3.	Të ardhura nga interesi i letrave me vlerë
4.	Të ardhura të tjera
A.	Të ardhurat gjithsej
	SHPENZIMET
1.	Shpenzime nga interesat e huamarrjeve
2.	Shpenzime nga interesat e depozitave të anëtarëve
3.	Shpenzime për provigjonet nga kreditë (neto)
4.	Shpenzime administrative
5.	Shpenzime të tjera
B.	Shpenzime gjithsej
	TEPRICA ose DEFICITI GJITHSEJ (A –B)
	Donacionet (dhuratat) e marra
	TEPRICA ose DEFICITI pas DONACIONEVE

FORMULARI NR. 7

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET	
A.	TË ARDHURAT FINANCIARE :
1.	Të ardhura nga interesi i kredive
2.	Të ardhura nga interesi i depozitave
3.	Të ardhura nga interesi i letrave me vlerë
4.	Të ardhura të tjera financiare
B.	SHPENZIMET FINANCIARE :
1.	Shpenzime nga interesat e huamarrjeve
2.	Shpenzime nga interesat e depozitave të anëtarëve
3.	Shpenzime të tjera financiare
C.	REZULTATI FINANCIAR BRUTO (C = A-B)
D.	SHPENZIME :
	Provigjonet nga kreditë (neto)
	Humbje nga kreditë e fshira
E.	REZULTATI OPERACIONAL BRUTO (E = C – D)
F.	Shpenzime administrative :
	Shpenzime personeli
	Shpenzime të tjera administrative
G.	REZULTATI OPERACIONAL NETO (G = E – F)
H.	REZULTATI JOOPERACIONAL :
	Të ardhura jooperacionale
	Shpenzime jooperacionale
	TEPRICA ose DEFICITI GJITHSEJ (G – H)

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**SISTEMI I RAPORTIMIT TË SHOQËRIVE TË KURSIM-
KREDITIT**

(miratuar me vendimin nr.75, datë 05.09.2001.)

FORMULARËT E RAPORTIMIT

E M R I

PERIUDHA E RAPORTIMIT.....

FORMULARI NR. 1
NUMRI I SHOQËRIVE TË KURSIM- KREDITIT

Informacion vjetor
Numri i shkk-ve në fillim të vitit :
Krijimi i shkk-ve të reja gjatë vitit (+) :
Mbyllja e shkk-ve gjatë vitit (-) :
Numri i shkk-ve në fund të vitit :

Informacion tremujor
Numri i shkk-ve në fillim të tremujorit :
Krijimi i shkk-ve të reja gjatë tremujorit (+) :
Mbyllja e shkk-ve gjatë tremujorit (-) :
Numri i shkk-ve në fund të tremujorit :

FORMULARI NR. 2
NUMRI TOTAL I ANËTARËVE TË SHOQËRIVE TË KURSIM- KREDITIT

Informacion vjetor
Numri i anëtarëve në fillim të vitit :
Anëtarësimet e reja gjatë vitit (+) :
Largimet e anëtarëve gjatë vitit (-) :
Numri i anëtarëve në fund të vitit :

Informacion tremujor
Numri i anëtarëve në fillim të tremujorit :
Anëtarësimet e reja gjatë tremujorit (+) :
Largimet e anëtarëve gjatë tremujorit (-) :
Numri i anëtarëve në fund të tremujorit :

FORMULARI NR. 3
KAPITALI TOTAL I SHOQËRIVE TË KURSIM- KREDITIT

Informacion vjetor
Kapitali total në fillim të vitit :
Rritja e kapitalit gjatë vitit (+) :
Pakësimi i kapitalit gjatë vitit (-) :
Kapitali total në fund të vitit :

Informacion tremujor
Kapitali total në fillim të tremujorit :
Rritja e kapitalit gjatë tremujorit (+) :
Pakësimi i kapitalit gjatë tremujorit (-) :
Kapitali total në fund të tremujorit :

FORMULARI NR. 4
DEPOZITAT E GRUMBULLUARA NGA SHOQËRITË E KURSIM- KREDITIT

Informacion vjetor
Gjendja e depozitave në fillim të vitit :
Shtesa e depozitave gjatë vitit (+) :
Pakësimi i depozitave gjatë vitit (-) :
Gjendja e depozitave në fund të vitit :
- për individ :
- për joindivid :

Informacion tremujor
Gjendja e depozitave në fillim të tremujorit :
Shtesa e depozitave gjatë tremujorit (+) :
Pakësimi i depozitave gjatë tremujorit (-) :
Gjendja e depozitave në fund të tremujorit :
- për individ :
- për joindivid :

FORMULARI NR. 5
KREDITË E DHËNA NGA SHOQËRITË E KURSIMIT- KREDITIT

Informacion vjetor
Gjendja e kredive në fillim të vitit :
Kreditë e dhëna gjatë vitit (+) :
Shlyerjet e kredive gjatë vitit (-) :
Gjendja e kredive në fund të vitit :
- për individ :
- për joindivid :

Informacion tremujor
Gjendja e kredive në fillim të tremujorit :
Kreditë e dhëna gjatë tremujorit (+) :
Shlyerjet e kredive gjatë tremujorit (-) :
Gjendja e kredive në fund të tremujorit :
- për individ :
- për joindivid :

Arkëtimet nga interesat
Arkëtimet nga interesat gjatë tremujorit të parë :
Arkëtimet nga interesat gjatë tremujorit të dytë :
Arkëtimet nga interesat gjatë tremujorit të tretë :
Arkëtimet nga interesat gjatë tremujorit të katërt :
Arkëtimet nga interesat gjatë vitit :

FORMULARI NR. 6
KATEGORITË E KREDIVE TË DHËNA NGA SHOQËRITË E KURSIMIT
KREDITIT

Informacion vjetor				
Kategoritë (në lekë)	Gjendja në fillim		Përdorimet	
	Numri	Shuma	Numri	Shuma
Deri 5,000				
5,001 – 10,000				
10,001 – 50,000				
50,001 – 100,000				
100,001 – 200,000				
200,001 – 500,000				
500,001 – 1,000,000				
Mbi 1,000,000				

Informacion tremujor				
Kategoritë (në lekë)	Gjendja në fillim		Përdorimet	
	Numri	Shuma	Numri	Shuma
Deri 5,000				
5,001 – 10,000				
10,001 – 50,000				
50,001 – 100,000				
100,001 – 200,000				
200,001 – 500,000				
500,001 – 1,000,000				
Mbi 1,000,000				

FORMULARI NR. 7
KREDITË E PAKTHYERA NË AFAT NGA SHOQËRITË E KURSIMIT
KREDITIT

Periudha e moskthimit (në ditë)	Deri 90	91 – 120
Gjendja në fillim të periudhës :		
Shtesat gjatë periudhës :		
Pakësimet gjatë periudhës :		
Gjendja në fund :		

FORMULARI NR. 8
KREDIA E DHËNË GJATË TREMUJORIT SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË

Numri i degëve të ekonomisë Në mijë Lekë

Numri i degëve të ekonomisë	
1.	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura
2.	Peshkimi
3.	Industria nxjerrëse
4.	Industria përpunuese
5.	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike e gazit dhe
6.	Ndërtimi
7.	Tregtia. Riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiak
8.	Hotele dhe restorante
9.	Transporti dhe telekomunikacioni
10.	Aktivitete financiare
11.	Pasuritë e patundshme
12.	Shëndeti dhe veprimtaritë sociale
13.	Shërbime kolektive, sociale dhe personale

RREGULLORE

PËR NORMAT E MBIKËQYRJES TË SUBJEKTEVE JOBANKA QË USHTROJNË VEPRIMTARI FINANCIARE

Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.60, datë
05.07.2000.

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

- 1.1. Kjo rregullore nxirret në zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.8080, datë 01.03.96 "Për shoqëritë tregtare" dhe të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.26, datë 18.03.1999.
- 1.2. Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjitha subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare, të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë" të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.26, datë 18.03.1999. Në vazhdim të kësaj rregulloreje ato do të quhen "subjekte jobanka".
- 1.3. Qëllimi i rregullores është përcaktimi i normave mbikëqyrëse për të gjitha "subjektet jobanka", që ushtrojnë aktivitetet e parashikuara në pikën 1.4. të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë".
- 1.4. Në kuptim të kësaj rregulloreje:

Me "**kapital**" kuptohet shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme:

- a) kapitali i paguar dhe çdo dhurim kapitali;
- b) të gjitha rezervat me burim shpërndarjen e fitimit;
- c) fitim (humbje) i pashpërndarë;
- d) fitim (humbje) ushtrimor;
- e) diferencat e rivlerësimit (kreditorë apo debitorë) të kapitalit të paguar apo të dhurimeve në monedhë të ndryshme nga monedha kombëtare.

Me "**kredi me probleme**" kuptohet teprica bruto (principal + interes) e shumës së kredive nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura.

Me "**përfitues**" kuptohet një person ose disa persona juridikë, të lidhur midis tyre në marrëdhënie të tilla, që vështirësitë financiare të njërit apo të disave shkaktojnë vështirësi financiare në përmbushjen e detyrimeve kontraktore (paaftësi paguese) të të tjerëve.

NORMAT MBIKËQYRËSE PËR SUBJEKTET JOBANKA

Neni 2

Operacionet e lejueshme

Operacione të lejueshme për "subjekte jobanka" janë të gjitha veprimtaritë financiare të parashikuara në pikën 1.4. të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë" të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.26, datë 18.03.1999.

Neni 3

Kreditë, klasifikimi i tyre dhe llogaritja e provigjoneve

- 3.1. "Subjektet jobanka" hartojnë një manual të veçantë për kreditë, të miratuar nga organet drejtuese të tyre.
- 3.2. Klasifikimi i kredive dhe i të gjitha aktiveve, në përgjithësi, bëhet duke respektuar rregullat e parashikuara në rregulloren "Për klasifikimin e kredive dhe krijimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë" të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.50, datë 18.03.1999 dhe të gjitha ndryshimeve të saj.

Neni 4

Mjaftueshmëria e kapitalit

- 4.1. Raporti i kapitalit me totalin e aktiveve të jetë jo më i vogël se 10 për qind.
- 4.2. Raporti i kapitalit me totalin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto të jetë jo më i vogël se 100 për qind.
- 4.3. Raporti i kapitalit me totalin e kredive me probleme të jetë jo më i vogël se 100 për qind.
- 4.4. Raporti i kapitalit të paguar në natyrë me kapitalin të jetë jo më i madh se 50 për qind.

Neni 5

Cilësia e aktiveve

- 5.1. Raporti i kredive me probleme (principal + interes) me totalin e kredive të dhëna (principal + interes) të jetë jo më i madh se 8 për qind.
- 5.2. Raporti i shlyerjes faktike të kredisë (principal + interes) me shlyerjen e parashikuara (principal + interes) në kontratën e kredisë të jetë jo më i vogël se 90 për qind.
- 5.3. Raporti i shumës të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto me totalin e aktiveve të jetë jo më i madh se 10 për qind, pas 12 muajve të marrjes së licencës nga Banka e Shqipërisë.
- 5.4. Raporti i aktiveve, që sjellin të ardhura me detyrimet që shkaktojnë shpenzime të jetë jo më i vogël se 100 për qind.

Neni 6

Normat e shpërndarjes së rrezikut

- 6.1. Shuma maksimale e kredisë dhënë një përfituesi vitin e parë të aktivitetit të "subjektit jobankë", të jetë jo më e madhe se 100 për qind e kapitalit të "subjektit jobankë".
- 6.2. Pas 12 muajve të marrjes të licencës, çdo kredi e dhënë për një përfitues të jetë jo më e madhe se 10 për qind e totalit të kredive të dhëna nga "subjekti jobankë".
- 6.3. Çdo investim në letra me vlerë, me përjashtim investimet në bono thesari të Shtetit Shqiptar dhe të vendeve të zonës A, të jetë jo më i madh se 5 për qind e kapitalit të "subjektit jobankë". (Përcaktimi i zonës konsiderohet sipas specifikimit të bërë në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit".)
- 6.4. Shuma totale e investimeve në letra me vlerë, me përjashtim investimet në bono thesari të Shtetit Shqiptar dhe të vendeve të zonës A, të jetë jo më i madh se 40 për qind e kapitalit të "subjektit jobankë". (Përcaktimi i zonës konsiderohet sipas specifikimit të bërë në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit".)

Neni 7

Likuiditeti

- 7.1. Raporti i aktiveve me afat mbetës deri në maturim 1 muaj me detyrimet me afat mbetës deri në maturim 1 muaj të jetë jo më i vogël se 100 për qind.
- 7.2. Raporti i aktiveve me afat mbetës deri në maturim 3 muaj me detyrimet me afat mbetës deri në maturim 3 muaj të jetë jo më i vogël se 100 për qind.
- 7.3. 80 për qind e kredive me afat maturimi më të madh se 2 vjet të financohen nga burime me afat maturimi më të madh se 2 vjet.

Neni 8

Raportimi

- 8.1. Raportimi nga "subjektet jobanka" në Bankën e Shqipërisë, bëhet çdo tremujor.
- 8.2. Për sa kohë Banka e Shqipërisë nuk ka përcaktuar një format standard të sistemit raportues, sipas të cilit "subjektet jobanka" duhet të raportojnë, ato janë të detyruara të paraqesin në Bankën e Shqipërisë:
 - a) bilancin;
 - b) llogarinë e rezultatit;
 - c) pasqyrën e *cash-flow*;
 - d) pasqyra të veçanta për normat e mbikëqyrjes për secilën nga pikat e mësipërme.

Neni 9

Të ndryshme

- 9.1" SUBJEKTET JOBANKA" JANË TË DETYRUARA TË ZBATOJNË KËRKESAT E KËSAJ RREGULLOREJE TRE MUAJ PAS MARRJES SË LICENCËS NGA BANKA E SHQIPËRISË.
- 9.2. Në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë zgjat afatin, deri në tre muaj, për plotësimin e këtyre kërkesave.
- 9.3. Në rastet kur edhe pas afatit tremujor "subjekti jobankë" nuk plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje atëherë, Banka e Shqipërisë, zbaton dispozitat e kreut VII "Shkeljet dhe dënimet" të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 " Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 9.4. Kjo rregullore hyn në fyqi 15 ditë pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

RREGULLORE

PËR

BANKAT KOOPERATIVË

Miratuar me vendimin nr. 25, datë 29.03.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KAPITULLI I

KRIJIMI DHE AKTIVITETI

Neni 1

Të përgjithshme

- 1.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve të krijimit, të ushtrimit të aktivitetit, të licencimit dhe të mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë të bankave kooperativë, si dhe veçoritë e këtyre bankave.
- 1.2. Bazën ligjore të kësaj rregulloreje e përbëjnë: ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe ligji nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 1.3. Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:
 - "Banka kooperativë" është personi juridik i krijuar nga bashkimi vullnetar i anëtarëve të saj me qëllim përdorimin e burimeve financiare të tyre kryesisht në interes të aktivitetit të vetë bankës dhe që vepron brenda zonës administrative ku ka selinë.
 - "Kuotë anëtarësie fillestare" është kuota e paguar nga secili anëtar i bankës kooperativë në momentin e anëtarësimit në bankë, sipas përcaktimit të bërë në aktet e brendshme rregullative të bankës.
 - "Teprica" sipas pikës 6 të nenit 64, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" përfaqëson diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve të bankës, duke zbritur edhe taksat, pra fitimin neto të bankës kooperativë.
 - "Gjendja e llogarisë tepricë në fillim" e përcaktuar në pikën 4 të nenit 64, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" konsiderohet kapitali i nënshkruar që banka kooperativë plotëson brenda afatit prej 5 vjetësh nga koha e fillimit të aktivitetit si bankë. Shuma prej 1/3 e kapitalit minimal të kërkuar kohë pas kohe nga Banka e Shqipërisë për të licencuar bankat e reja, kupton 1/3 e shumës minimale të kapitalit fillestar të kërkuar, të paguar për kontributin në para për një bankë, sipas përcaktimit të bërë në rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë".
 - "Zona e kompetencës territoriale të bankës" është hapësira me rreze prej 25 km nga selia e bankës, brenda të cilës banka kooperativë ushtron aktivitetin e saj.
 - "Qarkullim vjetor" është sasia në para e shitjeve të prodhimeve, të mallrave dhe të shërbimeve që anëtarët e bankës kooperativë realizojnë gjatë një viti financiar.
 - "Anëtarë të bankës kooperativë" janë subjektet e përcaktuara në nenin 64, pika 2,b të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
 - "Kapitali fillestar minimal", përfaqëson shumën minimale të kapitalit të kërkuar, të paguar për marrjen e licencës nga Banka e Shqipërisë, për të vepruar si bankë kooperativë në Republikën e Shqipërisë.

Termet e tjerë, që nuk janë përfshirë në përcaktimet si më sipër do të kenë të njëjtin kuptim si ata të shprehur në nenin 2, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Anëtarësimi

2.1. Anëtarët e bankës kooperative marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në aktet e brendshme të bankës. Të paktën dy nga anëtarët e këshillit drejtues të bankës, duke përfshirë edhe drejtuesin e këshillit, duhet të kenë cilësi profesionale sipas përcaktimeve të bëra në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë për administratorët e bankave që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

2.2. Qarkullimi i vjetor i aktivitetit të realizuar nga anëtarët e bankës kooperative, artizanë dhe tregtarë të vegjël, të jetë deri në 1000 herë pagën mesatare mujore të fundit të zonës administrative të rajonit ku ka qendrën banka kooperative.

Neni 3

Veçoritë e bankave kooperative

- 3.1 Banka kooperative ka emërtimin e veçantë të saj të shoqëruar me termin "bankë kooperative" dhe emërtimin e zonës në të cilën banka ka selinë.
- 3.2 Banka kooperative ndërtohet dhe vepron mbështetur në parimin e vullnetarizmit dhe të reciprocitetit, që është tipar dallues i kësaj banke. Kjo karakteristikë reflektohet në raportet e ndërsjella midis bankës dhe anëtarëve nga njëra anë, klientelës dhe shtrirjes territoriale nga ana tjetër.
- 3.3 Përfitimi kryesor i anëtarëve në bankën kooperative materializohet në përparësinë e mundësisë të përdorimit të shërbimeve dhe të produkteve bankare.
- 3.4 Banka zbaton parimin e lokalizimit, që nënkupton shtrirjen e aktivitetit të saj brenda zonës së kompetencës territoriale.
- 3.5 Banka hap degë dhe agjenci vetëm brenda zonës së kompetencës territoriale të saj me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.
- 3.6 Aktet e brendshme të bankës kooperative shërbejnë për disiplinimin, në përputhje me rregullat e mbikëqyrjes të fiksuar nga Banka e Shqipërisë, të aktivitetit, të operacioneve të kredisë dhe të mbledhjes të depozitave. Në këto akte përcaktohen instrumentet që rregullojnë raportet ndërmjet anëtarëve, duke përcaktuar edhe kufirin e detyrimit që anëtarët marrin përsipër për bankën kooperative.
- 3.7. Anëtarësimi në bankat kooperative, përveç karakteristikave individuale të çdo banke kooperative të përcaktuara në aktet e brendshme rregullative, ka edhe këto karakteristika të përgjithshme:
 - dhënia e përparësisë anëtarit në shërbimet e kryera nga bankat kooperative;
 - gëzimi i të drejtave të barabarta, në bazë të rregullit "një anëtar, një votë";
 - karakteri nominativ i anëtarësimit që bëhet me vendim të asamblesë së përgjithshme të bankës.
- 3.8 Banka kooperative ka "komitetin e kreditit", përbërja dhe rregullat për funksionimin e të cilit përcaktohen nga këshilli drejtues i saj.
- 3.9 Statuti i bankës përcakton kufirin brenda të cilit këshilli drejtues vendos mbi kërkesat e pranimit dhe të largimit të anëtarit.

Neni 4

Ushtrimi i aktivitetit nga bankat kooperative

- 4.1 Banka kooperative ka si objekt kryesor të saj dhënien e kredisë kryesisht në favor të anëtarëve të saj.
- 4.2 Përveç sa është përcaktuar në pikën 4.1 të këtij neni, banka kooperative ushtron aktivitetet bankare si vijon:
 - a) mban llogari bankare dhe përcakton marrëveshje për transaksione afatshkurtra ;
 - b) pranon dhe ofron shërbimin e depozitave, për të cilat paguan ose jo interes;
 - c) jep kredi personave të tretë;
 - d) merr pjesë në tregun ndërbankar;
 - e) ofron garanci;
 - f) ruan metale të çmuara dhe parashikon shërbime të lidhura me kasetat e sigurimit;
 - g) emeton, pranon dhe administron mjete të pagesave;
 - h) ndërmjetëson transaksione monetare (duke përfshirë valutat).

- 4.3. Kreditë që jep banka kooperativë mund të jenë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, por nuk duhet të kalojnë për secilin kredimarrës, kufirin prej 500 herë pagën mesatare mujore të fundit të zonës administrative të rajonit ku ka qendrën banka kooperativë.
- 4.4. Banka blen ose shet për llogari të anëtarëve letra me vlerë.

Neni 5

Aktet e brendshme rregullative të bankës kooperativë

Aktet e brendshme rregullative të bankës kooperativë përmbajnë:

emërtimin dhe adresën e selisë së bankës; qëllimin e krijimit; periudhën brenda së cilës do të ushtrohet aktiviteti i bankës, shumën e derdhur të kuotës së anëtarësimit të secilit prej anëtarëve të bankës dhe mënyrën e pagesës; përbërjen, pronësinë dhe formimin e kapitalit të bankës; emrat, mbiemrat, adresat e anëtarëve të bankës; kushtet e anëtarësimit, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve dhe garancinë e marrjes përsipër prej tyre të detyrimeve që rrjedhin; procedurat për t'u anëtarësuar dhe për t'u larguar nga banka; procedurat e zgjedhjeve të këshillit drejtues dhe të komitetit të kontrollit, si dhe të drejtat dhe detyrat e tyre; procedurat për shpërndarjen e të ardhurave dhe për mbulimin e humbjeve të bankës, në bazë të rezolutës së mbledhjes së këshillit drejtues të bankës, si dhe mënyrat e zbatimit të rregullave të mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

Neni 6

Mbikëqyrja e bankave kooperativë

- 6.1. Mbikëqyrja e bankave kooperativë realizohet nëpërmjet kontrollit të zbatimit të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për bankat dhe për degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.
- 6.2. Bankat kooperativë raportojnë në Bankën e Shqipërisë sipas një sistemi raportues të miratuar.
- 6.3. Bankat kooperativë organizojnë mbajtjen e kontabilitetit sipas Manualit të Kontabilitetit Bankar miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.820, datë 30.12.1998.
- 6.4. Aktiviteti i bankave kooperativë ushtrohet duke patur parasysh që afati mesatar i maturimit të kredisë të jetë jo më i madh se afati mesatar i maturimit të burimit të financimit.
- 6.5. Banka kooperativë paraqet në Bankën e Shqipërisë çdo ndryshim në aktet e brendshme rregullative të saj.

KAPITULLI II

Neni 7

Licencimi

- 7.1. Banka e Shqipërisë është i vetmi autoritet që jep licencën, si akt administrativ, për autorizimin e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë bankare nga bankat kooperativë, në mbështetje të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 7.2. Shuma minimale e kapitalit fillestar të kërkuar, të paguar për një bankë kooperativë është jo më pak se 100 milionë lekë. Kur kapitali i nënshkruar i bankës së propozuar është mbi nivelin e shumës së kapitalit minimal fillestar, atëherë anëtarët, si fillim, duhet të derdhen jo më pak se shuma e kapitalit fillestar të kërkuar nga Banka e Shqipërisë. Pjesa e mbetur paguhet sipas përcaktimeve të bëra në statutin e bankës kooperativë, brenda afatit ligjor prej 5 vjetësh.
- 7.3. Për vërtetimin e derdhjes së kapitalit fillestar të kërkuar dhe burimin e tij, banka kooperativë e propozuar, duhet të paraqesë në Bankën e Shqipërisë dokumentin që vërteton derdhjen e këtij kapitali nga anëtarët si pasojë e pagesave të kuotizacionit të secilit prej tyre, në një llogari depozitë të marrë si garanci në Bankën e Shqipërisë. Depozitimi bëhet me xhirim në llogari dhe jo në cash.

Neni 8

Dokumentacioni

Dokumentacioni i kërkuar nga Banka e Shqipërisë do të përfshijë:

- 8.1. Për anëtarët e bankës kooperativë të propozuar, dokumentacioni që do të paraqitet në Bankën

- e Shqipërisë do të përfshijë, sipas rastit:
- 8.1.1. Kur anëtarët janë persona juridikë :
- listën e të gjithë anëtarëve të bankës kooperativë, vendqëndrimin ose selinë ekzistuese, dhe largësinë e punësimit ose të banimit të tyre nga selia e bankës së propozuar;
 - aktin e themelimit, statutin, aktin e regjistrimit në gjykatë;
 - të dhënat për veprimtarinë ekonomike, tregtare ose industriale për vitin e fundit të çdo anëtarit. Dokumentet e mësipërme të jenë të vërtetuara nga ekspertët e pavarur të autorizuar;
 - vërtetimin nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim-taksave nga anëtarët e bankës kooperativë për vitin e fundit të aktivitetit të tyre.
- 8.1.2. Kur anëtarët janë persona fizikë ose individë:
- listën e anëtarëve, adresën dhe shtetësinë e tyre;
 - listën e bizneseve ku kanë pjesëmarrje influencuese;
 - çertifikatën e regjistrimit në organet e tatim-taksave për personat fizikë;
 - vërtetimin nga autoritetet përkatëse se ndaj tyre nuk është hapur ndonjë proces gjyqësor;
 - dëshmi penaliteti.
- 8.2. Për administratorët
Për drejtuesin dhe një anëtar të këshillit drejtues të bankës kooperativë paraqiten dokumentet në Bankën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren "Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja".
- 8.3 Planbiznesi i paraqitur në Bankën e Shqipërisë përfshin:
- strategjinë e bankës kooperativë të propozuar, objektivat dhe pozicionin e saj në treg;
 - vendvendosjen e bankës së propozuar duke përshkruar kufizimin e saj në një zonë të përcaktuar, që mund të shtrihet në një rreth ose mund të mbulojë disa rrethe;
 - veprimtaritë bankare dhe financiare që propozon të kryejë dhe objektivat për një periudhë njëvjeçare;
 - strukturën e organizimit të bankës kooperativë të propozuar. Ajo të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos pengojë mbikëqyrjen e bankës kooperativë nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra edhe në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 9

Verifikimi i dokumentacionit dhe dhënia e licencës

- 9.1. Banka e Shqipërisë bën verifikimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje. Data e pranimit të kërkesës për licencë konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas kësaj rregulloreje. Nga kjo datë, e cila i njoftohet kërkuetit, llogaritet një afat tremujor brenda të cilit Banka e Shqipërisë jep ose refuzon miratimin paraprak për dhënie licence dhe njofton me shkrim kërkuetin e saj brenda 10 ditësh nga marrja e vendimit.
- 9.2. Dhënia e licencës për të ushtruar veprimtari bankare publikohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- 9.3. Banka kooperativë e licencuar regjistrohet në Regjistrin e Bankave që mbahet në Bankën e Shqipërisë me qëllim konsultimin nga publiku.
- 9.4. Banka e Shqipërisë revokon licencën e bankës kooperativë në rastet e parashikuara në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 10

Komisionet

Banka e Shqipërisë në mbështetje të nenit 11, pika 4 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" vendos komisionet e mëposhtme për procedurat e licencimit të bankave

kooperativë:

- në momentin e paraqitjes së dokumentacionit, kërkuesi paguan në Bankën e Shqipërisë një komision prej 15.000 lekësh;
- në momentin e dhënies së licencës kërkuesi paguan në Bankën e Shqipërisë një komision prej 10.000 lekësh.

Komisionet e mësipërme nuk rimbursohen, pavarësisht nëse miratohet ose jo kërkesa për dhënie licence.

Neni 11

Kërkesat për zgjerimin ose pakësimin e rrjetit të bankës

Banka kooperativë, ka të drejtë të hapë degë dhe agjenci brenda zonës së kompetencës territoriale të bankës vetëm me miratim të Bankës së Shqipërisë.

Për këtë, banka duhet t'i paraqesë një kërkesë me shkrim Bankës së Shqipërisë, duke e shoqëruar kërkesën me këto të dhëna:

- a) vendndodhjen e degës ose të agjencisë së propozuar;
- b) një kopje të rregullores së degës ose të agjencisë;
- c) një përshkrim të shkurtër të kompetencave të drejtuesit kryesor;
- d) planin e veprimtarisë së degës ose të agjencisë për një vit.

Neni 12

Likuidimi

Për procedurat e likuidimit të bankave kooperativë zbatohen rastet e përcaktuara në pikën 7 të nenit 64, të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

RREGULLORE

PËR

MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONAT E LIDHUR ME TË

Miratuar me vendimin nr. 100, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

BAZA LIGJORE DHE QËLLIMI

Neni 1

- 1.1. Baza ligjore e kësaj rregulloreje janë ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 1.2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve të bankës dhe degës së bankës së huaj me personat e lidhur me to.
- 1.3. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat për thjeshtësi do t'i quajmë "bankë".

PËRCAKTIMET

Neni 2

- 2.1. Me persona të lidhur kuptojmë dy ose më shumë individë dhe/ose persona fizikë dhe/ose persona juridikë, të cilët mund të jenë rezidentë ose jorezidentë në Republikën e Shqipërisë, që për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje :
 - 2.1.1. Plotësojnë kuptimin e termave të nenit 2, gërma f dhe gërma k, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.98 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kur personi:
 - ka pjesëmarrje në kapitalin e bankës ose në kapitalin e një shoqërie tjetër e cila është aksionere e bankës,
 - ndikon në vendimmarrjen e bankës apo të shoqërisë tjetër aksionere të bankës,
 - është zotërues direkt ose indirekt i një pjese të kapitalit që i jep atij 25 për qind ose më shumë të votave të organit më të lartë vendimmarrës të bankës apo të personit tjetër juridik,
 - i vetëm ka në dispozicion shumicën e votave në bankë apo tek personi tjetër juridik, në bazë të një marrëveshjeje të përfunduar me ortakët ose me aksionerët e tjerë,
 - përcakton *de facto* nëpërmjet të drejtës së votës që zotëron, vendimet e marra në mbledhjet e organit më të lartë të bankës apo të personit tjetër juridik, përfshirë dhe zgjedhjen dhe emërimin e administratorëve të bankës.
 - 2.1.2. Janë administratorë të bankës në përputhje me përcaktimet e bëra në rregulloren "Për administratorë të bankës dhe të degës së bankës së huaj" dhe familjarët e tyre.

Në zbatim të nenit 35 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me termin familjarë kuptojmë:

- bashkëshorti(a) dhe fëmijët,
- të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve a të motrave.

- 2.1.3. Sipas vlerësimit me shkrim të inspektorëve të mbikëqyrjes, janë financiarisht të lidhur në mënyrë të tillë që vështirësitë financiare të njërit shkaktojnë vështirësi financiare të tjerëve.
- 2.1.4. Për zbatimin e kuadrit rregullativ të mbikëqyrjes, personat e lidhur konsiderohen si një kundërparti e vetme. Koeficienti i ponderimit për personat e lidhur njehsohet me koeficientin më të madh të ponderimit kur të paktën dy nga përbërësit e personave të lidhur kanë secili koeficientë të ndryshëm ponderimi.
- 2.2. Veprimet e bankës me personat e lidhur me të janë të gjitha veprimtaritë e lejuara të bankës, të kryera me personat e lidhur të përcaktuar në pikën 2.1. të këtij neni.
- Veprimet me personat e lidhur trajtohen nga banka, me të njëjtët terma dhe me të njëjtat kushte si veprimet me të gjithë klientët e tjerë të bankës.
- 2.3. Të drejtat ndaj personave të lidhur janë pjesë e veprimeve të bankës me personat e lidhur, në llogaritë e bilancit (kryegjë dhe interes) dhe/ose në llogaritë e jashtë bilancit të marra së bashku.
- 2.4. Të drejtat neto janë të drejtat ndaj personave të lidhur kur nga ato zbriten sipas rradhës :
 i) fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga të drejtat për secilën prej llogarive të bilancit dhe/ose të llogarive jashtë bilancit,
 ii) garancitë dhe/ose kolaterali i marrë, kur këto garanci ose kolaterale plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloren "Për kontrollin e risqeve të mëdha".
- 2.5. Të drejtat në rrezik janë të drejtat neto të ponderuara me koeficientët, të përcaktuara në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit" dhe në përputhje me pikën 2.1.4. të këtij neni.

KËRKESAT MBIKËQYRËSE

Neni 3

- 3.1. Banka e Shqipërisë në zbatim të nenit 37 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" përcakton kufizime për veprimet e bankës me personat e lidhur me të.
- 3.2. Për personat e lidhur të bankës që zotërojnë direkt dhe/ose indirekt jo më pak se 5 për qind të kapitalit të bankës, dhe/ose për personat sipas përcaktimit 2.1.2. dhe/ose 2.1.3. të nenit 2 të kësaj rregulloreje :
- i) të drejtat në rrezik të jenë jo më të mëdha se 20 për qind e kapitalit rregullator;
- ii) të drejtat në rrezik të jenë jo më të mëdha se 30 për qind e kapitalit rregullator kur personi i lidhur është një bankë;
- iii) totali i të drejtave në rrezik të jetë jo më i madh se 300 për qind e kapitalit rregullator.

KONTROLLI

Neni 4

- 4.1. Organet vendimmarrëse të bankës miratojnë rregulla dhe udhëzime të brendshme për :
 i) drejtimin e rrezikut të veprimeve me personat e lidhur;
 ii) politikatat dhe procedurat për dhënie e kredive, në të cilat të theksohet shprehimisht se kushtet e kredive për personat e lidhur janë të njëjta me kushtet e të gjithë klientelës.
- 4.2. Subjektet e kësaj rregulloreje të sigurojnë një sistem monitorimi dhe informacioni të vazhdueshëm për veprimet me personat e lidhur. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të mbikëqyrë në çdo kohë sistemin e monitorimit dhe të informacionit të veprimeve me personat e lidhur.

RAPORTIMI

Neni 5

- 5.1. Subjektet e kësaj rregulloreje raportojnë në Bankën e Shqipërisë për veprimet me personat e lidhur sipas formatit të raportimit bashkëlidhur.
- 5.2. Formularët e raportimit, nga subjektet e kësaj rregulloreje, plotësohen çdo muaj, ndërsa raportimi në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, në Sektorin e Inspektimeve në Vend, të bëhet jo më vonë se 10 ditë nga fundi i çdo tremujori. Inspektorët e Departamentit të Mbikëqyrjes kanë të drejtë të përcaktojnë afate më të shpeshta raportimi, kur e gjykojnë të arsyeshme.

PËRFUNDIMTARE

Neni 6

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr. 100, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI

FORMULARI NR. 1

MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONIN E LIDHUR

Emri i bankës
Periudha raportuese
Data e raportimit
Përgatiti (Emër,mbiemër,firmë)
Drejtuesi (Emër,mbiemër,firmë)

Përbërja	Të drejtat (1)	Detyrime (2)
a. Individ : -----		
b. Person fizik : -----		
c. Person juridik : -----		
1. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////	//////////
a. Individ : -----		
b. Person fizik : -----		
c. Person juridik : -----		
2. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////	//////////
a. Individ : -----		
b. Person fizik : -----		
c. Person juridik : -----		
n. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////	//////////
Totali i veprimeve me personat e lidhur (1+2+..+n)	//////////	//////////

FORMULARI NR. 2

KËRKESAT MBIKËQYRËSE TË VEPRIMEVE TË BANKËS ME PERSONIN E LIDHUR

Emri i bankës
Periudha raportuese
Data e raportimit
Përgatiti (Emër,mbiemër,firmë)
Drejtuesi (Emër,mbiemër,firmë)

KAPITALI RREGULLATOR
(20%) E KAPITALIT RREGULLATOR :
(30%) E KAPITALIT RREGULLATOR :
(300%) E KAPITALIT RREGULLATOR :

Veprimet me personat e lidhur	Të drejtat (1) ¹	Fondet rezervë (2)	Garancitë dhe/ose kolaterale të marra (3)	Të dënuara (4)= {(2)-(3)}
1. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr. 1)				
2. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr. 1)				

n. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr. 1)				
Totali veprimeve me personat e lidhur (1+2+..+n)				

¹ Në këtë kolonë regjistrohen shuma e të dhënave të kolonës 1 dhe të dhënat e kolonës 3 (për zërat jashtë-bilanci), të nxjerra nga formulari nr.1 .